



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni!

KOMPANIA E SIGURIMEVE “Elsig” – PRISHTINË

KUSHTET PËR SIGURIMET E PRONËS
PER SIGURIMIN E BIZNESEVE

Prishtinë, Korrik 2025

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMET E PRONËS (ABV...KS12 / niveli 1)

Përmbajtja

- Neni 1 Përkufizimet e përgjithshme
- Neni 2 Kontrata e sigurimit
- Neni 3 Forma e shkruar
- Neni 4 Ndërmjetësuesit e sigurimit
- Neni 5 Ndryshimi i adresës së kontraktuesit të sigurimit
- Neni 6 Përmbajtja e kontratës së sigurimit
- Neni 7 Obligimi për informimin parakontraktual
- Neni 8 Rritja e rrezikshmërisë
- Neni 9 Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodh dëmi
- Neni 10 Pagesa e primit
- Neni 11 Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi
- Neni 12 Vetëmbajtja e kontraktuar (franshiza)
- Neni 13 Afati për kompensimin e dëmit(pagesën e dëmshpërblimit)
- Neni 14 Ekspertiza
- Neni 15 Situata ligjore pas dëmit
- Neni 16 Pushimi së ekzistuari i sendit të siguruar
- Neni 17 Ndërrimi i pronarit të sendit të siguruar
- Neni 18 Sigurimi për llogari të tjetrit
- Neni 19 Zgjatja e kontratës; Lirimi për kohëzgjatjen
- Neni 20 Marrëveshja për gjyqin përgjegjës
- Neni 21 Ndryshimi i kushteve të sigurimit apo i tarifës së primit

Neni 1

Përkufizimet e përgjithshme

Përkufizimet vijuese kanë në tekstet e këtyre kushteve kuptimin e mëposhtëm:

Siguruesi: është K.S. „ELSIG“ Sh.a. dhe ka selinë në Prishtinë

Parashtruesi i kërkesës: është personi i cili shtron kërkesën për sigurim. Në rast se pranohet kërkesa e shkruar dhe lidhet kontrata e sigurimit atëherë parashtruesi i kërkesës për sigurim është automatikisht edhe kontraktuesi i sigurimit.

Kontraktuesi i sigurimit: është personi fizik apo juridik i cili lidh kontratën e sigurimit me siguruesin dhe ka obligim që t'i paguaj siguruesit primin e sigurimit. Kontraktuesi i sigurimit mund të siguroj pasurinë apo/dhe interesin e tij (në këtë rast ai është kontraktuesi i sigurimit dhe i siguruar ose thënë ndryshe personi i siguruar njëkohësisht) ose pasurinë apo/dhe interesin e personit të tretë.

I siguruari: është personi, pasuria apo interesi i të cilit sigurohet, dhe që ka një interes të ligjshëm material që të mos ndodh dëmi.

Sigurimi për palën e tretë: është kontrata e sigurimit, në të cilën kontraktuesi i sigurimit është i ndryshëm nga i siguruari

Data e ripërtirjes: është një datë e veçantë brenda një viti. Kjo datë shënohet në secilën policë duke shkruar një ditë dhe muaj të veçantë. Data e ripërtirjes është me rëndësi të veçantë për afatin e pagesës së primit. Normime më të detajuara rreth kësaj do të bëhen në pjesë tjera të këtyre kushteve.

Periudha e sigurimit: është periudha kohore e një viti, përveç nëse kontrata e sigurimit është lidhur për kohë më të shkurtër se sa një vit. Secilën herë në datën e ripërtirjes, përfundon periudha e mëparshme dhe fillon periudha e ardhshme e sigurimit. Data e ripërtirjes është e shënuar në policë.

Primi i sigurimit: është shuma e parave, të cilën kontraktuesi i sigurimit ia paguan siguruesit për secilën periudhë siguruese dhe atë për shkak të kontratës së lidhur të sigurimit. Zakonisht pagesa bëhet paraprakisht

Shuma e sigurimit: është shuma më e lartë e obligimit të siguruesit, në rast se ndodhë rasti i siguruar.

Polica e sigurimit: është dokumenti(dëftesa) që dokumenton lidhjen e kontratës së sigurimit, e që duhet lëshuar nga siguruesi.

Sigurimi në pako: është përmbledhja e më shumë klasave të ndryshme të sigurimit përmes paraqitjes së përbashkët në kërkesën për sigurim dhe në policën e sigurimit. Secila klasë e sigurimit në pako paraqet në vetvete një kontratë të veçantë. Në policë shënohet primi për secilën klasë veç e veç.

Neni 2

Kontrata e sigurimit

Kërkesa e sigurimit, të gjitha dokumentet shtesë të kërkesës e që janë të formës së shkruar, polica e sigurimit, dhe kushtet e marrëveshjes së sigurimit janë pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit.

Neni 3

Forma e shkruar

1. Të gjitha marrëveshjet, paraqitjet, kërkesat dhe sqarimet rreth kontratës së sigurimit, duhet të bëhen me shkrim. Sqarimet e siguruesit janë të vlefshme vetëm nëse janë në formë të shkruar dhe përmbajnë: emrin zyrtar të kompanisë, adresën e saktë të kompanisë nënshkrimitin e personit të autorizuar për vendosjen e marrënieve kontraktuale për kompaninë dhe vulën e kompanisë. Letrat e kontraktuesit të sigurimit dhe të siguruarit janë ligjërish të vlefshme vetëm nga momenti kur arrijnë në selinë qendrore të siguruesit.
2. Siguruesi pasi që të ketë marrë kërkesën për sigurim, mund të kërkojë informacione shtesë dhe sqarime të tjera. Në këtë rast llogaritet që kërkesa për sigurim i ka arritur siguruesit vetëm atëherë kur siguruesi pranon të gjitha informacionet shtesë dhe sqarimet e kërkuara.
3. Nëse ende nuk ka ndodhur ngjarja e siguruar, kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë që brenda afatit kohor prej 10 ditë pune nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sigurimit (apo nga momenti i ardhjes së policës me postë apo në ndonjë mënyrë tjetër), të shkëpusë kontratën e sigurimit duke i dërguar me shkrim siguruesit njoftimin për shkëputjen e kontratës. Me këtë rast kontraktuesit të sigurimit i kthehet primi i parapaguar mirëpo pa pjesën e mbajtur nga siguruesi për shkak të shpenzimeve administrative, lartësia e së cilës është 10% e primit të parapaguar.

Neni 4

Ndërmjetësuesit e sigurimit

Ndërmjetësuesit e sigurimit janë të autorizuar të këshillojnë kontraktuesin e sigurimit apo paraqitësin e kërkesës për sigurim, dhe t'i ofrojnë atij të gjitha informatat e nevojshme për paraqitjen e kërkesës për sigurim. Ndërmjetësuesit e sigurimit, megjithatë nuk janë të autorizuar, që në emër të siguruesit, të japin sqarime që e fusin siguruesin në detyrim, apo që në emër të tij të marrin(pranojnë) shumën të çfarëdoshme parash

Neni 5

Ndryshimi i adresës së kontraktuesit të sigurimit

1. Kontraktuesi i sigurimit, është i obliguar që siguruesin ta informojë menjëherë me shkrim për çdo ndryshim të: adresës së banimit, adresës së kompanisë, apo adresës së dërgesave.
2. Për ndryshimin e emrit, mbiemrit, apo ndryshimin e emrit zyrtar të kompanisë, po ashtu duhet informuar menjëherë siguruesin.
3. Në rast të mosrespektimit të pikës 1, palët merren vesh, që: deri në mbërritjen e njoftimit(informacionit) për ndryshimin e adresës, tek siguruesi, llogaritet që shkresat e dërguara rekomande nga siguruesi, në adresën e fundit të njohur të kontraktuesit të sigurimit, janë dërguar në mënyrë të rregullit dhe po ashtu llogaritet që i kanë arritur kontraktuesit të sigurimit më së voni tetë ditë pas dërgimit të tyre rekomande nga siguruesi. Për mosrespektimin e pikës 2, vlen e njëjta rregull.

Neni 6

Përmbajtja e kontratës së sigurimit

1. Nëse sigurimi i referohet një sendi, atëherë vlera që duhet siguruar është e njëjtë me vlerën e atij sendi, përveç nëse rrethanat nuk e përcaktojnë ndryshe.
2. Fitimi i humbur sigurohet, vetëm nëse për këtë, palët kanë arritur marrëveshje të veçantë në kontratën e sigurimit.

3. Nëse sigurimi është bërë për një personifikim(sendi apo bashkësia i/e cila përfshinë në vete sende tjera), atëherë janë të siguruarat të gjitha sendet që përfshihen me atë personifikim.
4. Nëse shumat e sigurimit në momentin kur ndodh ngjarja e siguruar, është më e lartë se sa vlera e sigurimit (mbisigurim), atëherë siguruesi nuk është i detyruar të dëmshpërblejë të siguruarin me një vlerë më të madhe se sa vlera e dëmit. Kompensimi(zhdëmtimi) i plotë i dëmit, kurrë nuk mund të jetë më i lartë se shumata e sigurimit.
5. Nëse shumata e sigurimit në momentin kur ndodh ngjarja e siguruar, është më e ulët se sa vlera e sigurimit (nënsigurim), atëherë siguruesi ka detyrim të paguaj vetëm një pjesë të dëmit dhe atë në proporcionin e njëjtë sikurse shumata e sigurimit me vlerën e sendit të siguruar, dhe atë sipas principit proporcional. Për të konstatuar dhe përcaktuar nënsigurimin eventual merren parasysh të gjitha sendet e siguruarat.

Neni 7

Obligimi për informimin parakontraktual

1. Me rastin e lidhjes së kontratës, kontraktuesi i sigurimit duhet të informoj drejt dhe plotësisht për të gjitha rrethanat, që luajnë rol në përcaktimin e rrezikshmërisë, dhe të vendimit për marrjen e rrezikut në sigurim. Kjo vlen për rrethanat që i janë të njohura apo do të duhej të i ishin të njohura kontraktuesit të sigurimit. Rrethanat që përcaktojnë vendimin, për sigurimin apo mossigurimin e rrezikut, janë gjithë ato rrethana që ndikojnë në vendimin e përgjithshëm të siguruesit për të lidhur apo moslidhur kontratën, apo në vendimin e tij për lidhjen/moslidhjen e asaj kontrate me konditat për të cilat palët janë pajtuar. Rrethanat për të cilat siguruesi ka pyetur në formë të shkruar, hyjnë gjithsesi në këtë grup rrethanash.
2. Nëse ka shkelje të qëllimshme të obligimit për informimin parakontraktual sipas pikës 1, atëherë siguruesi ka mundësi që në pajtim me ligjin të shkëpusë kontratën dhe është i liruar nga detyrimi i tij për dëmshpërblim eventual.
3. Nëse shkelja e obligimit për informimin parakontraktual sipas pikës 1, nuk është bërë qëllimshëm, atëherë siguruesi ka mundësi që të shkëpusë kontratën, apo të ofrojë përshtatjen e lartësisë së primit. Shkëputja e kontratës apo oferta për përshtatjen e primit mund të bëhen nga siguruesi vetëm brenda afatit kohor prej një muaji nga momenti kur ai ka kuptuar për shkeljen e obligimit të informimit parakontraktual.
- 3.1. Në rast të shkëputjes së kontratës, kontrata përfundon(shkëputet) 14 ditë pas arritjes së letrës (rekomandë) për shkëputjen e kontratës. Në rast të ofertës për përshtatjen e primit, kontrata shkëputet automatikisht nëse kontraktuesi i sigurimit brenda afatit kohor prej 14 ditësh nga arritja e ofertës, nuk e pranon atë ofertë për rritjen e primit.
- 3.2. Nëse rasti i siguruar ndodh para se të jetë kuptuar se ka ndodhur shkelja e obligimit për informimin parakontraktual, apo qoftë edhe pasi të jetë kuptuar se ka pasur shkelje mirëpo gjithsesi para se të jetë shkëputur kontrata apo të ketë ardhur deri tek marrëveshja për ngritjen e primit, atëherë reduktohet dëmshpërblimi, dhe atë në proporcionin mes primit që është paguar, dhe primit që do të duhej paguar, për situatën e rrezikshmërisë reale. Nëse siguruesi, po të kishte pasur njohuri për rrethanat e rrezikshmërisë së vërtetë, fare nuk do të kishte nënshkruar kontratën për shkak të parimeve bazë të kompanisë së tij, atëherë siguruesi është i liruar nga obligimi i tij për dëmshpërblim.

Neni 8

Rritja e rrezikshmërisë

1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar që për çdo ndryshim të rëndësishëm të rrezikshmërisë(rritjes së rrezikut), menjëherë pasi të ketë kuptuar për këtë, ta njoftojë siguruesin me shkrim. Nëse rreziku është rritur pa ndikimin e kontraktuesit të sigurimit, atëherë ky i fundit duhet të njoftojë siguruesin me shkrim për rritjen e rrezikut më së voni 14 ditë pasi që të ketë kuptuar për rritjen e rrezikshmërisë. Si rritje e rrezikshmërisë shihen të gjitha ato rrethana, që do të kishin ndikuar në vendimin e siguruesit për të lidhur apo mos lidhur fare kontratën e sigurimit si dhe në vendimin e tij për të lidhur apo mos lidhur kontratën e sigurimit me ato kondita për të cilat palët janë marrë vesh.
2. Nëse rritja e rrezikut është e atillë, që siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën nëse gjendja e tillë do të kishte mbretëruar në kohën e

lidhjes së kontratës, atëherë siguruesi ka të drejtë të shkëpusë kontratën menjëherë(pa afat kohorë priteje).

3. Nëse rritja e rrezikut është e atillë, që nëse kjo gjendje e rrezikshmërisë do të kishte mbretëruar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta lidhte këtë kontratë vetëm me kondita tjera kontraktuale(p.sh. me një prim më të lartë), atëherë ai ka të drejtë të ofrojë kontraktuesit të sigurimit kondita të reja(p.sh. prim të ri) për kontratën. Në këtë rast kontrata automatikisht përfundon(shkëputet) në rast se brenda afatit kohor prej 14 ditësh prej momentit të arritjes së kësaj oferte, kontraktuesi i sigurimit nuk e pranon ofertën.
4. Shkëputja e kontratës, apo oferta për ndryshimin e konditave kontraktuale, mund të bëhen nga siguruesi, vetëm brenda afatit kohor prej një muaji, nga çasti kur ai kupton për rritjen e rrezikshmërisë, apo për situatën reale të rrezikshmërisë.
5. Rregullat e këtij neni zbatohen po ashtu edhe për rritjen e rrezikshmërisë gjatë periudhës kohore mes paraqitjes së kërkesës dhe lidhjes së kontratës, kur ofrohet nga kontraktuesi i sigurimit apo rrezikshmëria reale nuk ka qenë të njohura për siguruesin.

Neni 9

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodh dëmi

1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar, që të ndërmerr të gjitha masat të cilat parashihen me ligj, apo me kontratë si dhe të gjitha masat tjera, që ndihmojnë parandalimin e dëmit. Ai gjithashtu nuk guxon të tolerojë shkeljen e këtyre obligimeve nga personat e tretë.
2. Nëse kontraktuesi i sigurimit shkel ndonjë nga këto detyrime qëllimisht, apo nga neglizhencia(pakujdesia) e madhe, atëherë siguruesi është i lirë nga obligimi i tij për zhdëmtim.
3. Siguruesi megjithatë nuk lirohet nga detyrimi i tij për të zhdëmtuar, nëse shkelja e detyrimit të kontraktuesit nuk ka ndikuar në ndodhjen e rastit të siguruar dhe në lartësinë e dëmit të mbuluar.

Neni 10

Pagesa e primit

1. Kontraktuesi i sigurimit, është i obliguar të paguaj primin, përderisa siguruesi ka obligim të marrë pagesat e primit prej kujtëdo që ka për këtë një interes ligjor.
2. Normalisht, primi duhet parapaguar për secilën periudhë të sigurimit. Në raste të veçanta mundet që palët kontraktuese të merrin vesh që primi të paguhet në këste, ku siguruesi do të kishte të drejtë që për këtë të llogaritë një pagesë shtesë(prim shtesë). Nëse palët janë pajtuar që primi të paguhet në këste, atëherë në policë duhet shënuar lartësinë dhe afatin kohor për pagimin e këtyre kësteve të primit.
3. Primi për periudhën e parë të sigurimit apo kësti i parë i primit duhet të paguhet me rastin e lidhjes së kontratës. Lartësia dhe afati i pagesës së primeve tjera apo të kësteve tjera të primit duhet shënuar në policë.
4. Nëse kontraktuesi i sigurimit vonohet në pagesën e ndonjë pjese të primit, apo kontrata e sigurimit shkëputet para afatit për të cilin palët janë pajtuar, atëherë të gjitha këstet e hapura(ende të papaguara) të primit, duhet paguar menjëherë.
5. Mbrojtja(mbulesa) siguruese fillon me pagesën e primit(apo këstit të parë nëse është kontraktuar pagesa në këste), por jo më herët se sa afati i fillimit të sigurimit i shkruar në policë.
6. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar që t'i paguaj siguruesit primin me shpenzimet e veta. Nëse pagesa e primit bëhet përmes transferit bankar apo të ndonjë instituti tjetër që bën këso lloj transferesh, atëherë si datë e pagesës llogaritet data kur kontraktuesi i sigurimit i jep bankës (institutit) detyrën, që kjo e fundit të bëjë transferin e parave.
7. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar, që përveç primit, të paguaj po ashtu të gjitha tatimet apo taksat, që kërkojnë me ligj.
8. Siguruesi ka të drejtë që për secilën vonesë në pagesë, t'i vë në llogari kontraktuesit të sigurimit kamatën(interestin) dhe shpenzimet për tërheqjen e vëmendjes(paralajmërimit) për vonesën në pagesën e primit.
9. Në rast të mbetjes prapa(vonesave) në pagesë, me pagesat që arrijnë tek siguruesi, së pari paguhen shpenzimet ende të hapura për tërheqjen e vëmendjes, më pas interesi(kamata) dhe tek pastaj primi ende i pambuluar, dhe atë duke filluar me atë prim apo pjesë të primit, afati i pagesës i të cilit është më i vjetri. Tek sigurimet në pako, primi i paguar me vonesë ju ndahet kontraktave të veçanta të sigurimit në

pako në raport të njëjtë me lartësinë e primit të kontraktuar për llojet e veçanta të sigurimit.

10. Siguruesi ka të drejtë që shumën e hapur(ende të papaguar) të primit që i ka kaluar afati i pagesës, apo shumën e ndonjë pretendimi(si p.sh.: shpenzimet për tërheqjen e vëmendjes, kamatat, etj.) që ai ka me të drejtë nga kjo kontratë, t'i llogarisë në rast të pagesës së detyrimit për zhdëmtim ndaj kontraktuesit të sigurimit apo ndonjë pale të tretë.

11. Nëse kontraktuesi i sigurimit nuk paguan me kohë(brenda afatit) dhe në tërësi primin e përcaktuar me kontratë, dhe këtë nuk e bën po ashtu asnjë person tjetër, që do të kishte interes ta bëjë këtë, atëherë pas afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga dita kur kontraktuesi i sigurimit ka marrë njoftimin rekomandë të siguruesit për afatin e pagesës së primit por jo më pare se 30 ditë nga afati i pagesës së primit, kjo kontratë e sigurimit vlen si *ipso iure* e shkëputur.

Nëse kontraktuesi i sigurimit bashkë me personat tjerë që kanë interes të paguajnë primin e kanë vonuar në më shumë se një rast më shumë se tridhjetë ditë pagesën e plotë të primit (apo kështu të primit nëse është kontraktuar që primi të paguhet në këste), atëherë pas afatit kohor prej 10 ditësh, duke filluar nga dita kur kontraktuesi i sigurimit ka marrë njoftimin rekomandë të siguruesit për afatin e pagesës së primit kjo kontratë e sigurimit vlen si *ipso iure* e shkëputur.

Për çdo rast kontrata vlen si *ipso iure* e shkëputur, nëse primi nuk paguhet 1 vit pas afatit të pagesës së tij.

Neni 11

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

1. Nëse ndodhë dëmi, kontraktuesi i sigurimit ka obligim që:
 - 1.1. sipas mundësive, menjëherë të provojë të shmangë apo të mbajë të vogël dëmin, dhe t'u përmbahet udhëzimeve të siguruesit. Ai duhet, nëse është e mundur, të marrë këto udhëzime nga siguruesi(obligimi i zvogëlimit të dëmit).
 - 1.2. ta informojë siguruesin, menjëherë pasi që ka njohuri për dëmin e mbuluar nga sigurimi, e më së voni brenda 3 ditësh(obligimi i lajmërimit të dëmit).
 - 1.3. të japë çdo informatë që është e nevojshme për vlerësimin (përcaktimin) e drejtë të dëmit apo të lartësisë së obligimit të siguruesit për zhdëmtim. Kontraktuesi i sigurimit ka obligim që të gjitha dëshmitë e nevojshme me shkrim që e ndihmojnë këtë vlerësim(p.sh.: dëftesat, faturat, protokollat), nëse një gjë e tillë kërkohet nga siguruesi, t'ia sjell atij dhe atë, me shpenzimet e veta. Siguruesit, gjatë procesit të trajtimit të aktit të dëmit, i duhet dhënë të gjitha informatat(sic me shkrim ashtu edhe gojëre) të plota dhe të vërteta(sakta). Siguruesit apo personit të autorizuar nga ai, i duhet dhënë në çdo kohë qasje në vendngjarjen e dëmit(obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit).
 - 1.4. të gjitha obligimet tjera, që dalin si të tilla nga kushtet e kontraktuar të sigurimit dhe vëjnë për periudhën pasi të ketë ndodhur dëmi, duhet përbushur menjëherë.
2. Në rast të shkeljes së detyrimeve të përcaktuara nga pika 1.1 deri 1.4, kontraktuesi i sigurimit është i detyruar ta zhdëmtojë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 12

Vetëmbajtja e kontraktuar (franshiza)

Nëse në kontratën e sigurimit palët kanë lidhur marrëveshje për vetmbajtjen e kontraktuar (franshizën) të kontraktuesit të sigurimit, atëherë ky i fundit nuk ka të drejtë që këtë vetmbajtje ta sigurojë tek ndonjë sigurues tjetër. Nëse kjo megjithatë ndodhë, atëherë zhdëmtimi bëhet ashtu, që zhdëmtimi i siguruesit tjetër merret megjithatë parasysh çka do të thotë se kontraktuesi i sigurimit prapëseprapë do ngarkohet me vetmbajtjen e kontraktuar (franshizën).

Neni 13

Afati për kompensimin e dëmit(pagesën e dëmshpërblimit)

1. Kur ndodh ngjarja e siguruar, atëherë siguruesi duhet që dëmshpërblimin apo shumën e caktuar me kontratë ta paguaj brenda afatit kohor prej 15 ditësh, duke llogaritur kohën nga dita e marrjes së njoftimit për kompletimin e dokumentacioni te ngjarjes se siguruar.
2. Nëse nevojitet një kohë e caktuar për të vërtetuar obligimin e siguruesit për të dëmshpërblyer apo për të vërtetuar lartësinë atij

dëmshpërblimi, atëherë afati për kompensim fillon të llogaritet nga dita kur ekzistimi i obligimit për dëmshpërblim, si dhe lartësia e tij janë përcaktuar.

3. Nëse lartësia e dëmshpërblimit nuk është përcaktuar brenda afatit kohor të shënuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë siguruesi duhet që të bëjë parapagesën e zhdëmtimit në atë lartësi për të cilën dihet se duhet paguar medoemos.
4. Afati kohor për zhdëmtim sipas pikave 1 deri 3 vendnumëron, nëse me faj të kontraktuesit të sigurimit dëmi apo lartësia e tij nuk mund të përcaktohen, apo pagesa nuk mund të ekzekutohet.
5. Zhdëmtimi(pagesa e kompensimit për dëmin) nuk mund të kërkohet në asnjë mënyrë prej siguruesit, nëse
 - 5.1. ka dyshime, rreth së drejtës për të marrë pagesën e kompensimit të dëmit nga paraqitësi i kërkesës për zhdëmtim, dhe atë deri sa të sillen provat e nevojshme që nuk është ashtu;
 - 5.2. në rast se si pasojë e dëmit të shkaktuar, janë nisur hetime ndaj kontraktuesit të sigurimit apo paraqitësit të kërkesës për zhdëmtim dhe atë nga policia, institucionet(autoritetet) zyrtare, apo për çështje penale nga ndonjë gjyq, siguruesi mund të shtyj afatin e pagesës deri në përfundimin e hetimeve.

Neni 14

Ekspertiza

1. Ekspertiza duhet të bëhet nëse ndonjëra palë kontraktuale, paraqet kërkesë për këtë. Nga kjo procedurë mund të nxirren vetëm konkludime rreth shkakut dhe lartësisë së dëmit. Konkluzionet e ekspertizës janë detyruese për palët, përveç nëse në mënyrë të rregullt dëshmohej se këto konkluzione qenësisht janë të ndryshme nga gjendja faktike. Vetëm në këtë rast, apo edhe në rastin kur ekspertët nuk mund të japin, nuk donë të japin, apo i vonojnë konkluzionet e tyre, kontraktuesi i sigurimit mund t'i drejtohet gjykatës. Vonesë llogaritet nëse ekspertët nuk i nxjerrin konkluzionet e tyre brenda afatit kohor prej 2 muajsh nga data e marrjes së detyrës për të bërë ekspertizën. Para përmbylljes së ekspertizës nuk është e obligueshme për siguruesin të paguaj për dëmin, dhe afati kohor sipas nenit 13 pika 1 fillon të numërohet, tek nga momenti i mbylljes së ekspertizës (Neni 13 pika 2).
2. Për procesin e ekspertizës vëjnë rregullat në vijim:
 - 2.1. Secila palë kontraktuale, zgjedh një ekspert(vlerësues dëmi), i cili është në listën e vlerësuesve të dëmit për ato lloje dëmsh dhe që është i autorizuar nga gjyqi.
 - 2.2. Secila palë kontraktuale ka të drejtë të kërkojë me shkrim nga pala tjetër, që ajo të zgjedh ekspertin e dytë. Nëse kjo zgjedhje nuk bëhet në afatin kohor prej dy javësh, nga momenti i marrjes së kërkesës për këtë, atëherë ekspertiza përmbyllet prapëseprapë dhe atë me konkluzionet e ekspertit të parë.
 - 2.3. Para fillimit të ekspertizës, të dy ekspertët(vlerësuesit e dëmit) e zgjedhur nga palët kontraktuese, përzgjedhin një ekspert të tretë si kryesues.
 - 2.4. Ekspertët i dorëzojnë konkluzionet e tyre në të njëjtën kohë të dy palëve të kontratës. Nëse ka dallime në mes të këtyre dy konkluzioneve, siguruesi i jep këto kryesuesit i cili më pas duhet të vendosë për pikat ku konkluzionet dallojnë. Vendimi i tij nuk guxon të jetë jashtë kufijve që përcaktohen nga konkluzionet e ndryshme të dy ekspertëve të përcaktuar nga palët e kontratës(duhet të jetë diku mes dy konkluzioneve të ndryshme). Pasi të ketë vendosur, kryesuesi i jep më pas në të njëjtën kohë që të dy palëve konkluzionet e tij.
 - 2.5. Shpenzimet e ekspertizës, i ndajnë palët në kontratë në relacionin fitimtar – i mundur.
3. Lartësia e pagesës për dëmin llogaritet në bazë të konkluzioneve që dalin nga ekspertiza.
4. Obligimet ligjore dhe kontraktuale të kontraktuesit të sigurimit, nuk preken(mbesin të njëjta) nga procesi i ekspertizës.
5. Siguruesi dhe kontraktuesi i sigurimit mund të merren vesh, që ekspertizën me konkluzionet obliguese për të dy palët ta bëjë një ekspert i vetëm, i cili do të zgjidhë nga të dy palët.

Neni 15

Situata ligjore pas dëmit

1. Pasi të ketë ndodhur dëmi, si siguruesi ashtu edhe kontraktuesi i sigurimit kanë të drejtë të shkëpusin kontratën e sigurimit, me kusht

që kufiri minimal të jetë tejkaluar. Llogaritjet që ky kufi minimal është tejkaluar nëse dëmet e shkaktuara në periudhën aktuale të sigurimit, janë më të larta se 1 promil e shumës së përgjithshme të sigurimit (0,001 * Shuma e sigurimit).

2. Shkëputja e kontratës është e mundur në çdo kohë, mirëpo jo më vonë se një muaj nga momenti i përfundimit të negociatave për zhdëmtimin. Siguruesi duhet t'i përmbahet një afati kohor prej një muaji në rast se e shkëput kontratën – me fjalë të tjera kontrata mbetet në fuqi edhe për një muaj nga momenti i shkëputjes së saj. Kontraktuesi i sigurimit nuk mund të shkëpusë kontratën më vonë se fundi i periudhës aktuale të sigurimit.
3. Nëse klienti ka tentuar të marrë kompensim nga siguruesi përmes mashtimit, atëherë siguruesi ka të drejtë që sapo të ketë refuzuar të bëjë kompensimin, menjëherë të shkëpusë kontratën dhe atë pa afat prilej(kontrata nuk mbetet në fuqi për asnjë moment pas shkëputjes).
4. Në kushtet e përgjithshme apo të veçanta të degëve të veçanta të sigurimit të pasurisë kjo çështje mund të rregullohet ndryshe.

Neni 16

Pushimi së ekzistuarit i sendit të siguruar

1. Nëse vjen deri tek shkatërrimi i sendit të siguruar, para fillimit të sigurimit, atëherë shuhet obligimi për pagesën e primit dhe kontraktuesit të sigurimit i kthehet primi i parapaguar(i paguar paraprakisht). Siguruesi mund t'i vejë në llogari të kontraktuesit të sigurimit shpenzimet për administrim dhe atë me një lartësi të arsyeshme.
2. Nëse sendi i siguruar shkatërrohet gjatë periudhës së sigurimit dhe sipas kontratës nuk është fjala për një dëm të mbuluar(ngjarje të siguruar), atëherë kontrata për sigurimin e sendit në fjalë përfundon mu në ditën e shkatërrimit të atij sendi. Nga moment i arritjes së informimit me shkrim nga kontraktuesi i sigurimit tek siguruesi për pushimin së ekzistuarit të sendit të siguruar, siguruesi obligohet që të kthejë pjesën e primit për periudhën e sigurimit të pa skaduar, për të cilën primi është parapaguar.
3. Nëse sendi i siguruar shkatërrohet nga një dëm i mbuluar(ngjarje e siguruar), atëherë primi duhet të paguhet për gjithë periudhën aktuale të sigurimit.

Neni 17

Ndërrimi i pronarit të sendit të siguruar

1. Me rastin ndërrimit të pronarit të sendit të siguruar, të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit të sigurimit, kalojnë *ipso iure* tek pronari i ri.
2. Kontraktuesi i sigurimit, që nuk e informon siguruesin për shitjen(ndërrimin e pronarit) të sendit të siguruar, mban edhe më tej përgjegjësi edhe për pagesën e primeve, që kanë afatin e pagesës pas ditës së shitjes(ndërrimit të pronarit) të sendit të siguruar.
3. Siguruesi dhe pronari i ri i sendit të siguruar kanë të drejtë të shkëpusin kontratën e sigurimit brenda afatit kohor prej 30 ditësh, nga dita kur ata kanë njohuri për ndërrimin e pronarit. Nëse cillido nga këta të dy e shkëputë kontratën brenda këtij afati, shkëputja megjithatë bëhet e plotfuqishme vetëm pas afatit kohor prej 15 ditësh nga data e njoftimit për shkëputjen e saj.
4. Rregullat e këtij neni vlejnë edhe në rast të ndërrimit të pronarit të sendit të siguruar përmes ekzekutimit të ankandit/inkaso-s të detyruar.

Neni 18

Sigurimi për llogari të tjetrit

1. Në rast të sigurimit për llogari të tjetrit, kontraktuesi i sigurimit lidh një kontratë sigurimi në emër të vet për pasurinë e huaj(interestin e një personi të tretë). Emri i këtij personi të tretë(emri i të siguruarit), mund të futet në kontratë, mirëpo kjo nuk është e detyrueshme.
2. Në rast të sigurimit për llogari të tjetrit, kontraktuesi i sigurimit është i detyruar të paguajë primin, dhe t'i përmbushë obligimet e tjera që dalin nga kontrata e sigurimit. Në anën tjetër, e drejta për zhdëmtim i takon të siguruarit.
3. I siguruari, mund të jetë në pronësi të drejtave të tij nga kontrata e sigurimit apo të realizojë këto të drejta përmes rrugës gjyqësore pa lejen e kontraktuesit të sigurimit, vetëm atëherë kur ai ka në pronësi policën e sigurimit.
4. Nëse nga normat ligjore, kushtet e sigurimit, apo rregullat tjera që dalin nga kontrata e sigurimit, del se sjellja e kontraktuesit të sigurimit ka konsekuenca ligjore për mardhënien e lidhur të sigurimit, atëherë tek

sigurimi për palën e tretë, sjellja e të siguruarit(pronarit) ka të njëjtat konsekuenca ligjore sikurse sjellja e kontraktuesit të sigurimit. Të gjitha obligimet e kontraktuesit të sigurimit, përveç obligimit të pagesës së primit, janë po ashtu edhe obligime të të siguruarit. Të gjitha faktet e bazuara në kontratën e sigurimit, që siguruesit i japin të drejtën të jetë kundërshtues apo refuzues në raport me kontraktuesin e sigurimit, siguruesi ka të drejtë(mund) t'i zbatojë edhe kundrejt të siguruarit vetë.

Neni 19

Zgjatja e kontratës; Lirimi për kohëzgjatjen

1. Kontrata e sigurimit vlen për kohën e përcaktuar me kontratë. Nëse kohëzgjatja e kontratës është të paktën një vit dhe kjo kontratë nuk shkëputet nga kontraktuesi i sigurimit apo siguruesi dhe atë të paktën tre muaj para skadimit të kontratës sipas afatit të skadimit të shënuar në policë, atëherë pas kalimit të periudhës së sigurimit të shënuar në policë, zgjatet kontrata për kohë të pacaktuar.
2. Nëse siguruesi ka ulur(liruar) primin për shkak të marrëveshjes për kohëzgjatjen e kontratës(lirimi për kohëzgjatjen), atëherë në rast se kontrata shkëputet para afatit të marrëveshjes, siguruesi ka të drejtë të kërkojë pagesën e asaj pjese shlesë të primit të cilën do ta kishte kërkuar qysh në fillim nëse kontrata do të ishte lidhur vetëm për afatin kohor kur ajo vërtetë ka ekzistuar.

Neni 20

Marrëveshja për gjyqin përgjegjës

1. Mospajtimet mes siguruesit në njërën anë, dhe kontraktuesit të sigurimit bashkë me të siguruarit në anën tjetër, zgjidhen njëzëri, në pajtim me rregullat interne të siguruesit.
2. Në rast se, marrëveshja njëzëri nuk është e mundur, atëherë kontraktuesi i sigurimit në pajtim me Ligjin për sigurimet LIGJI Nr. 05/L -045 ka të drejtë të drejtohet me ankesë forumit të pavarur të arbitrazhit apo nëse ky i fundit ende nuk është themeluar atëherë Bankës Qendrore të Kosovës.
3. Në rast se, kontraktuesi i sigurimit nuk është i kënaqur me vendimin e forumit të pavarur të arbitrazhit atëherë ai ka të drejtë që në pajtim me rregulloret në fuqi t'i drejtohet gjyqit përkatës me kërkesën për anulimin e vendimit të atij forumi.

Neni 21

Ndryshimi i kushteve të sigurimit apo i tarifës së primit

1. Nëse siguruesi ka ndryshuar kushtet e sigurimit apo tarifën e primit, atëherë ai duhet që për këtë ndryshim të lajmërojë kontraktuesin e sigurimit të paktën 60 ditë para përfundimit të vitit aktual të sigurimit.
2. Kontraktuesi i sigurimit ka të drejtë që, brenda 60 ditëve pas marrjes së njoftimit ta shkëpusë kontratën, me çka kontrata pas përfundimit të vitit aktual të sigurimit bëhet e pavlefshme.
3. Në rast se kontraktuesi i sigurimit nuk e shkëputë kontratën, atëherë me fillimin e vitit të ardhshëm(vitit pasues) të sigurimit, për këtë kontratë janë të vlefshme kushtet e reja të sigurimit dhe tarifa e re e primit.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga stuhia (ASTB_KS12 / niveli 2)

Pjesa e përgjithshme

Për këtë sigurim vlejnë kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë(ABV_KS12).

Pjesa e veçantë

Përmbajtja

- | | | |
|------|----|---|
| Neni | 1 | Rreziket dhe dëmet e siguruara |
| Neni | 2 | Dëmet e pasiguruara |
| Neni | 3 | Sendet dhe shpenzimet e siguruara |
| Neni | 4 | Shtrirja territoriale vlefshmërisë së sigurimit |
| Neni | 5 | Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi |
| Neni | 6 | Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi |
| Neni | 7 | Vlera e sigurimit |
| Neni | 8 | Dëmshpërblimi |
| Neni | 9 | Nësigurimi |
| Neni | 10 | Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja |
| Neni | 11 | Ekspertiza |
| Neni | 12 | Regresi |

Neni 1 Rrezikët dhe dëmet e siguruar

1. Rrezikët e siguruar

- 1.1. Stuhia; Stuhia është lëvizja e ajrit e kushtëzuar nga moti, shpejtësia e së cilës në vendin e sigurimit është më e lartë se sa 62 km/h.

Për konstatimin e shpejtësisë së erës merret parasysh informacioni i institutit meteorologjik.

- 1.2. Breshëri; Breshëri është një reshje atmosferike e kushtëzuar nga moti, që bie në formë të kokrrave të akullta.

- 1.3. Shtypja(presioni) i borës; Shtypja(presioni) i borës është ndikimi i forcës nga masat e borës apo masat e akullit të cilat janë mbledhur në mënyrë të natyrshme dhe janë në gjendje të qetë(nuk janë në lëvizje e sipër).

- 1.4. Shembja e shkëmbit/Godilja e gurit; Shembja e shkëmbit/Godilja e gurit është shpëputja dhe rënia e natyrshme e masave të gurtës në terren.

- 1.5. Rrëshqitja e dheut; Rrëshqitja e dheut është lëvizja teposhtë e masave të dheut apo atyre shkëmbore(të gurëve) e shkaktuar nga natyra e që bëhet nëpër shtegun e rrëshqitshëm që gjendet nën sipërfaqe.

2. Dëmet e siguruar

Të siguruar janë dëmet në sende, të cilat

- 2.1. ndodhin nga ndikimi i drejtpërdrejtë i një rreziku të siguruar(ngjarja e siguruar).

Bëhet fjalë për ndikim të drejtpërdrejtë edhe kur pjesë të ndërtesës, trupa drurësh, shtylla apo të ngjashme hidhen në sendet e siguruar;

- 2.2. ndodhin si pasojë e paevitueshme e një ngjarje të siguruar;

- 2.3. ndodhin kur sendet dalin nga dora, si pasojë e një ngjarje të siguruar.

Neni 2 Dëmet e pasiguruar

Të pasiguruar po ashtu edhe kur vinë si pasojë e paevitueshme e ndonjë ngjarje të siguruar, janë:

1. dëmet nga zjarri, rufeja, eksplodimi apo rënia e fluturakeve;
2. dëmet nga ortelet, apo shtypja e ajrit nga ortelet, nga përmbysja(vërshimi) prej stuhisë, fryrja e ujërave, përmblyrja(vërshimi) apo rrëketë;

3. dëmet nga ndikimi i vorbullës thithëse apo shtypjes që krijohet nga mjetet fluturuese ajrore apo të ato të hapësirës;

4. dëmet nga uji dhe dëmet e ujërave që në pamundësisë të bartjes së tyre nga kanalizimi, rrjedhin mbi kanalizim.

dëmet nga uji i shkrirë apo i reshjeve, janë megjithatë të siguruar nëse uji hyn në ndërtesë përmes pjesëve të forta të ndërtesës, përmes dyerve të jashtme/dritareve të mbyllura siç duhet, e që janë dëmtuar apo shkatërruar nga rasti i dëmit;

5. dëmet nga lëvizja e masave të dheut apo e atyre shkëmbore(gurorë) nëse kjo lëvizje është shkaktuar nga veprimtaria ndërtimore apo e rrënimjes;

6. dëmet nga ulja e tokës;

7. dëmet nga ndikimi në vazhdim(jo i menjëhershëm) i motit apo i ambientit;

8. dëmet pa pasojë në përdorshmërinë, funksionimin apo jetëgjatësinë e sendeve;

9. dëmet që janë shkaktuar në atë mënyrë që,

- ndërtimet e siguruar apo pjesë të tyre kanë qenë në gjendje të keqe ndërtimi,

- gjatë ndërtimeve të reja, atyre shtesë apo adoptimeve të ndërtimeve, pjesë të tyre nuk kanë qenë të lidhura apo ende nuk kanë qenë të lidhura me ndërtimin tjetër, apo pjesë të lidhjes me atë ndërtim janë shpëputur;

10. dëmet nga ndikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i

- 10.1. Luftës së çdo forme - me ose pa shpallje të luftës, duke ia bashkangjitur kësaj edhe të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve, dhe organizatave politike apo terroriste;

- 10.2. trazirave të brendshme, luftës qytetare, revolucionit, rebelimit, turbullirave, kryengritjes;

- 10.3. veprimeve ushtarake dhe veprimeve të autoriteteve tjera, që lidhen me ngjarjet e përmendura në pikat 10.1. dhe 10.2. të këtij neni;

- 10.4. Tërmetit apo ngjarjeve të tjera të pazakonshme natyrore;

- 10.5. Energjisë bërthamore, izotopeve radioaktive apo rrezatimit jonizues.

- 10.6. Është obligim i kontraktuesit të sigurimit, të dëshmojë se dëmi i ndodhur, nuk vjen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e ndonjë rësie/disave nga ngjarjet e përmendura në pikat 10.1. deri 10.5 apo e gjendjes së shkaktuar nga ato ngjarje.

Neni 3 Sendet dhe shpenzimet e siguruar

1. Sendet e siguruar

- 1.1. Të siguruar janë sendet e shënuara në policë, e që janë pronë e kontraktuesit të sigurimit apo që i janë shitur dhe dhënë mirëpo duke mos ia kaluar pronësinë në to, apo i janë dhënë si garanci(hipotekë).

- 1.2. Sendet e huaja janë të siguruar vetëm nëse për to ka një marrëveshje të veçantë, dhe vetëm atëherë kur për to nuk mund të merret dëmshpërblim nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.

Kur bëhet fjalë për vlerën e sigurimit të sendeve të huaja, kryesori është interesi i pronarit, përveç nëse me marrëveshje nuk është ndryshe e rregulluar.

- 1.3. Sendet që sigurohen vetëm me marrëveshje të veçantë:

- 1.3.1. veshjet e të gjitha llojeve me xhama qelqi dhe me xhama nga materialet tjera artificiale si plastika, e po ashtu edhe kupolat e dritës(për dritë);

- 1.3.2. Pajisjet e vendosura përjashta si p.sh.: shenjat e firmës, dhe reklamat, ndriçimi i jashtëm, rrethojat, antenat, pajisjet solare, markizat(tendat);

- 1.3.3. sendet e lëvizshme përjashta si dhe gjatë transportimit.

2. Shpenzimet e siguruar

- 2.1. Shpenzimet për masat që kontraktuesi i sigurimit i shpreh si të domosdoshme dhe i ndërmerr në rast se ndodh ngjarja e siguruar për të evituar apo zvogëluar dëmin, madje edhe në qoftë se ato nuk japin rezultat.

Shuma e kompensimit për shpenzimet e siguruar dhe dëmshpërblimit për sendet e siguruar nuk mund të jetë më e madhe se sa shumata e sigurimit. Kjo nuk vlen për ato masa për të cilat sigurosi ka dhënë instruksion konkret për ndërmarrjen e tyre.

2.2. Vetëm përmes marrëveshjes së veçantë janë të siguruar:

- 2.2.1. Shpenzimet e lëvizjes dhe të mbrojtjes, këto janë shpenzime, që krijohen për shkak të nevojës për të lëvizur ndryshuar apo mbrojtur sendet tjera në mënyrë që sendet e siguruar të mund të rikthehen në gjendje e mëparshme apo të riblehen; këto janë veçanërisht shpenzimet për de- dhe rimontimin e makinave apo të pajisjeve/implanteve si dhe shpenzimet për penetrimin, demolimin/shkatërrimin dhe rindërtimin e pjesëve të ndërtesës.

- 2.2.2. Shpenzimet e demolimit/shkatërrimit dhe të vënies rend(rregull), këto janë shpenzimet për punën e kryer në vendin e sigurimit, me kusht që këto shpenzime t'u përkasin sendeve të siguruar, dhe atë për shkatërrimin/demolimin e nevojshëm e pjesëve të mbetura e të dëmtuara, si dhe për heqjen dhe sortimin e mbetjeve dhe të mbeturinave. Këtu nuk hyjnë shpenzimet për transportimin dhe deponimin e atyre mbetjeve dhe mbeturinave – sipas pikës 2.2.3.

- 2.2.3. Shpenzimet e transportimit dhe deponimit, këto janë shpenzimet për kontrollimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin e sendeve të siguruar e të dëmtuara.

2.3. Të pasiguruar janë:

- 2.3.1. Shpenzimet që krijohen si pasojë e dëmtimit të shëndetit gjatë kryerjes së obligimit të shpëtimt;

- 2.3.2. Shpenzimet për shërbimet me interes publik ose të urdhëruara nga autoritetet, e që kanë të bëjnë me aktivitetin e zjarrfikësve dhe personave të tjerë në detyrë.

Neni 4 Shtrirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit

Sendet e lëvizshme janë të siguruar vetëm në hapësirat e siguruar të cekura në policë(=vendi i sigurimit). Nëse këto largohen nga vendi i sigurimit, atëherë mbrojtja e sigurimit pezullohet. Nëse largimi i tyre është permanent, atëherë kontrata e sigurimit për ato sende, shuhet.

Neni 5

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi

1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar që t'i mirëmbajë sendet e siguruar dhe tek ndërtesa(objekti) i siguruar posaçërisht të kujdeset për mbajtjen në gjendje të mirë të kulmit.
2. Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë sigurosin për secilin dëm që i është shkaktuar sigurosit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 6

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

1. Obligimi i zvogëlimit të dëmit

- 1.1. Në rast të dëmit apo të kërcënimit direkt që dëmi të ndodhë, kontraktuesi i sigurimit duhet që sipas mundësive

- të kujdeset që të ruaj, shpëtojë dhe rikthejë sendet e siguruar;

- për këtë të marrë udhëzime nga sigurosi dhe t'u përmbahet atyre udhëzimeve.

- 1.2. Në rast të humbjes së librezave të kursimit apo të letrave me vlerë, duhet kërkuar menjëherë mbyllja e tyre(të bëhet e pamundur tërheqja e parave) në institucionin përkatës, dhe nëse është e mundur të fillohet procedura gjyqësore për shpalljen e tyre të pavlefshme.

2. Obligimi i lajmërimit të dëmit

Secili dëm duhet lajmëruar menjëherë tek siguruesi, dhe rasti duhet treguar pranë autoriteteve të sigurisë (lajmëruar në polici). Tek tregimi që bëhet tek autoritetet e sigurisë (policia), duhet lajmëruar/dhënë në evidencë pajtjetër të gjitha sendet e dala nga dora.

3. Obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit

3.1. Siguruesit duhet mundësuar nëse kjo është e mundur çdo helim për përcaktimin e shkakut dhe lartësisë së dëmit të siguruar, apo të mbulesës siguruese të tij.

3.2. Gjatë procesit të përcaktimit të dëmit, siguruesit duhet dhënë mbështetjen e nevojshme, dhe nëse nga ai kërkohet t'i jepen në shfrytëzim dokumentet përkatëse. Shpenzimet për këto i mban kontraktuesi i sigurimit.

3.3. Gjendja e cila ka ardhur si pasojë e dëmit të shkaktuar, nuk guxon të ndryshohet pa lejen e siguruesit para se të përcaktohet dëmi, përveç nëse një ndryshim i kësaj gjendjeje është i domosdoshëm për të zvogëluar apo mbajtur sa më të vogël dëmin, apo nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit publik.

4. Pasojat ligjore në rast të shkeljes së detyrimeve të kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhvendosë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 7 Vlera e sigurimit

1. Rregullat speciale rreth vlerës së sigurimit

1.1. Si vlerë e sigurimit tek ndërtesat mund të kontraktohet::

1.1.1. vlera e re,

Me vlerë të re, të një ndërtese, nënkuptohet vlera e shpenzimeve që janë të zakonshme për atë vend, për planifikimin, konstruktimin dhe rindërtimin e asaj ndërtese;

1.1.2. vlera e kohës.

Vlera e kohës e një ndërtese llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të asaj ndërtese i hiqet vlera e caktuar që i përshlatet gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së saj;

1.1.3. vlera e tregut.

Vlera e tregut e një ndërtese, është vlera e arritshme e shitjes së saj, ku megjithatë vlera e trualit ku gjendet ndërtesa nuk merret parasysh.

1.2. Tek sendet e përdorimit dhe tek pajisjet e ndërmarrjeve, si vlerë e sigurimit mund të kontraktohet :

1.2.1. vlera e re.

Me vlerë të re nënkuptohen shpenzimet e riblerjes së sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë);

1.2.2. vlera e kohës.

Vlera e kohës llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të sendit i hiqet vlera e caktuar që i përshlatet gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së sendit;

1.2.3. vlera e tregut.

Vlera e tregut është çmimi i arritshëm i shitjes së një sendi.

1.3. Tek mallrat dhe rezervat/stoqet, vlerë e sigurimit llogaritet shpenzimet për riprodhimin / riblerjen e sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë).

Nëse tek mallrat dhe rezervat/stoqet, çmimi i arritshëm i shitjes është më i ulët se sa shpenzimet/kostoja e riprodhimit apo riblerjes, atëherë vlerë e sigurimit llogaritet çmimi i arritshëm i shitjes.

1.4. Vlerë e sigurimit tek

- paratë dhe vlerat monetare, vlen vlera nominale,
- librezat e kursimit pa fjalëkalim, vlen shuma e depozitës (gjendjes në plus),
- librezat e kursimit me fjalëkalim, vlejën shpenzimet për procedurën e shpalljes së pavlefshme të asaj librezë,
- letrat me vlerë me kurs zyrtar, vlen vlera e regjistruar (fiksuar), e fundit zyrtare,
- letrat tjera me vlerë, vlen vlera e tregut.

1.5. Vlera e sigurimit tek mbajtësit e të dhënave bashkë me programet dhe të dhënat që janë të ruajtura në to, niset ndihmëse për reproduktim, dëftesat, modelet, prototipat dhe të ngjashme që po ashtu janë të ruajtura në to, është vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre.

1.6. Vlera e sigurimit të automjeteve të lëvizjes nëpër tokë, ujë dhe ajër, e që janë të lejuara nga autoritetet, është vlera e tregut.

1.7. Vlerë e sigurimit e sendeve tjera të lëvizshme, që nuk janë përmendur në pikat 1.2. deri 1.6., është vlera e tregut.

2. Rregullat e përgjithshme të vlerës së sigurimit

2.1. Pavarësisht nga rregullat nga pika 1.1. deri në 1.7., vlera e sigurimit është të paktën vlera e tregut:

2.1.1. tek sendet me vlerë historike apo artistike, tek të cilat vjetërsia nuk çon zakonisht në humbje të vlerës;

2.1.2. tek sendet e lëvizshme, që huazohen (jepen me qira) për aktivitet biznesi si p.sh. librat, makinat, videofilmat dhe aparaturat.

2.2. Gjatë përcaktimit të vlerës së sigurimit, nuk merret parasysh vlera e pasionit personal për sendin.

Neni 8 Dëmshtëpërlimi

Për ndërtesat, sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve (neni 7. pikat 1.1. dhe 1.2.) palët janë pajtuar që:

1.1. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e re, sipas nenit 7, atëherë,

1.1.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.1.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit (vlera e re), e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

1.1.3. Nëse vlera e kohës, e sendit të prekur nga dëmi, në momentin para se dëmi të ndodhte ka qenë më e vogël se 40% e vlerës së re, atëherë kompensohet më së shumti vlera e kohës.

1.1.4. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë, atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

Një ndërtesë është veçanërisht atëherë, pakthyeshmërisht e zhvlefësuar, nëse është vendosur që të rrënohet, ose përgjithësisht nuk është më e shfrytëzueshme, apo veçanërisht nuk është e shfrytëzueshme për qëllimin e paraparë.

Sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve, janë posaçërisht atëherë përgjithmonë të zhvlefësuar, kur janë larguar nga procesi i punës, apo në përgjithësi nuk janë më të përdorueshme, ose nuk janë më të përdorueshme për qëllimin e tyre ekonomik.

1.2. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e kohës, sipas nenit 7, atëherë,

1.2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.2.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e zvogëluar e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit dhe atë e zvogëluar në raportin vlera e kohës me vlerën e re, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

1.2.3. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë (pika 1.1.4.), atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

1.3. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e tregut, sipas nenit 7, atëherë,

1.3.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.3.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e zvogëluar e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit dhe atë e zvogëluar në raportin vlera e tregut me vlerën e re, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

2. Për mallrat dhe rezervat/stoqet (neni 7, pika 1.3.)

2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

2.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

2.3. në rast se çmimi i arritshëm i shitjes në momentin para se të ndodhë dëmi, duke i hequr atij shpenzimet e kursyera, ka qenë më i ulët se shpenzimet për riprodhimin apo riblerjen, atëherë kompensohet më së shumti kjo vlerë më e vogël.

3. Për paratë dhe vlerat monetare, librezat e kursimit dhe letrat me vlerë (neni 7, pika 1.4.) kompensohen shpenzimet për riblerjen e tyre e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

4. Për mbajtësit e të dhënave dhe të ngjashme (neni 7, pika 1.5.) kompensohet vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre, nëse rikthimi i tyre është i nevojshëm, dhe kryhet brenda afatit kohor prej dy vitesh nga çasti kur ka ndodhur dëmi. Në rast të kundërt kompensohet vetëm vlera e materialit.

5. Për automjetet, dhe sendet tjera të lëvizshme (neni 7, pikat 1.6., 1.7. dhe 2.1.)

5.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit para momentit kur ka ndodhur ngjarja e siguruar;

5.2. në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

6. Për shpenzimet e siguruar (neni 3, pika 2.), kompensohen shpenzimet e shkaktuara.

7. Rregullat e përgjithshme për dëmshtëpërlimin

7.1. Nëse përmes riparimit (ndreqjes/rregullimit) të një sendi, vlera e tij aktuale e sigurimit, në krahasim me vlerën e tij të sigurimit në momentin para dëmtimit ngritet (ritet), atëherë kompensimi për riparimin zvogëlohet për vlerën e diferencës mes atyre dy vlerave..

- 7.2. **Vlera e mbetjes** llogaritet po ashtu; Kufizimet e autoriteteve për rindërtim apo për riblerje nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të mbetjeve.
- 7.3. Për sendet e dala nga dora dhe të gjetura përsëri vlejnë marrëveshja se:
- 7.3.1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar të marrë këto sende, nëse kjo mund të kërkohej (nuk është jashtë mase/e tepërt të kërkohej) nga ai.
- 7.3.2. Nëse sendet gjinden përsëri dhe i kthehen kontraktuesit të sigurimit, dhe atë pasi që është bërë zhdëmtimi, atëherë kontraktuesi i sigurimit duhet të kthejë një shumë të caktuar, e cila llogaritet ashtu, që: vlerës së marrë për zhdëmtim i hiqet vlera e mundshme e zhvlerësimit (amortizimit) të sendit, dhe mbetja është vlera që duhet kthyer. Sendet për të cilat nuk mund të kërkohej (do të ishte e tepërt të kërkohej) nga kontraktuesi i sigurimit që t'i marrë prapë, duhet të kalojnë në pronësi të siguruesit.
- 7.4. Tek sendet e veçanta, të cilat bashkë me sende tjera përbëjnë një tërësi (komplet), zhvlerësimi i sendeve të veçanta të padëmtuara, që vjen si pasojë e dëmtimit, shkatërrimit apo daljes nga dora e sendeve tjera, që bashkë me të përbëjnë tërësinë, nuk merret parasysh.

Neni 9 Nën sigurimi

Lartësia e dëmshpërblimit të llogaritur sipas nenit 7, zvogëlohet sipas normave të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12), nëse ka nën sigurim; kjo nuk vlen, nëse bëhet fjalë për një sigurim në rrezik të parë.

Neni 10 Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja

1. Kontraktuesi i sigurimit ka fillimisht të drejtën që:

1.1. për ndërtesat

- 1.1.1. në rast të shkatërrimit të kompensohet me vlerën e kohës, e më së shumti me vlerën e tregut;
- 1.1.2. në rast të dëmtimit t'i kompensohet lartësia e dëmit në vlerën e kohës, e më së shumti lartësia e dëmit në vlerën e tregut.

1.2. për sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve

- 1.2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora të zhdëmtohet me vlerën e kohës;
- 1.2.2. në rast të dëmtimit, të zhdëmtohet me lartësinë e dëmit sipas vlerës së kohës.

1.3. Lartësia e dëmit sipas vlerës së kohës, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e kohës me vlerën e re.

Lartësia e dëmit sipas vlerës së tregut, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e tregut me vlerën e re.

2. Të drejtën për zhdëmtim, kur ai tejkalon lartësinë e rregulluar me pikën 1 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit e fiton vetëm atëherë nëse kushtet e mëposhtme plotësohen:

2.1. është siguruar, që pagesa e zhdëmtimit do të përdoret në tërësi për rindërtimin/riprodhimin apo riblerjen.

Sendet të cilat para se të ndodhte dëmi, veç kanë qenë të prodhuara, blera, apo të porositura, apo kanë qenë në prodhim e sipër, nuk vlejnë si të rindërtuara/riprodhuara apo të riblera;

2.2. rindërtimi i ndërtesës bëhet në të njëjtin vend si më parë. Nëse ndërtimi në të njëjtin vend është ndaluar nga ana e autoriteteve (nuk guxon të ndërtohet aty), atëherë mjafton të bëhet rindërtimi në një vend tjetër në Kosovë;

2.3. sendet e rindërtuara/riprodhuara apo të riblera, përdoren për qëllimin e njëjtë si ato më parë (për të cilat paguhet zhdëmtimi);

2.4. rindërtimi/riprodhimi apo riblerja kryhet brenda afatit kohor prej tri vitesh, nga momenti kur ka ndodhur ngjarja e siguruar.

Neni 11 Ekspertiza

Kur është fjalë për ekspertizën, si shtesë e rregullave të kushteve të përgjithshme të sigurimeve të pasurisë (ABV_KS12), futen edhe marrëveshjet në vazhdim:

1. Konkluzioni e të dy ekspertëve duhet të përmbajë pajtësi, edhe vlerën e momentit para rastit të dëmit, të sendeve të prekura nga rasti i dëmit, si dhe vlerën e mbetjeve të tyre.

2. Me kërkesën e cilës do palë kontraktuese, duhet përcaktuar edhe vlera e sigurimit të sendeve të siguruara, e të paprekura nga rasti i dëmit.

Neni 12 Regresi

Kur siguruesi, i kompenson dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguruesi.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga uji i tubacioneve (AWB_KS12 / niveli 2)

Pjesa e përgjithshme

Për këtë sigurim vlejnë kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12).

Pjesa e veçantë

Përmbajtja

- | | | |
|------|----|---|
| Neni | 1 | Rreziqet dhe dëmet e siguruara |
| Neni | 2 | Dëmet e pasiguruara |
| Neni | 3 | Sendet dhe shpenzimet e siguruara |
| Neni | 4 | Shtirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit |
| Neni | 5 | Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi |
| Neni | 6 | Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi |
| Neni | 7 | Vlera e sigurimit |
| Neni | 8 | Dëmshpërblimi |
| Neni | 9 | Nën sigurimi; Sigurimi copëz |
| Neni | 10 | Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja |
| Neni | 11 | Ekspertiza |
| Neni | 12 | Regresi |

Neni 1

Rreziqet dhe dëmet e siguruara

1. Të siguruara janë dëmet në sende, të cilat ndodhin nga ndikimi i drejtpërdrejtë i ujit të tubacioneve, i cili rrjedh nga gypat e ujit, nga armaturat, apo pajisjeve të lidhura në to. Këto dëme vlejnë si ngjarje dëmi.

Të siguruara janë po ashtu dëmet në sende, e që janë pasojë e paevitueshme e ngjarjes së dëmit.

2. Vetëm tek sigurimi i ndërtesave, llogaritet po ashtu ngjarje dëmi edhe:

- 2.1. dëmi nga ngrirja në tubat e ujit, armaturat apo pajisjet e lidhura në to.
- 2.2. dëmi nga thyerja e tubave të ujit.

Neni 2

Dëmet e pasiguruara

Dëme të pasiguruara, madje edhe nëse ato vinë si pasojë e paevitueshme e ngjarjes së dëmit, janë:

- Dëmet që kanë ndodhur para fillimit të mbrojtjes siguruese, madje edhe nëse ato vërehen lek pasi të ketë filluar mbrojtja siguruese;
- dëmet nga thyerja e tubacioneve të ujit si pasojë e korrozionit, apo e amortizimit/konsumimit;
- dëmet nga thyerja e tubacioneve të ujit jashtë ndërtesës;
- dëmet nga thyerja në armatura apo pajisjet e lidhura në tubacionet e ujit (këto janë posaçërisht rubinetet, matësit e shpenzimit të ujit, mbajtësit e ujit, vaskat, (govata e dushit), lavamanët, turratët e tualetit, kaloriferët/radiatorët, bojlerët, kolektorët solar që mbajnë ujë, ngrohjet e mureve me ujë, pajisjet e klimës me ujë, pishinat); këto dëme megjithatë janë të siguruara, nëse thyerja vjen si pasojë e ngrirjes;
- dëmet në pajisjet, të cilat përdoren vetëm për përcjelljen e të reshurave;
- dëmet në apo nga sistemi i tubacioneve të ngrohjes së dyshemesë;
- dëmet në apo dëmet nga pajisjet solare që mbajnë ujë;
- dëmet në apo dëmet nga pajisjet për klimatizim e të cilat mbajnë ujë;
- dëmet në apo dëmet nga pajisjet spërkatëse (për fikjen e zjarrit);
- dëmet nga dalja e ujit nga pishina;
- dëmet në mallra që gjenden nën nivelin e sipërfaqes së tokës, e të cilat nuk kanë qenë të vendosura të pakllën 12 cm. mbi dysheme;
- mënjanimi i bllokimeve të tubacioneve të cilësdo formë;
- humbja e ujit, humbja e qirasë apo çfarëdo dëmi tjetër i tërthortë apo jo i menjëhershëm;
- dëmet nga ujërat nëntokësore (nën sipërfaqe), fryrja e ujërave, vërshimet, rrëketë, ujërat e të reshurave dhe dëmet e ujërave që si pasojë e të reshurave dhe pamundësisë së bartjes së tyre nga kanalizimi, rrjedhin mbi kanalizim;
- dëmet nga prishja e drunjve, kalbja e tyre apo krijimi i myshkut në to;
- dëmet nga zjarri, rrufeja, eksplozimi apo rënia e fluturakeve.
- dëmet nga ndikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i
- Luftës së çdo forme - me ose pa shpallje të luftës, duke ia bashkangjitur kësaj edhe të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve, dhe organizatave politike apo terroriste;
- trazirave të brendshme, luftës qytetare, revolucionit, rebelimit, turbullirave, kryengritjes;

17.3. veprimeve ushtarake dhe veprimeve të autoriteteve tjera, që lidhen me ngjarjet e përmendura në pikat 17.1. dhe 17.2. të këtij neni;

17.4. Tërmetit apo ngjarjeve të tjera të pazakonshme natyrore;

17.5. Energjisë bërthamore, izotopeve radioaktive apo rrezatimit jonizues.

Për pikën 17 vlen: Është obligim i kontraktuesit të sigurimit, të dëshmojë se dëmi i ndodhur, nuk vjen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e lëtrhorthë, e ndonjërs/disave nga ngjarjet e përmendura në pikat 17.1. deri 17.5 apo e gjendjes së shkakuar nga ato ngjarje.

Neni 3

Sendet dhe shpenzimet e siguruar

1. Sendet e siguruar

1.1. Të siguruar janë sendet e shënuara në policë, e që janë pronë e kontraktuesit të sigurimit apo që i janë shitur dhe dhënë mirëpo duke mos ia kaluar pronësinë në to apo i janë dhënë si garanci(hipotekë).

1.2. Sendet e huaja janë të siguruar vetëm nëse për to ka një marrëveshje të veçantë, dhe vetëm atëherë kur për to nuk mund të merret dëmshpërblim nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.

Tek vlera e sigurimit për sigurimin e sendeve të huaja, kryesori është interesi i pronarit, përveç nëse me marrëveshje nuk është ndryshe e rregulluar.

2. Shpenzimet e siguruar

2.1. Shpenzimet për masat që kontraktuesi i sigurimit i sheli si të domosdoshme dhe i ndërmerr në rast se ndodh ngjarja e siguruar për të evituar apo zvogëluar dëmin, madje edhe në qoftë se ato nuk japin rezultat.

Shuma e kompensimit për shpenzimet e siguruar dhe dëmshpërblimit për sendet e siguruar nuk mund të jetë më e madhe se sa shuma e sigurimit. Kjo nuk vlen për ato masa për të cilat sigurosi ka dhënë instruksion konkret për ndërmarrjen e tyre.

2.2. Vetëm tek sigurimi i ndërtesave janë të siguruar:

2.2.1. Shpenzimet e shkrirjes;

2.2.2. Shpenzimet e lëvizjes, këto janë shpenzime që krijohen nga ngjarja e dëmit për të gjetur vendin e dëmit, bashkë me shpenzimet e mënjanimi të dëmeve të shkakutara gjatë atij kërkimi.

2.3. Vetëm përmes marrëveshjes së veçantë janë të siguruar:

2.3.1. Shpenzimet e lëvizjes dhe të mbrojtjes, këto janë shpenzime, që krijohen për shkak të nevojës për të lëvizur ndryshuar apo mbrojtur sendet tjera në mënyrë që sendet e siguruar të mund të rikthehen në gjendjen e mëparshme apo të riblen; këto janë veçanërisht shpenzimet për de- dhe rimontimin e makinave apo të pajisjeve/implanteve si dhe shpenzimet për penetrimin, demolimin/shkatërrimin dhe rindërtimin e pjesëve të ndërtesës.

2.3.2. Shpenzimet e demolimit/shkatërrimit dhe të vënies rend(rregull), këto janë shpenzimet për punën e kryer në vendin e sigurimit, me kusht që këto shpenzime t'u përkasin sendeve të siguruar, dhe atë për shkatërrimin/demolimin e nevojshëm e pjesëve të mbetura e të dëmtuara, si dhe për heqjen dhe sortimin e mbetjeve dhe të mbeturinave. Këtu nuk hyjnë shpenzimet për transportimin dhe deponimin e atyre mbetjeve dhe mbeturinave – sipas pikës 2.3.3.

2.3.3. Shpenzimet e transportimit dhe deponimit, këto janë shpenzimet për kontrollimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin e sendeve të siguruar e të dëmtuara.

2.4. Të pasiguruar janë:

2.4.1. Shpenzimet që krijohen si pasojë e dëmtimit të shëndetit gjatë kryerjes së obligimit të shpëtimit;

2.4.2. Shpenzimet për shërbimet me interes publik ose të urdhëruara nga autoritetet, e që kanë të bëjnë me aktivitetin e zjarfikësve dhe personave të tjerë në detyrë.

Neni 4

Shtirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit

Sendet e lëvizshme janë të siguruar vetëm në hapësirat e siguruar të cekura në policë(=vendi i sigurimit). Nëse këto largohen nga vendi i sigurimit, atëherë mbrojtja e sigurimit pezullohet. Nëse largimi i tyre është permanent, atëherë kontrata e sigurimit për ato sende, shuhet.

Neni 5

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi

1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar që t'i mirëmbajë sendet e siguruar e posaçërisht të kujdeset për mirëmbajtjen e tubacioneve të ujit, të kanalizimit, armaturave, si dhe pajisjeve të lidhura me to dhe të fugave(ngjitjeve) të silikonit.

2. Nëse ndërtesën e lëshojnë të gjithë personat për më gjatë se 72 orë, atëherë duhet mbyllur të gjitha tubat e ujit(duhet ndaluar uji) dhe duhet ndërmarrë masat e nevojshme për të mos ardhur deri tek dëmet nga ngjarja.

Si masa të përshtatshme kundër dëmeve të ngrirjes vlejné, ngrohja e mjaftueshme dhe mbikëqyrur e rregullt e hapësirave të siguruar, apo zbrazja e rregullt e sistemit të ujit.

Tubacionet që qojnë tek pajisjet e sigurisë(si p.sh: pajisjet spërkatëse për fikjen e zjarrit, apo hidrantët për zjarfikësit), nuk duhet të mbyllen paljetor. Megjithatë edhe në këtë rast duhet ndërmarrë masat e nevojshme që të mos vjen deri tek dëmet nga ngrirja.

3. Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë siguruesin për secilin dëm që i është shkakuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 6

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

1. Obligimi i zvogëllimit të dëmit

Në rast të dëmit apo të kërcënimit direkt që dëmi të ndodhë, kontraktuesi i sigurimit duhet që sipas mundësive,

- të kujdeset që të ruaj dhe shpëtojë sendet e siguruar ;
- për këtë të marrë udhëzime nga sigurosi dhe t'u përmbahet atyre udhëzimeve.

2. Obligimi i lajmërimit të dëmit

Secili dëm duhet lajmëruar menjëherë tek sigurosi.

3. Obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit

3.1. Sigurosi duhet mundësuar nëse kjo është e mundur çdo helim për përcaktimin e shkakut dhe lartësisë së dëmit të siguruar, apo të mbulesës sigurose të tij.

3.2. Gjatë procesit të përcaktimit të dëmit, sigurosit duhet dhënë mbështetjen e nevojshme, dhe nëse nga ai kërkohet t'i jepen në shfrytëzim dokumentet përkatëse. Shpenzimet për këto i mban kontraktuesi i sigurimit.

3.3. Gjendja e cila ka ardhur si pasojë e dëmit të shkakuar, nuk guxon të ndryshohet pa lejen e sigurosit para se të përcaktohet dëmi, përveç nëse një ndryshim i kësaj gjendjeje është i domosdoshëm për të zvogëluar apo mbajtur sa më të vogël dëmin, apo nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit publik.

4. Pasojat ligjore në rast të shkeljes së detyrimeve të kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

Nëse kontraktuesi i sigurimit shkel ndonjëherë nga këto obligime, atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë siguruesin për secilin dëm që i është shkakuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 7

Vlera e sigurimit

1. Rregullat speciale rreth vlerës së sigurimit

1.1. Vlera e sigurimit tek ndërtesat është vlera e re.

Me vlerë të re, të një ndërtese, nënkuptohet vlera e shpenzimeve që janë të zakonshme për atë vend, për planifikimin, konstruktimin dhe rindërtimin e asaj ndërtese.

1.2. Vlera e sigurimit tek sendet e përdorimit dhe tek pajisjet e ndërmarrjeve, është vlera e re.

Me vlerë të re nënkuptohen shpenzimet e riblerjes së sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi(klasë).

1.3. Tek mallrat dhe rezervat/stoqet, vlerë e sigurimit llogariten shpenzimet për riprodhimin / riblerjen e sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi(klasë).

Nëse tek mallrat dhe rezervat/stoqet, çmimi i arritshëm i shitjes është më i ulët se sa shpenzimet/kostoja e riprodhimit apo riblerjes, atëherë vlerë e sigurimit llogaritet çmimi i arritshëm i shitjes.

1.4. Si vlerë sigurimi tek

- paratë dhe vlerat monetare, vlen vlera nominale,
- librezat e kursimit pa fjalëkalim, vlen shuma e depozitës(gjendjes në plus),
- librezat e kursimit me fjalëkalim, vlejné shpenzimet për procedurën e shpalljes së pavlefshme të asaj librezë,
- letrat me vlerë me kurs zyrtar, vlen vlera e regjistruar(fiksuar), e fundit zyrtare,
- letrat tjera me vlerë, vlen vlera e tregut.

1.5. Vlera e sigurimit tek mbajtësit e të dhënave bashkë me programet dhe të dhënat që janë të ruajtura në to, mjetet ndihmëse për riprodhim, dëftesat, modelet, prototipat dhe të ngjashme që po ashtu janë të ruajtura në to, është vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre.

1.6. Vlera e sigurimit të automjeteve të lëvizjes nëpër tokë, ujë dhe ajër, e që janë të lejuara nga autoritetet, është vlera e tregut.

Vlera e tregut është çmimi i arritshëm i shitjes së një sendi.

1.7. Vlerë e sigurimit e sendeve tjera të lëvizshme, që nuk janë përmendur në pikat 1.2. deri 1.6., është vlera e tregut.

2. Rregullat e përgjithshme të vlerës së sigurimit

2.1. Pavarësisht nga rregullat nga pika 1.1. deri në 1.7., vlera e sigurimit është të paktën vlera e tregut:

2.1.1. tek sendet me vlerë historike apo artistike, tek të cilat vjetërsia nuk qon zakonisht në humbje të vlerës;

2.1.2. tek sendet e lëvizshme, që huazohen(jepen me qira) për aktivitet biznesi si p.sh. librat, makinat, videofilmat dhe aparaturat;

2.2. Gjatë përcaktimit të vlerës së sigurimit, nuk merret parasysh vlera e pasionit personal për sendin.

Neni 8 Dëmtshpërblimi

1. Për ndërtesat, sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve (neni 7, pikat 1.1. dhe 1.2.);

1.1. në rast të shkatërrimit, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit(vlera e re), e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

1.3. Nëse vlera e kohës, e sendit të prekur nga dëmi, në momentin para se dëmi të ndodhte ka qenë më e vogël se 40% e vlerës së re, atëherë kompensohet më së shumti vlera e kohës.

Vlera e kohës llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të sendit i hiqet vlera e caktuar që i përshtatet gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së tij.

1.4. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë, atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

Vlera e tregut është vlera e arritshme e shitjes, ku tek ndërtesat duhet pasur parasysh që vlera e truallit ku gjendet ndërtesa nuk merret parasysh.

Një ndërtesë është veçanërisht atëherë, pakthyeshmërisht e zhvlerësuar, nëse është vendosur që të rrënohet, ose përgjithësisht nuk është më e shfrytëzueshme, apo veçanërisht nuk është e shfrytëzueshme për qëllimin e paraparë.

Sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve, janë posaçërisht atëherë përgjithmonë të zhvlefësuar, kur janë larguar nga procesi i punës, apo në përgjithësi nuk janë më të përdorueshme, ose nuk janë më të përdorueshme për qëllimin e tyre ekonomik.

2. Për mallrat dhe rezervat/stoqet (neni 7, pika 1.3.)

2.1. në rast të shkatërrimit, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

2.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

2.3. në rast se çmimi i arritshëm i shitjes në momentin para se të ndodhë dëmi, duke i hequr atij shpenzimet e kursyera, ka qenë më i ulët se shpenzimet për riprodhimin apo riblerjen, atëherë kompensohet më së shumti kjo vlerë më e vogël.

3. Për paratë dhe vlerat monetare, librezat e kursimit dhe letrat me vlerë (neni 7, pika 1.4.) kompensohen shpenzimet për riblerjen e tyre e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

4. Për mbajtësit e të dhënave dhe të ngjashme (neni 7, pika 1.5.) kompensohet vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre, nëse rikthimi i tyre është i nevojshëm, dhe kryhet brenda afatit kohor prej dy vitesh nga çasti kur ka ndodhur dëmi. Në rast të kundërt kompensohet vetëm vlera e materialit.

5. Për automjetet, dhe sendet tjera të lëvizshme(neni 7, pikat 1.6., 1.7. dhe 2.1.)

5.1. në rast të shkatërrimit, kompensohet vlera e sigurimit para momentit kur ka ndodhur ngjarja e siguruar;

5.2. në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

6. Për shpenzimet e siguruara (neni 3, pika 2.), kompensohen shpenzimet e shkaktuara.

7. Rregullat e përgjithshme për dëmtshpërblimin

7.1. Nëse përmes riparimit(ndreqjes/rregullimit) të një sendi, vlera e tij aktuale e sigurimit, në krahasim me vlerën e tij të sigurimit në momentin para dëmtimit ngritet(rritet), atëherë kompensimi për riparimin zvogëlohet për vlerën e diferencës mes atyre dy vlerave.

7.2. Vlera e mbetjes llogaritet po ashtu; Kufizimet e autoriteteve për rindërtim apo për riblerje nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të mbetjeve.

7.3. Tek sendet e veçanta, të cilat bashkë me sende tjera përbëjnë një tërësi(komplet), zhvlerësimi i sendeve të veçanta të padëmtuara, që vjen si pasojë e dëmtimit, shkatërrimit apo daljes nga dora e sendeve tjera, që bashkë me të përbëjnë tërësinë, nuk merret parasysh.

8. Rregullat speciale për dëmtshpërblimin

8.1. Tek tapetat, ngjyrosjet(lyerjet) si dhe tek veshjet e mureve dhe të dyshemeve që janë nga tekstili apo materialet artificiale si plastika kompensohet më së shumti vlera e kohës.

8.2. Kur bëhet fjalë për mënjanimin e dëmit nga thyerja, në tubacionet e ujit(Neni 1, pika 2.2.), atëherë kompensimi i dëmit për ndërrimin e domosdoshëm të tubave, kufizohet me shpenzimet për ndërrimin e më së shumti 2 metrave tubacion dhe të shpenzimeve plotësuese(sekondare) të domosdoshme gjatë atij ndërrimi deri në 2 metra tub. Nëse tejkalohet ky kufizim prej 2 metrave, atëherë zvogëlohet kompensimi i shpenzimeve të ndërrimit dhe shpenzimeve plotësuese(sekondare)

për ndërrimin në mënyrë proporcionale(p.sh.: për ndërrimin e 3 metrave tubacion do të kompensoheshin vetëm 2/3 e shpenzimeve të përmendura)

Neni 9

Nënsigurimi / Sigurimi copëz

1. Sipas nenit 8 lartësia e dëmtshpërblimit të llogaritur zvogëlohet sipas normave të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12), nëse ka nënsigurim; kjo nuk vlen, nëse bëhet fjalë për një sigurim në rrezik të parë.

2. Nëse kontraktohet që shumta e sigurimit të jetë vetëm një copëz e shumës së vlerës totale të shënuar në policë(sigurimi copëz), atëherë vlen:

2.1. shumta e sigurimit copëz është kufiri i dëmtshpërblimit të mundshëm;

2.2. Shumë e sigurimit sipas kushteve të përgjithshme të pasurisë(ABV_KS12), llogaritet shumta e vlerës totale e cila merret edhe si bazë për llogaritjen e shumës së sigurimit copëz.

Neni 10

Pagesa e dëmtshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja

1. Kontraktuesi i sigurimit ka fillimisht të drejtën që:

1.1. për ndërtesat

1.1.1. në rast të shkatërrimit të kompensohet me vlerën e kohës, e më së shumti me vlerën e tregut;

1.1.2. në rast të dëmtimit t'i kompensohet lartësia e dëmit në vlerën e kohës, e më së shumti lartësia e dëmit në vlerën e tregut.

1.2. për sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve

1.2.1. në rast të shkatërrimit të zhdëmtohet me vlerën e kohës;

1.2.2. në rast të dëmtimit, të zhdëmtohet me lartësinë e dëmit sipas vlerës së kohës.

1.3. Lartësia e dëmit sipas vlerës së kohës, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e kohës me vlerën e re.

Lartësia e dëmit sipas vlerës së tregut, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e tregut me vlerën e re.

2. Të drejtën për zhdëmtim, kur ai tejkalonjë lartësinë e rregulluar me pikën 1 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit e fiton vetëm atëherë nëse kushtet e mëposhtme plotësohen:

2.1. është siguruar, që pagesa e zhdëmtimit do të përdoret në tërësi për rindërtimin/riprodhimin apo riblerjen.

Sendet të cilat para se të ndodhte dëmi, veç kanë qenë të prodhuara, siguruara(blera), apo të porositura, apo kanë qenë në prodhim e sipër, nuk vlejné si të rindërtuara/riprodhuara apo të riblera;

2.2. rindërtimi i ndërtesës bëhet në të njëjtin vend si më parë.

Nëse ndërtimi në të njëjtin vend është ndaluar nga ana e autoriteteve(nuk guxon të ndërtohet aty), atëherë mjafton të bëhet rindërtimi në një vend tjetër në Kosovë;

2.3. sendet e rindërtuara/riprodhuara apo të riblera, përdoren për qëllimin e njëjtë si ato më parë(për të cilat paguhet zhdëmtimi);

2.4. rindërtimi/riprodhimi apo riblerja kryhet brenda afatit kohor prej tri vitesh, nga momenti kur ka ndodhur ngjarja e siguruar.

Neni 11

Ekspertiza

Kur është fjala për ekspertizën, si shtesë e rregullave të kushteve të përgjithshme të sigurimeve të pasurisë(ABV_KS12), futen edhe marrëveshjet në vazhdim:

1. Konkluzionet e të dy ekspertëve duhet të përbëjnë patjetër, edhe vlerën e momentit para rastit të dëmit, të sendeve të prekura nga rasti i dëmit, si dhe vlerën e mbetjeve të tyre.

2. Me kërkesën e ciles do palë kontraktuese, duhet përcaktuar edhe vlera e sigurimit e sendeve të siguruara, e të paprekura nga rasti i dëmit.

Neni 12

Regresi

Kur siguroesi, i kompenzon dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguroesi.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga vjedhja me thyerje (AED_KS12 / niveli 2)

Pjesa e përgjithshme

Për këtë sigurim vlejné kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë(ABV_KS12).

Pjesa e veçantë

Përbajtja

Neni 1 Rreziqet dhe dëmet e siguruara

Neni 2 Dëmet e pasiguruara

Neni 3 Sendet dhe shpenzimet e siguruara

- Neni 4 Shtrirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit
- Neni 5 Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi
- Neni 6 Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi
- Neni 7 Vlera e sigurimit
- Neni 8 Dëmshpërblimi
- Neni 9 Nënsegurimi; Sigurimi copëz
- Neni 10 Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja
- Neni 11 Ekspertiza
- Neni 12 Regresi

Neni 1 Rreziqet dhe dëmet e siguruar

1. Të siguruar janë dëmet në sende, që shkaktohen nga tentativa apo realizimi i vjedhjes me thyerje (ngjarja e dëmit).
Të siguruar janë po ashtu edhe dëmet në sende, e që janë pasojë e paevitueshme e ngjarjes së dëmit.
2. Bëhet fjalë për vjedhjen me thyerje, kur në hapësirat e siguruar, keqbërësi
 - 2.1. hyn me force, duke shtypur apo thyer dyert, dritaret apo pjesët e tjera të ndërtesës;
 - 2.2. hyn, duke kaluar pengesa të rënda dhe atë përmes hapjeve, të cilat nuk janë të destinuara që të përdoren si hyrje;
 - 2.3. përvidhet, dhe nga hapësirat e siguruar e të mbyllura me çelës/dry merr sende;
 - 2.4. depërton, duke hapur ndonjë dry dhe atë me ndihmën e ndonjë mjeti apo çelësi të falsifikuar.
Çelësa të falsifikuar, janë ata çelësa, të cilët prodhohen në kundërshtim me ligjin;
 - 2.5. depërton duke përdorur çelësin e vërtetë, deri tek i cili çelës ka ardhur përmes vjedhjes me thyerje në ndonjë hapësirë tjetër nga hapësira e siguruar apo përmes plaçkitjes.
Plaçkitja është marrja apo detyrimi i dhënies së sendeve duke përdorur apo duke kërcënuar me përdorimin aktiv të dhunës ndaj personave;
- 2.6. arrin, dhe gjatë kohës kur ka persona të pranishëm hyn në hapësirat e mbyllura në ndonjë nga mënyrat e sqaruara sipas pikave nga 2.1. deri në 2.5.
3. Bëhet fjalë për vjedhjen me thyerje në një kuti të mbyllur, kur keqbërësi
 - 3.1. ka hyrë në njërin nga mënyrat e cekura në pikën 2, dhe e thyen kutinë, apo e hapë atë me ndihmën e ndonjë mjeti apo çelësi të falsifikuar;
 - 3.2. e hapë kutinë, duke përdorur çelësin e vërtetë, deri tek i cili ka ardhur përmes vjedhjes me thyerje të një kutie të paktën njësoj të sigurt.
Hapja e kutive me çelësin e vërtetë, nëse keqbërësi ka ardhur deri tek ai përmes vjedhjes me thyerje në ndonjë hapësirë tjetër nga hapësira e siguruar dhe në njërin nga mënyrat e përshkruara në pikën 2 apo përmes plaçkitjes, llogaritet si ngjarje e siguruar vetëm nëse për këtë ka marrëveshje të veçantë;
 - 3.3. gjatë kohës kur ka persona të pranishëm, arrin në hapësirat e siguruar, dhe hapë duke thyer apo me ndihmën e ndonjë mjeti apo çelësi të falsifikuar kutinë e mbyllur që gjendet aty.

Neni 2 Dëmet e pasiguruar

- Të pasiguruar, madje edhe atëherë kur janë pasojë e paevitueshme e një ngjarje të siguruar, janë:
1. dëmet nga vandalizmi (dëmtimi qëllimkeq i sendeve);
 2. vjedhja ose dalja nga dora e sendeve, kur nuk është fjala për vjedhje me thyerje siç është e definuar në nenin 1;
 3. dëmet nga marrja e sendeve apo parave të thata nga automatët, duke përdorur monedha të falsifikuara, apo monedha që nuk kanë vlerën e duhur, si dhe kartela të manipuluar apo të ngjashme;
 4. dëmet, të cilat shkaktohen nga veprimtaria e qëllimshme e personave që jelojnë bashkë me kontraktuesin e sigurimit;
 5. dëmet, të cilat shkaktohen nga veprimtaria e qëllimshme e personave që punojnë apo kryejnë ndonjë aktivitet për kontraktuesin e sigurimit, dhe që kanë leje për të hyrë në hapësirat e siguruar, përveç nëse vjedhja me thyerje ndodh në aso kohe kur hapësirat e siguruar janë të mbyllura për ta, dhe për të hyrë në to nuk janë përdorur as çelësa të vërtetë e as të falsifikuar, nga këta persona;
 6. dëmet nga plaçkitja në vendin e sigurimit;
 7. dëmet nga plaçkitja gjatë rrugës së transportit (plaçkitja e korrierit);
 8. dëmet nga zjarri, eksplozimi apo dalja e ujit të tubacioneve (gypave).
- Mirëpo, të siguruar janë dëmet, që shkaktohen nga përdorimi i mjeteve shpërthyes gjatë një vjedhje me thyerje, nëse për to nuk mund të kërkohej dëmshpërblim nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi;
9. dëmet nga fitimi i humbur dhe dëmet e tërthorta (indirekte);
 10. dëmet që shkaktohen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e ndikimit të:

- 10.1. Luftës së çdo forme - me ose pa shpallje të luftës, duke ia bashkangjitur kësaj edhe të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve, dhe organizatave politike apo terroriste;
- 10.2. trazirave të brendshme, luftës qytetare, revolucionit, rebelimit, turbullirave, kryengritjes;
- 10.3. veprimeve ushtarake dhe veprimeve të autoriteteve tjera, që lidhen me ngjarjet e përmendura në pikat 10.1. dhe 10.2. të këtij neni;
- 10.4. Tërmetit apo ngjarjeve të tjera të pazakonshme natyrore;
- 10.5. Energjisë bërthamore, izotopeve radioaktive apo rrezatimit jonizues.

Për pikën 10 vlen: Është obligim i kontraktuesit të sigurimit, të dëshmojë se dëmi i ndodhur, nuk vjen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e ndonjë rrethësie nga ngjarjet e përmendura në pikat 10.1. deri 10.5.

Neni 3 Sendet dhe shpenzimet e siguruar

1. Sendet e siguruar
 - 1.1. Të siguruar janë sendet e shënuara në policë, e që janë pronë e kontraktuesit të sigurimit apo që i janë shtur dhe dhënë mirëpo duke mos ia kaluar pronësinë në to, apo i janë dhënë si garanci (hipotekë).
 - 1.2. Sendet e huaja janë të siguruar vetëm nëse për to ka një marrëveshje të veçantë, dhe vetëm atëherë kur për to nuk mund të merret dëmshpërblim nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.
Kur bëhet fjalë për vlerën e sigurimit të sendeve të huaja, kryesor është interesi i pronarit, përveç nëse me marrëveshje nuk është rregulluar ndryshe.
 - 1.3. Paratë dhe vlerat monetare, librezat e kursimit, letrat me vlerë, dokumentet (dëftesa, certifikatat), stolitë, sendet e arta dhe nga platinë, gurët e çmuar, metalet e çmuara, perlat e vërteta si dhe koleksionet e pullave postare dhe të monedhave janë të siguruar vetëm në kullitë e shënuara në policë e që janë të mbyllura me çelës.
2. Shpenzimet e siguruar
Të siguruar janë
 - 2.1. Shpenzimet për masat që kontraktuesi i sigurimit i shpreh si të domosdoshme dhe i ndërmerr në rast se ndodh ngjarja e siguruar për të evituar apo zvogëluar dëmin, madje edhe në qoftë se ato nuk japin rezultat, e këso shpenzime janë posaçërisht ato shpenzime që shkaktohen nga masat e ndërmarrura emergjente të sigurimit (raijtjen, mbylljen provizore etj.)
 - 2.2. Shpenzimet për rikthimin në gjendjen e mëparshme të pjesëve të dëmtuara të ndërtesës, dhe të riblerjes së pjesëve të marrura të ndërtesës apo të adaptimeve të hapësirave të siguruar.
 - 2.3. Shpenzimet për ndërrimin e domosdoshëm të bravave në hapësirat e siguruar – deri në shumën € 1.500.-, nëse gjatë një vjedhjeje me thyerje apo plaçkitje, çelësat kanë dalë nga dora.
Shuma e kompensimit për shpenzimet e definuara në pikat 2.1. deri në 2.3. dhe dëmshpërblimit për sendet e siguruar nuk mund të jetë më e madhe se sa shumat e sigurimit. Kjo nuk vlen për ato masa për të cilat siguruesi ka dhënë instruksion konkret për ndërmarrjen e tyre.

2.4. vetëm përmes marrëveshjes së veçantë:

- 2.4.1. Shpenzimet e lëvizjes dhe të mbrojtjes, këto janë shpenzime, që krijohen për shkak të nevojës për të lëvizur ndryshuar apo mbrojtur sendet tjera në mënyrë që sendet e siguruar të mund të rikthehen në gjendjen e mëparshme apo të riblen; këto janë veçanërisht shpenzimet për de- dhe rimontimin e makinave apo të pajisjeve/implanteve si dhe shpenzimet për penetrimin, demelimin/shkatërrimin dhe rindërtimin e pjesëve të ndërtesës.
 - 2.4.2. Shpenzimet e demolimit/shkatërrimit dhe të vënies rend (rregull), këto janë shpenzimet për punën e kryer në vendin e sigurimit, me kusht që këto shpenzime t'u përkasin sendeve të siguruar, dhe atë për shkatërrimin/demolimin e nevojshëm e pjesëve të mbetura e të dëmtuara, si dhe për heqjen dhe sortimin e mbetjeve dhe të mbeturinave. Këtu nuk hyjnë shpenzimet për transportimin dhe deponimin e atyre mbetjeve dhe mbeturinave – sipas pikës 2.4.3.
 - 2.4.3. Shpenzimet e transportimit dhe deponimit, këto janë shpenzimet për kontrollimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin e sendeve të siguruar e të dëmtuara.
3. Të pasiguruar janë:
- 3.1. Shpenzimet që krijohen si pasojë e dëmtimit të shëndetit gjatë kryerjes së obligimit të shpëtimt;
 - 3.2. Shpenzimet për shërbimet me interes publik ose të urdhëruara nga autoritetet, e që kanë të bëjnë me aktivitetin e zjarfikësve dhe personave të tjerë në detyrë.

Neni 4 Shtrirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit

Sendet e lëvizshme janë të siguruar vetëm në hapësirat e siguruar të cekura në policë (=vendi i sigurimit). Nëse këto largohen nga vendi i sigurimit, atëherë mbrojtja e sigurimit pezullohet. Nëse largimi i tyre është permanent, atëherë kontrata e sigurimit për ato sende, shuhet.

Neni 5

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi

1. Nëse nga hapësirat e sigurimit dalin të gjithë personat, qoftë edhe për një kohë shumë të shkurtër, atëherë
- 1.1. dyert, dritaret dhe të gjitha hapjet tjera të hapësirave të sigurimit duhet të mbahen të mbyllura me çelës (në atë mënyrë që të mos mund të hapen nga jashtë në mënyrë të rregullt)
- 1.2. Kufijtë duhet vënë nën dritë (duhet mbyllur me çelës);
- 1.3. duhet ndërmarrë plotësisht të gjitha masat e sigurisë.
2. Kasafortat e murit duhet që sipas rregullit të jenë të murosura në mur me një shtresë çimentoje me fortësi të klasës MB40 apo C30/37 (apo të kualitetit të lartë, p.sh. C35/45), dhe kjo shtresë duhet të jetë së paku 100 mm e trashë.
3. Arkat e regjistrimit duhet lënë e hapur pas përfundimit të orarit të punës.
4. Nëse sendet janë të siguruar në një ndërtesë të banuar permanent, atëherë kjo veçori e të qenit e banuar permanent nuk guxon të ndërprehet për më shumë se në tërësi 40 ditë brenda vitit.
5. Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhvendosë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 6

Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

1. Obligimi i zvogëlimit të dëmit

- 1.1. Në rast të dëmit apo të kërcënimit direkt që dëmi të ndodhë, kontraktuesi i sigurimit duhet që sipas mundësisë
 - të kujdeset që të ruaj, shpëtojë dhe rikthejë sendet e siguruar;
 - për këtë të marrë udhëzime nga siguruesi dhe t'u përmbahet atyre udhëzimeve.
- 1.2. Në rast të humbjes së librezave të kursimit apo të letrave me vlerë, duhet kërkuar menjëherë mbyllja e tyre (të bëhet e pamundur tërheqja e parave) në institucionin përkatës, dhe nëse është e mundur të lillohet procedura gjyqësore për shpalljen e tyre të pavlefshme.

2. Obligimi i lajmërimit të dëmit

Secili dëm duhet lajmëruar menjëherë tek siguruesi, dhe rasti duhet treguar pranë autoriteteve të sigurisë (lajmëruar në polici). Tek tregimi që bëhet tek autoritetet e sigurisë (policia), duhet lajmëruar/dhënë në evidencë pajtjetër të gjitha sendet e dala nga dora.

3. Obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit

- 3.1. Siguruesit duhet mundësuar nëse kjo është e mundur çdo helim për përcaktimin e shkakut dhe lartësisë së dëmit të siguruar, apo të mbulesës siguruese të tij.
- 3.2. Gjatë procesit të përcaktimit të dëmit, siguruesit duhet dhënë mbështetjen e nevojshme, dhe nëse nga ai kërkohet t'i jepen në shfrytëzim dokumentet përkatëse. Shpenzimet për këto i mban kontraktuesi i sigurimit.
- 3.3. Gjendja e cila ka ardhur si pasojë e dëmit të shkaktuar, nuk guxon të ndryshohet pa lejen e siguruesit para se të përcaktohet dëmi, përveç nëse një ndryshim i kësaj gjendjeje është i domosdoshëm për të zvogëluar apo mbajtur sa më të vogël dëmin, apo nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit publik.

4. Pasojat ligjore në rast të shkeljes së detyrimit të përcaktuar me këtë nen

Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhvendosë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 7

Vlera e sigurimit

1. Rregullat speciale rreth vlerës së sigurimit

- 1.1. Tek sendet e përdorimit dhe tek pajisjet e ndërmarrjeve, vlera e sigurimit është vlera e re.
Me vlerë të re nënkuptohen shpenzimet e riblerjes së sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë).
- 1.2. Tek mallrat dhe rezervat/stoqet, vlera e sigurimit është vlera e shpenzimeve për riprodhimin apo riblerjen e sendeve të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë).
Nëse tek mallrat dhe rezervat/stoqet, çmimi i arritshëm i shitjes është më i ulët se sa shpenzimet/kostoja e riprodhimit apo riblerjes, atëherë vlerë e sigurimit llogaritet çmimi i arritshëm i shitjes.
- 1.3. Si vlerë sigurimi tek
 - paratë dhe vlerat monetare, vlen vlera nominale,
 - librezat e kursimit pa fjalëkalim, vlen shuma e depozitës (gjendjes në plus),
 - librezat e kursimit me fjalëkalim, vlejshëm shpenzimet për procedurën e shpalljes së pavlefshme të asaj libeze,
 - lettrat me vlerë me kurs zyrtar, vlen vlera e regjistruar (fiksuar), e fundit zyrtare,
 - lettrat tjera me vlerë, vlen vlera e tregut.

- 1.4. Vlera e sigurimit tek mbajtësit e të dhënave bashkë me programet dhe të dhënat që janë të ruajtura në to, mjetele ndihmëse për riprodhim, dëftesat, modellet, prototipat dhe të ngjashme që po ashtu janë të ruajtura në to, është vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre.
- 1.5. Vlera e sigurimit të automjeteve të lëvizshme nëpër tokë, ujë dhe ajër, e që janë të lejuara nga autoritetet, është vlera e tregut.

Vlera e tregut është çmimi i arritshëm i shitjes së një sendi.

- 1.6. Vlerë e sigurimit e sendeve tjera të lëvizshme, që nuk janë përmendur në pikat 1.1 deri 1.5., është vlera e tregut.

2. Rregullat e përgjithshme të vlerës së sigurimit

- 2.1. Pavarësisht nga rregullat nga pika 1.1. deri në 1.6., vlera e sigurimit është të paktën vlera e tregut:
 - 2.1.1. tek sendet me vlerë historike apo artistike, tek të cilat vjetërsia nuk qon zakonisht në humbje të vlerës;
 - 2.1.2. tek sendet e lëvizshme, që huazohen (jepen me qira) për aktivitet biznesi si p.sh. librat, makinat, videofilmat dhe aparaturat;
- 2.2. Gjatë përcaktimit të vlerës së sigurimit, nuk merret parasysh vlera e pasionit personal për sendin.

Neni 8

Dëmshpërblimi

1. Për sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve (Neni 7, Pika 1.1.)

- 1.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;
- 1.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit (vlera e re), e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

- 1.3. Nëse vlera e kohës, e sendit të prekur nga dëmi, në momentin para se dëmi të ndodhte ka qenë më e vogël se 40% e vlerës së re, atëherë kompensohet më së shumti vlera e kohës.

Vlera e kohës llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të sendit i hiqet vlera e caktuar që i përshkallëton gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së sendit.

- 1.4. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë, atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

Sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve, janë posaçërisht atëherë përgjithmonë të zhvlefësuar, kur janë larguar nga procesi i punës, apo në përgjithësi nuk janë më të përdorueshme, ose nuk janë më të përdorueshme për qëllimin e tyre ekonomik.

2. Për mallrat dhe stoqet/rezervat (neni 7, pika 1.2.)

- 2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit para momentit kur ka ndodhur ngjarja e siguruar;
- 2.2. në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.
- 2.3. në rast se çmimi i arritshëm i shitjes në momentin para se të ndodhë dëmi, duke i hequr atij shpenzimet e kursyer, ka qenë më i ulët se shpenzimet për riprodhimin apo riblerjen, atëherë kompensohet më së shumti kjo vlerë më e vogël.

3. Për paratë dhe vlerat monetare, librezat e kursimit dhe lettrat me vlerë (neni 7, pika 1.3.) kompensohen shpenzimet për riblerjen e tyre e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

4. Për mbajtësit e të dhënave dhe të ngjashme (neni 7, pika 1.4.) kompensohet vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre, nëse rikthimi/riblerja i tyre është i nevojshëm, dhe kryhet brenda afatit kohor prej dy vitesh nga çasti kur ka ndodhur dëmi. Në rast të kundërt kompensohet vetëm vlera e materialit.

5. Për automjetet, dhe sendet tjera të lëvizshme (neni 7, pikat 1.5., 1.6. dhe 2.)

- 5.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit para momentit kur ka ndodhur ngjarja e siguruar;
- 5.2. në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.
6. Për shpenzimet e siguruar (neni 3, pika 2.), kompensohen shpenzimet e shkaktuara.

7. Rregullat e përgjithshme për dëmshpërblimin

- 7.1. Nëse përmasa riparimit (ndreqjes/rregullimit) të një sendi, vlera e tij aktuale e sigurimit, në krahasim me vlerën e tij të sigurimit në momentin para dëmtimit (rritet), atëherë kompensimi për riparimin zvogëlohet për vlerën e diferencës mes atyre dy vlerave.
- 7.2. Vlera e mbetjes llogaritet po ashtu; Kufizimet e autoriteteve për rindërtim apo për riblerje nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të mbetjeve.
- 7.3. Për sendet e dala nga dora dhe të gjetura përsëri vlejshëm marrëveshja se:
 - 7.3.1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar të marrë këto sende, nëse kjo mund të kërkohet (nuk është jashtë mase/e tepërt të kërkohet) nga ai.
 - 7.3.2. Nëse sendet gjinden përsëri dhe i kthehen kontraktuesit të sigurimit, dhe atë pasi që është bërë zhvendëtimi, atëherë kontraktuesi i sigurimit duhet të kthejë një

shumë të caktuar, e cila llogaritet ashtu, që: vlerës së marrë për zhdëmtim i hiqet vlera e mundshme e zhvlerësimit(amortizimit) të sendit, dhe mbajta është vlera që duhet kërkohet. Sendet për të cilat nuk mund të kërkohet(do të ishte e tepërt të kërkohet) nga kontraktuesi i sigurimit që t'i marrë prapë, duhet të kalojnë në pronësi të siguruesit.

- 7.4. Tek sendet e veçanta, të cilat bashkë me sende tjera përbëjnë një tërësi(komplet), zhvlerësimi i sendeve të veçanta të padëmtuara, që vjen si pasojë e dëmtimit, shkatërrimit apo daljes nga dora e sendeve tjera, që bashkë me të përbëjnë tërësinë, nuk merret parasysh.

Neni 9

Nën sigurimi; Sigurimi copëz

1. Sipas neni 8 lartësia e dëmshpërblimit të llogaritur zvogëlohet sipas normave të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12), nëse ka nën sigurim; kjo nuk vlen, nëse bëhet fjalë për një sigurim në rrezik të parë.
2. Nëse kontraktohet që shumta e sigurimit të jetë vetëm një copëz e shumës së vlerës totale të shënuar në policë(sigurimi copëz), atëherë vlen:
- 2.1. shumta e sigurimit copëz është kufiri i dëmshpërblimit të mundshëm;
- 2.2. Shumë e sigurimit sipas kushteve të përgjithshme të pasurisë(ABV_KS12), llogaritet shumta e vlerës totale e cila merret edhe si bazë për llogaritjen e shumës së sigurimit copëz.

Neni 10

Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja

1. Tek sendet e përdorimit dhe tek pajisjet e ndërmarrjeve, kontraktuesi i sigurimit fillimisht ka të drejtë që:
- 1.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora të zhdëmtohet me vlerën e kohës;
- 1.2. në rast të dëmtimit, të zhdëmtohet me lartësinë e dëmit sipas vlerës së kohës.
Lartësia e dëmit sipas vlerës së kohës, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e kohës me vlerën e re.
2. Të drejtën për zhdëmtim, kur ai tejkalon lartësinë e rregulluar me pikën 1 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit e fiton vetëm atëherë nëse kushtet e mëposhtme plotësohen:
- 2.1. është siguruar, që pagesa e zhdëmtimit do të përdoret në tërësi për rindërtimin/riprodhimin apo riblerjen.
Sendet të cilat para se të ndodhte dëmi, veç kanë qenë të prodhuara, blera, apo të porositura, apo kanë qenë në prodhim e sipër, nuk vlejnë si të rindërtuara/riprodhuara apo të riblerja;
- 2.2. sendet e rindërtuara/riprodhuara apo të riblerja, përdoren për qëllimin e njëjtë si ato më parë(për të cilat paguhet zhdëmtimi);
- 2.3. rindërtimi/riprodhimi apo riblerja kryhet brenda afatit kohor prej tri vitesh, nga momenti kur ka ndodhur ngjarja e siguruar.

Neni 11

Ekspertiza

Kur është fjala për ekspertizën, si shtesë e rregullave të kushteve të përgjithshme të sigurimeve të pasurisë(ABV_KS12), futen edhe marrëveshjet në vazhdim:

1. Konkluzioni i të dy ekspertëve duhet të përmbajë pajtësi, edhe vlerën e momentit para rastit të dëmit, të sendeve të prekura nga rasti i dëmit, si dhe vlerën e mbetjeve të tyre.
2. Me kërkesën e cilës do palë kontraktuese, duhet përcaktuar edhe vlera e sigurimit e sendeve të siguruar, e të paprekura nga rasti i dëmit.

Neni 12

Regresi

Kur siguruesi, i kompenson dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguruesi.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga zjarri (AFB_KS12 / niveli 2)

Pjesa e përgjithshme

Për këtë sigurim vlejnë kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë(ABV_KS12).

Pjesa e veçantë

Përmbajtja

- | | | |
|------|---|--|
| Neni | 1 | Rreziket dhe dëmet e siguruar |
| Neni | 2 | Dëmet e pasiguruar |
| Neni | 3 | Sendet dhe shpenzimet e siguruar |
| Neni | 4 | Shtirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit |
| Neni | 5 | Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi |

- | | | |
|------|----|--|
| Neni | 6 | Vlera e sigurimit |
| Neni | 7 | Dëmshpërblimi |
| Neni | 8 | Nën sigurimi |
| Neni | 9 | Pagesa e dëmshpërblimit; Riprodhimi/Rindërtimi, Riblerja |
| Neni | 10 | Ekspertiza |
| Neni | 11 | Regresi |

Neni 1

Rreziket dhe dëmet e siguruar

1. Rreziket e siguruar
- 1.1. Zjarri; Zjarri është flaka, e cila bën dëm, dhe përhapet me forcën e vet (Zjarri i dëmit).
- 1.2. Rrufeja; Rrufeja është ndikimi direkt i forcës apo nxehtësisë së një rufeje, në sende(goditja e drejtpërdrejtë e rufesë).
- 1.3. Eksplodimi; Eksplodimi është një dukuri momentale e forcës, e cila vjen si pasojë e brymjes së gazrave, apo avujve.
Vetëm atëherë bëhet fjalë për eksplozimin e një mbajtësi(bidoni, tubacioni dhe të ngjashme), nëse muret e tij janë të shqyera në atë masë që ndryshimi i shtypjes brenda dhe jashtë atij mbajtësi zhduket nga një moment në tjetrin dhe vjen deri tek barazimi i shtypjes.
Bëhet fjalë për eksplozim edhe nëse nuk janë shqyer muret e mbajtësit, nëse ai eksplozim ka ardhur si pasojë e reaksioneve kimike brenda mbajtësit.
- 1.4. Rënia e fluturakeve; Rënia e fluturakeve, është rënia apo goditja nga mjetet fluturuese në ajër apo në hapësirë, nga satelitet, pjesët e tyre apo ngarkesa e tyre.
2. Dëmet e siguruar
Të siguruar janë dëmet në sende, të cilat
- 2.1. shfaqen nga ndikimi i drejtpërdrejtë i ndonjë rreziku të siguruar(ngjarja e siguruar);
- 2.2. shfaqen si pasojë e paevitueshme e një ngjarje të siguruar;
- 2.3. shfaqen si pasojë e një ngjarje të siguruar, përmes fikjes së zjarrit, rrënim, apo pastrimit të gërmadhëve;
- 2.4. shfaqen kur sende dalin nga dora, si pasojë e një ngjarje të siguruar.

Neni 2

Dëmet e pasiguruar

Të pasiguruar janë:

1. Dëmet në sende të cilat i janë ekspozuar një zjarri që përdoret(të dobishëm), nxehtësisë, apo tymit;
2. Dëmet në sende, që bien apo hidhen në zjarr që përdoret(të dobishëm);
3. Dëmet e përcëllimit;
4. Dëmet në pajisjet elektrike nga energjia e rrymës (p.sh.: rryma elektrike e fortë, tensioni i lartë, izolimi i gabueshëm(i keq), lidhja e shkurtër, tokëzimi, kontakti i keq, mosfunksionimi i rregullt i aparatave të sigurisë, atyre të rregullimit, dhe të matjes, jostabiliteti, mbingarkesa).
Dëmet e këtij lloji, nuk janë as atëherë të siguruar, kur shfaqen dukuri të ndërgjimit, nxehtësisë, apo me karakter eksploziv;
5. Dëmet në pajisjet elektrike, përmes tensionit të lartë apo rrymës induktive, si pasojë e goditjes së rufesë apo ndonjë shkarkimi atmosferik(goditja jo e drejtpërdrejtë e rufesë);
6. Dëmet e shkaktuara nga ndikimi i shtypjes mekanike dhe dëmet në makineritë e djegies si pasojë e eksplozimeve në brendësinë e tyre;
7. Dëmet nga projektilet e armëve të zjarrit;
8. Dëmet nga shtypja e ulët (implozioni);
9. Dëmet që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e:

- 9.1. Luftës së çdo forme - me ose pa shpallje të luftës, duke ia bashkangjitur kësaj edhe të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve, dhe organizatave politike apo terroriste;
- 9.2. trazirave të brendshme, luftës qytetare, revolucionit, rebelimit, turbullirave, kryengritjes;
- 9.3. veprimeve ushtarake dhe veprimeve të autoriteteve tjera, që lidhen me ngjarjet e përmendura në pikat 9.1. dhe 9.2. të këtij neni;
- 9.4. Tërmetit apo ngjarjeve të tjera të pazakonshe natyrore;
- 9.5. Energjisë bërthamore, izotopeve radioaktive apo rrezatimit jonizues.

Për pikat 1, deri 8, vlen: Nëse një dëm i tillë, shkakton zjarr apo eksplozim, atëherë dëmet që shkaktohen si pasojë e këtij zjarri apo eksplozimi, janë të siguruar.

Për pikat 2., 3., 4., 6., 7. dhe 8. vlen: Dëmi të tilla janë të siguruar, nëse vinë si pasojë e paevitueshme e një dëmi të siguruar.

Për pikën 9. vlen: Është obligim i kontraktuesit të sigurimit, të dëshmojë se dëmi i ndodhur, nuk vjen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e ndonjëres/disave nga ngjarjet e përmendura në pikat 9.1. deri 9.5 apo e gjendjes së shkaktuar nga ato ngjarje.

Neni 3 Sendet dhe shpenzimet e siguruar

1. Sendet e siguruar

1.1. Të siguruar janë sendet e shënuara në policë, e që janë pronë e kontraktuesit të sigurimit apo që i janë shitur dhe dhënë mirëpo duke mos ia kaluar pronësinë në to, apo i janë dhënë si garanci (hipotekë).

1.2. Sendet e huaja janë të siguruar vetëm nëse për to ka një marrëveshje të veçantë, dhe vetëm atëherë kur për to nuk mund të merret dëmshpërblim nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.

Kur bëhet fjalë për vlerën e sigurimit të sendeve të huaja, kryesori është interesi i pronarit, përveç nëse me marrëveshje nuk është ndryshe e rregulluar.

2. Shpenzimet e siguruar

2.1. Shpenzimet për masat që kontraktuesi i sigurimit i sheh si të domosdoshme dhe i ndërmerr në rast se ndodh ngjarja e siguruar për të evituar apo zvogëluar dëmin, madje edhe në qoftë se ato nuk japin rezultat.

Shuma e kompensimit për shpenzimet e siguruar dhe dëmshpërblimit për sendet e siguruar nuk mund të jetë më e madhe se sa shuma e sigurimit. Kjo nuk vlen për ato masa për të cilat siguroesi ka dhënë instruksion konkret për ndërmarrjen e tyre.

2.2. Vetëm përmes marrëveshjes së veçantë janë të siguruar:

2.2.1. **Shpenzimet e fikjes së zjarrit**, këto janë shpenzimet e luftimit të zjarrit, përveç shpenzimeve të përcaktuara në pikën 2.3.

2.2.2. **Shpenzimet e lëvizjes dhe të mbrojtjes**, këto janë shpenzime, që krijohen për shkak të nevojës për të lëvizur ndryshuar apo mbrojtur sendet tjera në mënyrë që sendet e siguruar të mund të rikthehen në gjendjen e mëparshme apo të riblen; këto janë veçanërisht shpenzimet për de- dhe rimontimin e makinave apo të pajisjeve/implanteve si dhe shpenzimet për penetrimin, demolimin/shkatërrimin dhe rindërtimin e pjesëve të ndërtesës.

2.2.3. **Shpenzimet e demolimit/shkatërrimit dhe të vënies rend(rregull)**, këto janë shpenzimet për punën e kryer në vendin e sigurimit, me kusht që këto shpenzime t'u përkasin sendeve të siguruar, dhe atë për shkatërrimin/demolimin e nevojshëm e pjesëve të mbetura e të dëmtuara, si dhe për heqjen dhe sortimin e mbetjeve dhe të mbeturinave. Këtu nuk hyjnë shpenzimet për transportimin dhe deponimin e atyre mbetjeve dhe mbeturinave – sipas pikës 2.2.4.

2.2.4. **Shpenzimet e transportimit dhe deponimit**, këto janë shpenzimet për kontrollimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin e sendeve të siguruar e të dëmtuara.

2.3. Të pasiguruar janë:

2.3.1. Shpenzimet që krijohen si pasojë e dëmtimit të shëndetit gjatë kryerjes së obligimit të shpëtimt;

2.3.2. Shpenzimet për shërbimet me interes publik ose të urdhëruara nga autoritetet, e që kanë të bëjnë me aktivitetin e zjarrfikësve dhe personave të tjerë në detyrë.

Neni 4 Shtrirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit

Sendet e lëvizshme janë të siguruar vetëm në hapësirat e siguruar të cekura në policë (vendi i sigurimit). Nëse këto largohen nga vendi i sigurimit, atëherë mbrojtja e sigurimit pezullohet. Nëse largimi i tyre është permanent, atëherë kontrata e sigurimit për ato sende, shuhet.

Neni 5 Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi

1. Obligimi i zvogëllimit të dëmit

1.1. Në rast të dëmit apo të kërcënimit direkt që dëmi të ndodhë, kontraktuesi i sigurimit duhet që sipas mundësisë

- të kujdeset që të ruaj, shpëtojë dhe rikthejë sendet e siguruar;
- për këtë të marrë udhëzime nga siguroesi dhe t'u përmbahet atyre udhëzimeve.

1.2. Në rast të humbjes së librezave të kursimit apo të letrave me vlerë, duhet kërkuar menjëherë mbyllja e tyre (të bëhet e pamundur tërheqja e parave) në institucionin përkatës, dhe nëse është e mundur të fillohet procedura gjyqësore për shpalljen e tyre të pavlefshme.

2. Obligimi i lajmërimit të dëmit

Secili dëm duhet lajmëruar menjëherë tek siguroesi, dhe rasti duhet treguar pranë autoriteteve të sigurisë (lajmëruar në polici). Tek tregimi që bëhet tek autoritetet e sigurisë (policia), duhet lajmëruar/dhënë në evidencë pajtëtar të gjitha sendet e dala nga dora.

3. Obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit

3.1. Siguroesi duhet mundësuar nëse kjo është e mundur çdo hetim për përcaktimin e shkakut dhe lartësisë së dëmit të siguruar, apo të mbulesës siguruese të tij.

3.2. Gjatë procesit të përcaktimit të dëmit, siguroesi duhet dhënë mbështetjen e nevojshme, dhe nëse nga ai kërkohej t'i jepen në shfrytëzim dokumentet përkatëse. Shpenzimet për këto i mban kontraktuesi i sigurimit.

3.3. Gjendja e cila ka ardhur si pasojë e dëmit të shkaktuar, nuk guxon të ndryshohet pa lejen e siguroesit para se të përcaktohet dëmi, përveç nëse një ndryshim i kësaj gjendjeje është i domosdoshëm për të zvogëluar apo mbajtur sa më të vogël dëmin, apo nëse kjo është e domosdoshme për shkak të interesit publik.

4. **Pasojat ligjore në rast të shkeljes së detyrimeve të kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi**

Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë siguroesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguroesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 6 Vlera e sigurimit

1. Rregullat speciale rreth vlerës së sigurimit

1.1. Si vlerë e sigurimit tek ndërtesat mund të kontraktohet:

1.1.1. vlera e re.

Me vlerë të re, të një ndërtese, nënkuptohet vlera e shpenzimeve që janë të zakonshme për atë vend, për planifikimin, konstruktimin dhe rindërtimin e asaj ndërtese;

1.1.2. vlera e kohës.

Vlera e kohës e një ndërtese llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të asaj ndërtese i hiqet vlera e caktuar që i përshtatet gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së saj;

1.1.3. vlera e tregut.

Vlera e tregut e një ndërtese, është vlera e arritshme e shitjes së saj, ku megjithatë vlera e trualit ku gjendet ndërtesa nuk merret parasysh.

1.2. Tek sendet e përdorimit dhe tek pajisjet e ndërmarrjeve, si vlerë e sigurimit mund të kontraktohet:

1.2.1. vlera e re.

Me vlerë të re nënkuptohen shpenzimet e riblerjes së sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë);

1.2.2. vlera e kohës.

Vlera e kohës llogaritet në atë mënyrë që, vlerës së re të sendit i hiqet vlera e caktuar që i përshtatet gjendjes, amortizimit dhe vjetërsisë së sendit;

1.2.3. vlera e tregut.

Vlera e tregut është çmimi i arritshëm i shitjes së një sendi.

1.3. Tek mallrat dhe rezervat/stoqet, vlerë e sigurimit llogaritet shpenzimet për riprodhimin / riblerjen e sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi (klasë).

Nëse tek mallrat dhe rezervat/stoqet, çmimi i arritshëm i shitjes është më i ulët se sa shpenzimet/kostoja e riprodhimit apo riblerjes, atëherë vlerë e sigurimit llogaritet çmimi i arritshëm i shitjes.

1.4. Vlerë e sigurimit tek

- paratë dhe vlerat monetare, vlen vlera nominale,
- librezat e kursimit pa fjalëkalim, vlen shuma e depozitës (gjendjes në plus),
- librezat e kursimit me fjalëkalim, vlen shpenzimet për procedurën e shpalljes së pavlefshme të asaj libeze,
- letrat me vlerë me kurs zyrtar, vlen vlera e regjistruar (fiksuar), e fundit zyrtare,
- letrat tjera me vlerë, vlen vlera e tregut.

1.5. Vlera e sigurimit tek mbajtësit e të dhënave bashkë me programet dhe të dhënat që janë të ruajtura në to, mjetet ndihmëse për riprodhim, dëftesat, modelet, prototipat dhe të ngjashme që po ashtu janë të ruajtura në to, është vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre.

1.6. Vlera e sigurimit të automjeteve të lëvizjes nëpër tokë, ujë dhe ajër, e që janë të lejuara nga autoritetet, është vlera e tregut.

1.7. Vlerë e sigurimit e sendeve tjera të lëvizshme, që nuk janë përmendur në pikat 1.2. deri 1.6., është vlera e tregut.

2. Rregullat e përgjithshme të vlerës së sigurimit

2.1. Pavarësisht nga rregullat nga pika 1.1. deri në 1.7., vlera e sigurimit është të paktën vlera e tregut:

2.1.1. tek sendet me vlerë historike apo artistike, tek të cilat vjetërsia nuk qon zakonisht në humbje të vlerës;

2.1.2. tek sendet e lëvizshme, që huazohen (jepen me qira) për aktivitet biznesi si p.sh. librat, makinat, videofilmat dhe aparaturat.

2.2. Gjatë përcaktimit të vlerës së sigurimit, nuk merret parasysh vlera e pasionit personal për sendin.

Neni 7 Dëmshpërbllimi

1. Për ndërtesat, sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve (neni 6, pikat 1.1. dhe 1.2.) palët janë pajtuar që:

1.1. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e re, sipas nenit 6, atëherë

1.1.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.1.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit (vlera e re), e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

1.1.3. Nëse vlera e kohës, e sendit të prekur nga dëmi, në momentin para se dëmi të ndodhte ka qenë më e vogël se 40% e vlerës së re, atëherë kompensohet më së shumti vlera e kohës.

1.1.4. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë, atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

Një ndërtesë është veçanërisht atëherë, pakthyeshmërisht e zhvlerësuar, nëse është vendosur që të rrënohet, ose përgjithësisht nuk është më e shfrytëzueshme, apo veçanërisht nuk është e shfrytëzueshme për qëllimin e paraparë.

Sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve, janë posaçërisht atëherë përgjithmonë të zhvlefësuar, kur janë larguar nga procesi i punës, apo në përgjithësi nuk janë më të përdorueshme, ose nuk janë më të përdorueshme për qëllimin e tyre ekonomik.

1.2. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e kohës, sipas nenit 6, atëherë,

1.2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.2.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e zvogëluar e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit dhe atë e zvogëluar në raportin vlera e kohës me vlerën e re, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

1.2.3. Nëse sendi i dëmtuar, në momentin para se të ndodhë dëmi veç ka qenë i zhvlefësuar përgjithmonë (pika 1.1.4.), atëherë kompensohet më së shumti vlera e tregut.

1.3. nëse sigurimi është kontraktuar me vlerën e tregut, sipas nenit 6, atëherë,

1.3.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

1.3.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e zvogëluar e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit dhe atë e zvogëluar në raportin vlera e tregut me vlerën e re, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

2. Për mallrat dhe rezervat/stoqet (neni 6, pika 1.3.)

2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit në momentin para se të ndodhë dëmi;

2.2. Në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

2.3. në rast se çmimi i aritshëm i shitjes në momentin para se të ndodhë dëmi, duke i hequr atij shpenzimet e kursyera, ka qenë më i ulët se shpenzimet për rripodhimin apo riblerjen, atëherë kompensohet më së shumti kjo vlerë më e vogël.

3. Për paratë dhe vlerat monetare, librezat e kursimit dhe letrat me vlerë (neni 6, pika 1.4.) kompensohen shpenzimet për riblerjen e tyre e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi

4. Për mbajtësit e të dhënave dhe të ngjashme (neni 6, pika 1.5.) kompensohet vlera e shpenzimeve për rikthimin ose riblerjen e tyre, nëse rikthimi i tyre është i nevojshëm, dhe kryhet brenda afatit kohor prej dy vitesh nga çasti kur ka ndodhur dëmi. Në rast të kundërt kompensohet vetëm vlera e materialit.

5. Për automjetet, dhe sendet tjera të lëvizshme (neni 6, pikat 1.6., 1.7. dhe 2.1.)

5.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora, kompensohet vlera e sigurimit para momentit kur ka ndodhur ngjarja e siguruar;

5.2. në rast të dëmtimit, kompensohet vlera e shpenzimeve për riparim në momentin e dëmtimit, e më së larti deri në vlerën e sigurimit, në momentin para se të ndodhë dëmi.

6. Për shpenzimet e siguruara (neni 3, pika 2.), kompensohen shpenzimet e shkaktuara.

7. Rregullat e përgjithshme për dëmshpërbllimin

7.1. Nëse përmes riparimit (ndreqjes/rregullimit) të një sendi, vlera e tij aktuale e sigurimit, në krahasim me vlerën e tij të sigurimit në momentin para dëmtimit ngritet (rilet), atëherë kompensimi për riparimin zvogëlohet për vlerën e diferencës mes atyre dy vlerave..

7.2. Vlera e mbetjes llogaritet po ashtu; Kufizimet e autoriteteve për rindërtim apo për riblerje nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të mbetjeve.

7.3. Për sendet e dala nga dora dhe të gjetura përsëri vlejné marrëveshja se:

7.3.1. Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar të marrë këto sende, nëse kjo mund të kërkohej (nuk është jashtë mase/e tepërt të kërkohej) nga ai.

7.3.2. Nëse sendet gjinden përsëri dhe i kthehen kontraktuesit të sigurimit, dhe atë pasi që është bërë zhdëmtimi, atëherë kontraktuesi i sigurimit duhet të kthejë një shumë të caktuar, e cila llogaritet ashtu, që: vlerës së marrë për zhdëmtim i hiqet vlera e mundshme e zhvlerësimit (amortizimit) të sendit, dhe mbetja është vlera që duhet kthyer. Sendet për të cilat nuk mund të kërkohej (do të ishte e tepërt të kërkohej) nga kontraktuesi i sigurimit që t'i marrë prapë, duhet të kalojnë në pronësi të siguruesit..

7.4. Tek sendet e veçanta, të cilat bashkë me sende tjera përbëjnë një tërësi (komplet), zhvlerësimi i sendeve të veçanta të padëmtuara, që vjen si pasojë e dëmtimit, shkatërrimit apo daljes nga dora e sendeve tjera, që bashkë me të përbëjnë tërësinë, nuk merret parasysh.

Neni 8 Nënsigurimi

Lartësia e dëmshpërbllimit të llogaritur sipas nenit 7, zvogëlohet sipas normave të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12), nëse ka nënsigurim; kjo nuk vlen, nëse bëhet fjalë për një sigurim në rrezik të parë.

Neni 9 Pagesa e dëmshpërbllimit; Rripodhimi/Rindërtimi, Riblerja

1. Kontraktuesi i sigurimit ka fillimisht të drejtën që:

1.1. për ndërtesat

1.1.1. në rast të shkatërrimit të kompensohet me vlerën e kohës, e më së shumti me vlerën e tregut;

1.1.2. në rast të dëmtimit t'i kompensohet lartësia e dëmit në vlerën e kohës, e më së shumti lartësia e dëmit në vlerën e tregut.

1.2. për sendet e përdorimit dhe pajisjet e ndërmarrjeve

1.2.1. në rast të shkatërrimit apo daljes nga dora të zhdëmtohet me vlerën e kohës;

1.2.2. në rast të dëmtimit, të zhdëmtohet me lartësinë e dëmit sipas vlerës së kohës.

1.3. Lartësia e dëmit sipas vlerës së kohës, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e kohës me vlerën e re.

Lartësia e dëmit sipas vlerës së tregut, rri në raport me lartësinë e dëmit sipas vlerës së re, në proporcion të njëjtë sikurse vlera e tregut me vlerën e re.

2. Të drejtën për zhdëmtim, kur ai tejkalon lartësinë e rregulluar me pikën 1 të këtij neni, kontraktuesi i sigurimit e fiton vetëm atëherë nëse kushtet e mëposhtme plotësohen:

2.1. është siguruar, që pagesa e zhdëmtimit do të përdoret në tërësi për rindërtimin/ripodhimin apo riblerjen.

Sendet të cilat para se të ndodhte dëmi, veç kanë qenë të prodhuara, siguruara (blera), apo të porositura, apo kanë qenë në prodhim e sipër, nuk vlejné si të rindërtuara/riprodhuara apo të riblera;

2.2. rindërtimi i ndërtesës bëhet në të njëjtin vend si më parë. Nëse ndërtimi në të njëjtin vend është ndaluar nga ana e autoriteteve (nuk guxon të ndërtohet aty), atëherë mjafton të bëhet rindërtimi në një vend tjetër në Kosovë;

2.3. sendet e rindërtuara/riprodhuara apo të riblera, përdoren për qëllimin e njëjtë si ato më parë (për të cilat paguhet zhdëmtimi);

2.4. rindërtimi/ripodhimi apo riblerja kryhet brenda afatit kohor prej tri vitesh, nga momenti kur ka ndodhur ngjarja e siguruar.

Neni 10 Ekspertiza

Kur është fjalë për ekspertizën, si shtesë e rregullave të kushteve të përgjithshme të sigurimeve të pasurisë (ABV_KS12), futen edhe marrëveshjet në vazhdim:

1. Konkluzionet e të dy ekspertëve duhet të përmbajë pajtësi, edhe vlerën e momentit para rastit të dëmit, të sendeve të prekura nga rasti i dëmit, si dhe vlerën e mbetjeve të tyre.

2. Me kërkesën e cilës do palë kontraktuese, duhet përcaktuar edhe vlera e sigurimit e sendeve të siguruara, e të paprekura nga rasti i dëmit.

Neni 11 Regresi

Kur siguruesi, i kompenzon dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguruesi.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit të thyerjes së xhamave (ABG_KS12 / niveli 2)

Pjesa e përgjithshme

Për këtë sigurim vlejné kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12).

Pjesa e veçantë

Përmbajtja

Neni 1	Rreziqet dhe dëmet e siguruar
Neni 2	Dëmet e pasiguruar
Neni 3	Sendet dhe shpenzimet e siguruar
Neni 4	Shtirirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit
Neni 5	Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi
Neni 6	Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi
Neni 7	Vlera e sigurimit
Neni 8	Dëmshpërblimi
Neni 9	Nënsigurimi
Neni 10	Regresi

Neni 1
Rreziqet dhe dëmet e siguruar
Të siguruar janë dëmet e shkaktuara nga thyerja në xhamat e siguruar (neni 3).

Neni 2
Dëmet e pasiguruar

Të pasiguruar janë:

1. Dëmet që përbëhen vetëm nga grithja, gërvishja, apo copëzimi i qosheve të xhamave, i sipërfaqes së xhamave apo i folieve, ngjyrosjeve, shkrimeve dhe shtresave bashkë me shtresën e pasqyrës të vendosura në xhamat;
2. Dëmet në skelete dhe korniza;
3. Dëmet vijuese(rrjedhëse/pasojë);
4. Dëmet nga zjarri, rrufeja, eksplozimi apo rrëzimi i fluturakeve;
5. Dëmet që shkaktohen gjatë vendosjes(montimit), zhvendosjes(heqjes) apo gjatë transportimit të xhamave;
6. Dëmet që shkaktohen gjatë punëve në xhamat apo në skeletet dhe kornizat e tyre. Dëmet gjatë pastrimit janë të siguruar;
7. Dëmet që shkaktohen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e ndikimit të
 - 7.1. Luftës së çdo forme - me ose pa shpallje të luftës, duke ia bashkangjitur kësaj edhe të gjitha veprimet e dhunshme nga ana e shteteve, dhe organizatave politike apo terroriste;
 - 7.2. trazirave të brendshme, luftës qytetare, revolucionit, rebelimit, turbullirave, kryengritjes;
 - 7.3. veprimeve ushtarake dhe veprimeve të autoriteteve tjera, që lidhen me ngjarjet e përmendura në pikat 7.1. dhe 7.2. të këtij neni;
 - 7.4. Tërmetit apo ngjarjeve të tjera të pazakonshme natyrore;
 - 7.5. Energjisë bërthamore, izotopeve radioaktive apo rrezatimit jonizues.

Për pikën 7 vlen: Është obligim i kontraktuesit të sigurimit, të dëshmojë se dëmi i ndodhur, nuk vjen si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e ndonjëres/disave nga ngjarjet e përmendura në pikat 7.1. deri 7.5.

Neni 3
Sendet dhe shpenzimet e siguruar
1. Sendet e siguruar

Të siguruar janë xhamat e qelqit, artificial dhe të tjerë të shënuar në policë.

2. Shpenzimet e siguruar

Vetëm nëse lidhet marrëveshje e veçantë, janë të siguruar :

- 2.1. Shpenzimet e lëvizjes dhe të mbrojtjes, këto janë shpenzime, që krijohen për shkak të nevojës për të lëvizur ndryshuar apo mbrojtur sendet tjera në mënyrë që sendet e siguruar të mund të rikthehen në gjendjen e mëparshme apo të riblehen; këto janë veçanërisht shpenzimet për de- dhe rimontimin e grilave mbrojtës, shkopinjve mbrojtës dhe të ngjashme.
- 2.2. Shpenzimet e heqjes së mbeturinave, këto janë shpenzimet për kontrollimin, heqjen, trajtimin dhe deponimin e sendeve të siguruar e të prekura nga dëmi.
- 2.3. Shpenzimet për vendosjen e xhamave apo mbështjellësve provizor nga shtrëngesa(nevoja e ngutshme) si dhe për pagesat shtesë jashtë orarit të punës.

Neni 4
Shtirirja territoriale e vlefshmërisë së sigurimit
Xhamat e siguruar, janë të siguruar vetëm në vendin e sigurimit të shënuar në policë.

Neni 5
Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit para se të ndodhë dëmi
Kontraktuesi i sigurimit është i obliguar t'i mirëmbajë si duhet kornizat dhe skeletet e xhamave të siguruar.
Nëse kontraktuesi i sigurimit shkelë këtë detyrim atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 6
Detyrimet e kontraktuesit të sigurimit në rast se ndodh dëmi
1. Obligimi i zvogëllimit të dëmit
Në rast të dëmit apo të kërcënimit direkt që dëmi të ndodhë, kontraktuesi i sigurimit duhet që sipas mundësive,
- të kujdeset që të ruaj dhe shpëtojë xhamat e siguruar ;
- për këtë të marrë udhëzime nga siguruesi dhe t'u përmbahet atyre udhëzimeve.
2. Obligimi i lajmërimit të dëmit
Secili dëm duhet lajmëruar menjëherë tek siguruesi.
3. Obligimi i zbardhjes së rastit të dëmtimit
3.1. Siguruesit duhet mundësuar nëse kjo është e mundur çdo hetim për përcaktimin e shkakut dhe lartësisë së dëmit të siguruar, apo të mbulesës siguruese të tij.
3.2. Gjatë procesit të përcaktimit të dëmit, siguruesit duhet dhënë mbështetjen e nevojshme, dhe nëse nga ai kërkohet, t'i japin në shfrytëzim dokumentet përkatëse. Shpenzimet për këto i mban kontraktuesi i sigurimit.
3.3. Nëse dëmi është shkaktuar nga një person i tretë, atëherë siguruesit duhet bërë të njohur shkaktarin dhe dëshmitarët eventuale nëse kjo gjë është e mundur.
4. Pasojat ligjore në rast të shkeljes së detyrimit të përcaktuar me këtë nen
Nëse kontraktuesi i sigurimit shkel ndonjërin nga këto obligime, atëherë ai është i detyruar ta zhdëmtojë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Neni 7
Vlera e sigurimit
Vlera e sigurimit për xhamat e siguruar është e barabartë me shumën e shpenzimeve në atë vend(regjion) për riprodhimin apo riblerjen(sigurimin) e tyre dhe të shpenzimeve për nxjerrjen dhe pastrimin e mbetjeve të thyerjes. Shpenzimet e cekura tek neni 3.2 nuk janë pjesë e vlerës së sigurimit.

Neni 8
Dëmshpërblimi
1. Dëmshpërblimi paguhet për shpenzimet në atë vend(regjion) për riprodhimin apo riblerjen e xhamave të siguruar e të prekura nga dëmi dhe për shpenzimet e nxjerrjes dhe pastrimit të mbetjeve të thyerjes(Shpenzimet e riparimit).
Për shpenzimet shtesë që dalin si pasojë e përdorimit të ndonjë shërbimi të menjëhershëm nuk paguhet dëmshpërblim.
2. Nëse xhami i siguruar ka qenë i pavlerë(i amortizuar përgjithmonë) para se të ndodhë dëmi, atëherë për të nuk paguhet dëmshpërblim.
Një xham quhet veçanërisht atëherë i pavlerë(përgjithmonë i amortizuar), nëse nuk është më i përshtatshëm të përdoret për qëllimin e tij të përdorimit apo të përdoret në përgjithësi.

Neni 9
Nënsigurimi
Sipas nenit 8 lartësia e dëmshpërblimit të llogaritur zvogëlohet sipas normave të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12), nëse ka nënsigurim; kjo nuk vlen, nëse bëhet fjalë për një sigurim në rrezik të parë.

Neni 10
Regresi
Kur siguruesi, i kompenson dëmin, të siguruarit apo kontraktuesit të sigurimit, atëherë çdo e drejtë e të siguruarit apo e kontraktuesit të sigurimit ndaj personave të tretë për kompensimin e atij dëmi, kalon tek siguruesi.

Kushtet shtesë të sigurimit nga stuhia për ndërmarrjet industriale, ato të zanatit dhe të tjera (ZB_St_IG_KS12/ niveli 3)

Përmbajtja

1. Sendet e siguruar
 - 1.1. Objeklet
 - 1.2. Lokali
 - 1.3. Pajisjet e ndërmarrjes
 - 1.4. Mallrat dhe rezervat
 - 1.5. Sende të tjera
2. Rregullat tjera - Bazamenti i makinerive

1. Sendet e siguruar

Nëse sendet e siguruar në policë përshkruhen me ndonjë personifikim, dhe nëse nuk është ndryshe e rregulluar me kontratë, atëherë vlejnë këto rregulla për kategorizim:

- 1.1. Ndërtesat janë të siguruar bashkë me të gjitha pjesët e tyre të ndërtuara mbi dhe nën sipërfaqen e tokës, përveç xhamave, dhe xhamave artificial të çfarëdo lloji përfshirë edhe kupolat e dritës.
- 1.1.1. Si ndërtesë/godinë llogariten(fjala ndërtesë/godinë është personifikim i):

- të gjitha ndërtesat në kuptimin e ngushtë, e ato janë të gjitha veprat ndërtimore të cilat përmes kufizimeve të hapësirave i mbrojnë njerëzit dhe sendet nga ndikimet e jashtme, i mundësojnë njerëzve hyrjen në to, si dhe janë të lidhura fort me tokën dhe kanë një qëndrueshmëri të caktuar;

- po ashtu ndërtimet që kanë ndonjëherë nga veçoritë në vijim:

përbëjnë një pjesë konstruktive të ndërtesës/godinës në mënyrë dominante kanë strukturë tekniko-ndërtimore, në kontabilitet, klasifikohen zakonisht si ndërtesa/godina.

Të tilla mund të jenë: strehët, urat lidhëse, platformat(rampat), zgafella e ashensorit, siloset, bunkerët, fuçitë e ujit dhe mbajtësit tjerë, tymtarët, kanalet dhe pusët/pusetat, korridoret lidhëse.

1.1.2. Vetëm me marrëveshje të posaçme janë të siguruar:

Kulmet e rrafshçota, kampstëpizat, barakat e shesheve të ndërtimit, lëndat, rrethojat, çadrat dhe kiosqet.

1.1.3. Ndërtesë/godinë flogariten të gjitha pjesët e ndërtesave bashkë me pajisjet e tyre të cilat në librat e kontabilitetit janë klasifikuar si ndërtesë/godinë. Si p.sh.:

- Rrufepitësit
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehtësisë së ujit, ato të ndërtimit, të ajrosjes, klimatizimit, të alarmimit për zjarr apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashensorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet(tubat, kabllo,...) e tyre
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orëditë për ndarjen e hapësirave apo mobiliet e integruara(montuara)
- shtresat fikse të dysheveve dhe mureve, veshjet me pllaka të shtrura; llamperitë e montuara fiks, dhe veshjet tjera të mureve.
- shkallët e lidhura fort me objektin, shkallët nëse janë vendosur nga jashtë
- dyert me lëvizje elektromekanike dhe/ose me ngrohjen elektrike bashkë me instalimet drejtuese dhe/ose me elemente të ngrohjes
- Stufat e murosura për nxehtjen e hapësirave
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.1.4. Vetëm me marrëveshje të posaçme janë të siguruar këto pjesë plotësuese të ndërtesës:

Shtizat për flamuj, postbuloqet brenda hapësirës së rrethuar, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet e përdorimit të tyre, si edhe aparatet solare.

1.1.5. Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina)

Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina) mbulon rritjen e vlerës, ndërtimet e reja ato shtesë dhe përshtatjet, pastaj mbulon edhe rregullimin(vënien në gjendje të rregullt), vlerësimin e pamjaftueshëm si dhe godinat apo pjesët e tyre të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi shërben për vënien në ekuilibër të nën sigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumat e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nën sigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nën sigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.2. Lokalit

1.2.1. Të siguruar janë të gjitha pjesët e ndërtesës, të cilat ndodhen brenda lokalit të siguruar (hapësirave të siguruar), dhe po ashtu pjesët e mureve dhe

tavaneve të hapësirave të siguruar, të cilat janë të domosdoshme për përdorimin normal të hapësirave të siguruar dhe janë pronë e kontraktuesit të sigurimit.

1.2.2. Brenda hapësirave të siguruar, sigurohen:

- Ngjyrosjet, Tapetat, Pllakat e shtrura, Dyshemetë, veshjet e mureve dhe të tavaneve.
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehtësisë së ujit, ato të ndërtimit, të ajrosjes, klimatizimit, të alarmimit për zjarr apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashensorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet(tubat, kabllo,...) e tyre
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orëditë për ndarjen e hapësirave apo mobiliet e integruara(montuara)
- shtresat fikse të dysheveve dhe mureve, veshjet me pllaka të shtrura; llamperitë e montuara fiks, dhe veshjet tjera të mureve
- Stufat e murosura për nxehtjen e hapësirave
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.2.3 Të pasiguruar janë:

- hapësirat (dhomat) plotësuese si ato të: podrunit, tavanit, shupat e drurit, garazhet, etj
- markizat, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet përdoruese të tyre që u takojnë hapësirave të siguruar

1.3. Pajisjet e ndërmarrjes

1.3.1. Aty hyjnë të gjitha pajisjet që i shërbejnë asaj ndërmarrje e që gjenden në vendin e sigurimit dhe atë brenda godinës, përveç nëse janë pjesë e pajisjeve teknike të godinës të përkufizuara me pikën 1.1.3.

Pajisje të ndërmarrjes flogariten posaçërisht:

- makineritë, pajisja, impiantet dhe instalimet për prodhim, transformim, përcim, magazinim dhe konsumim të energjisë në të gjitha format.

Aty hyjnë po ashtu: pajisjet për (tharje dhe djegëje, furra për prodhimin e tullave, majolikave, porcelanit dhe të sendeve të ngjashme, e po ashtu edhe kthinat për tymosje, trafostacionet, instalimet për klimatizim dhe pastrimit të ajrit.

- Makinat, pajisjet, impiantet dhe instalimet për prodhimin, përpunimin, transmetimin, , dërgimin dhe ruajtjen e të dhënave, informacioneve, dhe njoftimeve të çfarëdo tipi(mirëpo pa mbajtësit e të dhënave – pika 1.5.2.)

- Pajisjet, impiantet, aparatat dhe instalimet për matjen, kontrollimin, rregullimin dhe drejtimin e produkteve, gjendjes operative dhe hapave punues të të gjitha llojeve.

- Pajisjet, impiantet, aparatat dhe instalimet për transportimin e personave, materialit, mallrave dhe lëndëve të të gjitha llojeve, po ashtu aparatave absorbuese dhe instalimeve të tubacioneve të ujit e ku hyjnë të gjitha aparatat për furnizimin dhe heqjen e ujërave bashkë me aparatat matëse, armaturat, filtrat dhe pjesët plotësuese

- Automjetet e të gjitha llojeve, makinat punuese vetëlëvizëse si dhe rimorkiot, mirëpo jo nëse ato automjete hyjnë në grupin e automjeteve me regjistrim nga autoritetet(pika 1.5.1.), përveç nëse janë automjete për fikjen e zjarrit

- Pajisjet, impiantet, këllëfët(mbajtësit), dhe enët për magazinimin e materialeve, mallrave dhe materieve të të gjitha llojeve; po ashtu ambalazhi që mund të riciklohet, paletat, kontejnerët si dhe pajisja e depove me rafte të larta

- Makinat e punës të të gjitha llojeve bashkë me elementet e tyre të vënies në lëvizje dhe pjesët e tyre plotësuese

- Siloset, bunkerët, fuçitë për ujë e të tjera, oxhaqet, kanalet, pusët/pusetat, nëse këto përdoren për prodhim dhe nuk flogariten si ndërtesë(godinë); bazamenti i maqinave

- Veglat e punës në impiantet e prodhimit duke përfshirë edhe katalizatorët

- makinat manuale dhe aparatet e çfarëdo lloji

- Veglat e punës bashkë me mjetet ndihmëse të prodhimit të të gjitha llojeve për përdorim me dorë apo me maquina, përveç nëse hyjnë në grupin e mjeteve ndihmëse për replikim(riprodhim) (pika 1.5.3.)

- Pajisjet e zyrave të të gjitha llojeve, bashkë me revistat dhe librat, pajisjet dhe rrobat e punës të të gjitha llojeve; pajisjet e dhomave(hapësirave) të përbashkëta, atyre të akomodimit dhe të mysafirëve si dhe pajisjet e kuzhinave, kantinave, bibliotekave dhe të hapësirave të ngjashme.

- Impiantet për fikjen e zjarrit, mbrojtjen nga zjarri, mbrojtjen në punë, impiantet sanitare dhe sportive

- mbishkrimet e firmës dhe pajisja propagandistike, mjetet e propagandës dhe të dekorimit.

- pajisjet e hequra nga përdorimi dhe ato rezervë; Pjesët rezervë dhe sendet ende të pa montuara(ndërtuara), e që janë për pajisjet e reja të gjithë atyre llojeve të përmendura më lart(më parë), si dhe pjesët rezervë për automjete.

1.3.2. Vetëm me marrëveshje të posaçme janë të siguruar:

Sendet e lëvizshme në vend të hapur ose në transport dhe impiantet e jashtme, si për shembull, mbishkrimet e firmave dhe instalimet e reklamës të çfarëdo lloji.

1.3.3. Sigurimi plotësues për pajisjet e ndërmarrjes

Sigurimi plotësues mbulon rritjen e vlerës, rregullimin(vënien në gjendje të rregullt), blerjen, ndërtimin, vlerësimin e pamjaftueshëm si dhe pajisjet të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi shërben për vënien në ekuilibër të nën sigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumat e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nën sigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nën sigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.4. Mallrat dhe rezervat

Aty hyjnë të gjitha mallrat dhe rezervat që gjenden në vendin e sigurimit dhe ndodhen brenda godinave. Në këtë grup hyjnë lënda e parë, prodhimet gjysmëfinale dhe finale me të cilat punohet, pjesët e gatshme të blera, mallrat tregtare të të gjitha llojeve, mbeturinat e përdorueshme, prospektet dhe reklammat, materialit shpenzues dhe ndihmës të çfarëdo lloji, tretësit, vajrat, materialet për ngrohje dhe ndezje, gazrat teknik, materiali ndërtimor, materiali hedonist, ambalazhi i përcikluarshëm i çfarëdo lloji, si dhe metalet e çmuara dhe gurët e çmuarshëm që shërbejnë për qëllime të prodhimtarisë.

Vetëm me marrëveshje të posaçme janë të siguruar:

Maltrat dhe rezervat në vend të hapur ose në transport.

1.5. Sendet e tjera

Këtu bëjnë pjesë sendet e mëposhtme që gjenden në vendin e sigurimit brenda në objekte dhe që përdoren në sipërmarrje:

1.5.1. Automjetet

Automjetet rrugore, mjetet funduese, mjetet fluturuese me teje zyrtare (përveç automjeteve zjarrfikëse – pika 1.3.1);

1.5.2. Mbjatësit e të dhënave të të gjitha llojeve, bashkë me programet dhe të dhënat që gjenden në ta. Të tillë janë p.sh. librat e ndërmarrjes, dosjet, planet, ruajtësit magnetik, mikrofilmat dhe të ngjashme;

1.5.3. Materialot ndihmëse të reproduktimit(replikimit)

Në këtë grup hyjnë të gjitha gjërat që i shërbejnë ndërmarrjes, e të cilat i përgjigjen këtij përkufizimi (definicioni):

Materiali ndihmës i reproduktimit(replikimit) mban në vete një formë, një model/shabllon, dizajn, shkrim apo informacion tjetër për një produkt të veçantë, dhe e njëjta formë (model/shabllon, dizajn, shkrim, informacion tjetër) bartet në produkt, ku në rast të ndryshimit të produktit apo përfundimit të prodhimit të atij produkti, materiali ndihmës i reproduktimit(replikimit) nuk është më i përdorueshëm apo të paktën duhet të ndryshohet për t'u përdorur sërish.

Këso materiale janë p.sh.: kallëpet e derdhjeje, shabllonet e të gjitha formave, format e derdhjeje, injektive dhe ndrydhjeje, modelet, stampuesit(biruesit), matricat, klishetë, pllakat dhe cilindrat e shtypshkronjave e të tjera.

1.5.4. Paratë dhe sendet me vlerë paraje

Në to hyjnë: paratë dhe sendet me vlerë paraje të çfarëdo lloji, librezat e kursimit me apo pa fjalëkalim, letrat me vlerë me kurs zyrtar dhe letrat tjera me vlerë;

1.5.5. Sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes

Në sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes **nuk bëjnë pjesë** paratë, dhe sendet me vlerë paraje, stollitë, automjetet dhe sendet që gjenden në ndërtesat e banimit si inventar shtëpie.

1.5.6. Sendet e tjera në vend të hapur ose në transport janë të siguruar vetëm në bazë të marrëveshjes së posaçme.

2. Rregullat tjera

Bazamenti i makinave

Nëse bazamentet e makinave nuk janë përjashtuar nga sigurimi, atëherë bazamenti i makinës së dëmtuar nga ngjarja e siguruar është i siguruar nga dëmi, deri tek i cili dëm vjen kur bazamenti i asaj maqine, pa marrë parasysh se a është dëmtuar / shkatërruar apo jo, për shkakë teknike bëhet pjesërisht apo plotësisht i papërdorueshëm për rindërtimin / riparimin e asaj maqine.

Kushtet shtesë të sigurimit nga uji i tubacioneve për ndërmarrjet industriale, ato të zanatit dhe të tjera (ZB_W_IG KS12 / niveli 3)

Përmbajtja

1.Sendet e siguruar

1.1.Objektet

1.2. Lokali

1.3.Pajisjet e ndërmarrjes

1.4.Mallrat dhe rezervat

1.5.Sende të tjera

2.Rregullat tjera - Bazamenti i makinerive

1. Sendet e siguruar

Nëse sendet e siguruar në pollicë përshkruhen me ndonjë personifikim, dhe nëse nuk është ndryshe e rregulluar me kontratë, atëherë vlejnë këto rregulla për kategorizim:

1.1. Ndërtesat janë të siguruar bashkë me të gjitha pjesët e tyre të ndërtuara mbi dhe nën sipërfaqen e tokës.

1.1.1. Si ndërtesë/godinë llogariten(fjala ndërtesë/godinë është personifikim i):

- të gjitha ndërtesat në kuptimin e ngushtë, e ato janë të gjitha veprat ndërtimore të cilat përmes kufizimeve të hapësirave i mbrojnë njëri-tjetër dhe sendet nga ndikimet e jashtme, i mundësojnë njerëzve hyrjen në to, si dhe janë të lidhura fort me tokën dhe kanë një qëndrueshmëri të caktuar;
- po ashtu ndërtimet që kanë ndonjërin nga veçoritë në vijim:

përbëjnë një pjesë konstruktive të ndërtesës/godinës në mënyrë dominante kanë strukturë tekniko-ndërtimore. në kontabilitet, klasifikohen zakonisht si ndërtesa/godina.

Të tilla mund të jenë: Mbistrehët, kampshëpizat, barakat e shesheve të ndërtimit, tendat, çatitë e rrafshëta, strehët, urat lidhëse, platformat(rampat), zgafella e ashensorët, siloset, bunkerët, fuçitë e ujit dhe mbajtësit tjerë, tymtarët, kanalet dhe pusët/pusetat, korridoret lidhëse, rrethojat.

1.1.2. Ndërtesë/godinë llogariten të gjitha pjesët e ndërtesave bashkë me pajisjet e tyre të cilat në librat e kontabilitetit janë klasifikuar si ndërtesë/godinë. Si p.sh.:

- Rrufepritisit
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehjes së ujit, ato të ndriçimit, të ajrosjes, aklimatizimit, të alarmimit për zjarr apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashensorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet(tubat, kabllo, ...) e tyre
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orënditë për ndarjen e hapësirave apo mobiliet e integruara(montuara)
- shtresat fikse të dyshemeve dhe mureve, veshjet me pllaka të shtruara; llamperitë e montuara fikse, dhe veshjet tjera të mureve
- shkallët e lidhura fort me objektin, shkallët dhe shtizat për flamuj, nëse janë vendosur nga jashtë
- dyert (në rrethoja edhe shtyllat e postblokut) me lëvizje elektromekanike dhe/ose me nxehje elektrike (në rrethime edhe pamakët) bashkë me instalimet drejtuese dhe/ose me elemente të ngrohjes
- markizat, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet punuese.
- Stufat e murosura për nxehjen e hapësirave
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.1.3. Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina)

Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina) mbulon rritjen e vlerës, ndërtimet e reja ato shtesë dhe përshtatjet, pastaj mbulon edhe rregullimin(vënien në gjendje të rregullt), vlerësimin e pamjaftueshmë si dhe godinat apo pjesët e tyre të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi shërben për vënien në ekuilibër të nënsigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumat e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nënsigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nënsigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.2. Lokali

1.2.1. Të siguruar janë të gjitha pjesët e ndërtesës, të cilat ndodhen brenda lokalit të siguruar (hapësirave të siguruar), dhe po ashtu pjesët e mureve dhe tavaneve të hapësirave të siguruar, të cilat janë të domosdoshme për përdorimin normal të hapësirave të siguruar dhe janë pronë e kontraktuesit të sigurimit.

1.2.2. Brenda hapësirave të siguruar, sigurohen:

- Ngjyrosjet, Tapetat, Pllakat e shtruara, Dyshemetë, veshjet e mureve dhe të tavaneve.
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehjes së ujit, ato të ndriçimit, të ajrosjes, aklimatizimit, të alarmimit për zjarr apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashensorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet(tubat, kabllo, ...) e tyre
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orënditë për ndarjen e hapësirave apo mobiliet e integruara(montuara)
- shtresat fikse të dyshemeve dhe mureve, veshjet me pllaka të shtruara; llamperitë e montuara fikse, dhe veshjet tjera të mureve
- Stufat e murosura për nxehjen e hapësirave
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.2.3 Të pasiguruar janë:

- hapësirat (dhomat) plotësuese si ato të: podrumit, tavanit, shupat e drurit, garazhet, etj
- markizat, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet punuese që u takojnë hapësirave të siguruar

1.3. Pajisjet e ndërmarrjes

1.3.1. Aty hyjnë të gjitha pajisjet që i shërbejnë asaj ndërmarrje e që gjenden në vendin e sigurimit dhe atë brenda godinës, përveç nëse janë pjesë e pajisjeve teknike të godinës të përkufizuara me pikën 1.1.2.

Pajisje të ndërmarrjes llogariten posaçërisht.

- makineritë, pajisja, implantet dhe instalimet për prodhim, transformim, përcim, magazinim dhe konsumim të energjisë në të gjitha format.

Aty hyjnë po ashtu: pajisjet për tharje dhe djegëje, furrat për prodhimin e tullave, majolikave, porcelanit dhe të sendeve të ngjashme, e po ashtu edhe kthinat për tymosje, trafostacionet, instalimet për aklimatizim dhe pastrimit të ajrit..

- Makinat, pajisjet, impiantet dhe instalimet për prodhimin, përpunimin, transmetimin, dërgimin dhe ruajtjen e të dhënave, informacioneve, dhe njoftimeve të çfarëdo tipi (mirëpo pa mbajtësit e të dhënave – pika 1.5.2.)
- Pajisjet, impiantet, aparaturat dhe instalimet për matjen, kontrollimin, rregullimin dhe drojtimin e produkteve, gjendjes operative dhe hapave punës të të gjitha llojeve.
- Pajisjet, impiantet, aparaturat dhe instalimet për transportimin e personave, materialit, mallrave dhe lëndëve të të gjitha llojeve, po ashtu aparaturave absorbuese dhe instalimeve të tubacioneve të ujit e ku hyjnë të gjitha aparaturat për furnizimin dhe heqjen e ujërave bashkë me aparaturat matëse, amaturat, filtrat dhe pjesët plotësuese
- Automjetet e të gjitha llojeve, makinat punuese vetëlëvizëse si dhe rimorkiot, mirëpo jo nëse ato automjete hyjnë në grupin e automjeteve me regjistrim nga autoritetet (pika 1.5.1.), përveç nëse janë automjete për fikjen e zjarrit
- Pajisjet, impiantet, këllëfët (mbajtësit), dhe enët për magazinimin e materialeve, mallrave dhe materialeve të të gjitha llojeve; po ashtu ambalazhi që mund të riciklohet, paletat, kontejnerët si dhe pajisja e depove me raftë të larta
- Makinat e punës të të gjitha llojeve bashkë me elementet e tyre të vënies në lëvizje dhe pjesët e tyre plotësuese
- Siloset, bunkerët, fuqitë për ujë e të tjera, oxhaqet, kanalet, pusët/pusetat, nëse këto përdoren për prodhim dhe nuk llogariten si ndërtesë (godinë); bazamenti i makinave
- Veglat e punës në impiantet e prodhimit duke përfshirë edhe katalizatorët
- makinat manuale dhe aparatet e çfarëdo lloji
- Veglat e punës bashkë me mjetet ndihmëse të prodhimit të të gjitha llojeve për përdorim me dorë apo me makinë, përveç nëse hyjnë në grupin e mjeteve ndihmëse për replikim (riprodhim) (pika 1.5.3.)
- Pajisjet e zyrave të të gjitha llojeve, bashkë me revistat dhe librat, pajisjet dhe robat e punës të të gjitha llojeve; pajisjet e dhomave (hapësirave) të përbashkëta, atyre të akomodimit dhe të mysafirëve si dhe pajisjet e kuzhinave, kantinave, bibliotekave dhe të hapësirave të ngjashme
- Impiantet për fikjen e zjarrit, mbrojtjen nga zjarri, mbrojtjen në punë, impiantet sanitare dhe sportive
- mbishkrimet e firmës dhe pajisja propagandistike, mjetet e propagandës dhe të dekorimit.
- pajisjet e hequra nga përdorimi dhe ato rezervë; Pjesët rezervë dhe sendet ende të pa montuara (ndërtuara), e që janë për pajisjet e reja të gjithë atyre llojeve të përmendura më lart (më parë), si dhe pjesët rezervë për automjete.

1.3.2. Sigurimi plotësues për pajisjet e ndërmarrjes

Sigurimi plotësues mbulon rritjen e vlerës, rregullimin (vënien në gjendje të rregullt), blerjen, ndërrimin, vlerësimin e pamjaftueshëm si dhe pajisjet të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi shërben për vënien në ekuilibër të nën sigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumet e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nën sigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nën sigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.4. Mallrat dhe rezervat

Aty hyjnë të gjitha mallrat dhe rezervat që gjenden në vendin e sigurimit dhe ndodhen brenda godinave. Në këtë grup hyjnë lënda e parë, prodhimet gjysmëfinale dhe finale me të cilat punohet, pjesët e gatshme të blera, mallrat tregtare të të gjitha llojeve, mbeturinat e përdorueshme, prospektet dhe reklamata, materialit shpenzues dhe ndihmës të çfarëdo lloji, tretësit, vajrat, materialet për ngrohje dhe ndezje, gazrat teknik, materiali ndërtimor, materiali hedonist, ambalazhi i parecikluarshëm i çfarëdo lloji, si dhe metalet e çmuara dhe gurët e çmuarshëm që shërbejnë për qëllime të prodhimtarisë.

1.5. Sendet e tjera

Këtu bëjnë pjesë sendet e mëposhtme që gjenden në vendin e sigurimit brenda në objekte dhe që përdoren në sipërmarrje:

1.5.1. Automjetet

Automjetet rrugore, mjetet lundruese, mjetet fluturuese me leje zyrtare (përveç automjeteve zjarfikëse – pika 1.3.1);

1.5.2. Mbajtësit e të dhënave të të gjitha llojeve, bashkë me programet dhe të dhënat që gjenden në ta. Të tilla janë p.sh. librat e ndërmarrjes, dosjet, planet, ruajtësit magnetik, mikrofilmat dhe të ngjashme;

1.5.3. Materialet ndihmëse të reproduktimit (replikimit)

Në këtë grup hyjnë të gjitha gjërat që i shërbejnë ndërmarrjes, e të cilat i përgjigjen këtij përkufizimi (definicioni):

Materialet ndihmëse i reproduktimit (replikimit) mban në vete një formë, një model/shabllon, dizajn, shkrim apo informacion tjetër për një produkt të veçantë, dhe e njëjta formë (model/shabllon, dizajn, shkrim, informacion tjetër) bartet në produkt, ku në rast të ndryshimit të produktit apo përfundimit të prodhimit të atij produkti, materiali ndihmës i reproduktimit (replikimit) nuk është më i përdorueshëm apo të paktën duhet të ndryshohet për t'u përdorur sërish.

Këso materiale janë p.sh.: kallëpet e derdhjeje, shabllonet e të gjitha formave, format e derdhjeje, injektive dhe ndrydhjeje, modelet, stampuesit (buresit), matricat, klishtë, pllakat dhe cilindrat e shlypshkronjeve e të tjera.

1.5.4. Paratë dhe sendet me vlerë paraqe

Në to hyjnë: paratë dhe sendet me vlerë paraqe të çfarëdo lloji, librezat e kursimit me apo pa fjalëkalim, letrat me vlerë me kurs zyrtar dhe letrat tjera me vlerë;

1.5.5. Sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes

Në sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes nuk bëjnë pjesë paratë, dhe sendet me vlerë paraqe, stolitë, automjetet dhe sendet që gjenden në ndërtesat e banimit si inventar shtëpie.

2. Rregullat tjera

Bazamenti i makinave

Nëse bazamentet e makinave nuk janë përjashtuar nga sigurimi, atëherë bazamenti i makinës së dëmtuar nga ngjarja e siguruar është i siguruar nga dëmi, deri tek i cili dëm vjen kur bazamenti i asaj maqine, pa marrë parasysh se a është dëmtuar / shkatërruar apo jo, për shkakë teknike bëhet pjesërisht apo plotësisht i papërdorueshëm për rindërtimin / riparimin e asaj maqine.

Kushtet shtesë të sigurimit nga zjarri për ndërmarrjet industriale, ato të zanatit dhe të tjera (ZB_F_IG_KS12 / niveli 3)

Përmbajtja

- Sendet e siguruara
 - Ndërtesat
 - Lokali
 - Pajisjet e ndërmarrjes
 - Mallrat dhe rezervat
 - Sendet tjera
- Rreziqet dhe dëmet e siguruara dhe të pasiguruara
 - Dëmet nga shpërthimi i lëndëve plasëse
 - Bazamenti i makinerive
 - Masat e përgjithshme të sigurisë
 - Ushtrimi i çfarëdo veprimtarie me rrezik të shtuar nga zjarri
 - Mbrojtja ndërtimore nga zjarri, pajisja kundër zjarrit
 - Ngarkesa elektrostatische
 - Impiantet për ndezje dhe ngrohje
 - Punimet nga ana e të papunësuarve në ndërmarrje
 - Rendi dhe pastërtia, shikimi kontrollues
 - Magazinimet
 - Shtojca

1. Sendet e siguruara

Nëse sendet e siguruara në policë përshkruhen me ndonjë personifikim, dhe nëse nuk është ndryshe e rregulluar me kontratë, atëherë vëjnë këto rregulla për kategorizim:

1.1. Ndërtesat janë të siguruara bashkë me të gjitha pjesët e tyre të ndërtuara mbi dhe nën sipërfaqen e tokës.

1.1.1. Si ndërtesë/godinë llogariten (fjala ndërtesë/godinë është personifikim i):

- të gjitha ndërtesat në kupimin e ngushtë, e ato janë të gjitha veprat ndërtimore të cilat përmes kufizimeve të hapësirave i mbrojnë njerëzit dhe sendet nga ndikimet e jashtme, i mundësojnë njerëzve hyrjen në to, si dhe janë të lidhura fort me tokën dhe kanë një qëndrueshmëri të caktuar;

- po ashtu ndërtimet që kanë ndonjërin nga veçoritë në vijim:

përbëjnë një pjesë konstruktive të ndërtesës/godinës në mënyrë dominuese kanë strukturë tekniko-ndërtimore. në kontabilitet, klasifikohen zakonisht si ndërtesa/godina.

Të tilla mund të jenë: Mbistrehët, kampshpëtzat, barakat e shesheve të ndërtimit, magazinat me balona mbajtës të ndërtimit, çatitë e rrafshëta, strehët, urat lidhëse, platformat (rampat), zgafellja e ashensorit, siloset, bunkerët, fuqitë e ujit dhe mbajtësit tjerë, tymtarët, kanalet dhe pusët/pusetat, korridoret lidhëse, rrethojat.

1.1.2. Ndërtesë/godinë llogariten të gjitha pjesët e ndërtesave bashkë me pajisjet e tyre të cilat në librat e kontabilitetit janë klasifikuar si ndërtesë/godinë. Si p.sh.:

- Rrufeprilësit
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehjes së ujit, ato të ndërrimit, të ajrosjes, aklimatizimit, të alarmimit për zjar apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashensorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet (tubat, kabllot, ...) e tyre.
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orënditë për ndarjen e hapësirave apo mobillet e integruara (montuara)

- shtresat fikse të dysHEMEVE dhe MUREVE, veshjet me pllaka të shtruara; llamperitë e montuara fiks, dhe veshjet tjera të mureve.
- shkallët e lidhura fort me objektin, shkallët dhe shtizat për flamuj, nëse janë vendosur nga jashtë
- dyert (në rrethoja edhe shtyllat e postbllokut) me lëvizje elektromekanike dhe/ose me nxehtë elektrike (në rrethime edhe pamakët) bashkë me instalimet drejtuese dhe/ose me elemente të ngrohjes;
- markizat, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet punuese;
- Stufat e murosura për nxehtjen e hapësirave.
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.1.3. Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina)

Sigurimi plotësues për ndërtesa(godina) mbulon rritjen e vlerës, ndërtimet e reja ato shtesë dhe përshtatjet, pastaj mbulon edhe rregullimin(vënien në gjendje të rregullt), vlerësimin e pamjaftueshmësi si dhe godinat apo pjesët e tyre të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi

shërben për vënien në ekuilibër të nënsigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumat e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nënsigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nënsigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.2. Lokali

1.2.1. Të siguruarat janë të gjitha pjesët e ndërtesës, të cilat ndodhen brenda lokalit të siguruar(hapësirave të siguruar), dhe po ashtu pjesët e mureve dhe tavaneve të hapësirave të siguruar, të cilat janë të domosdoshme për përdorimin normal të hapësirave të siguruar dhe janë pronë e kontraktuesit të sigurimit.

1.2.2. Brenda hapësirave të siguruar, sigurohen::

- Ngjyrosjet, Tapelat, Pllakat e shtruara, Dyshemelë, veshjet e mureve dhe të tavaneve.
- Pajisjet sanitare, e ato janë pajisjet e tualetit, banjës dhe pajisjet për larje.
- Pajisjet e ngrohjes, pajisjet e nxehtjes së ujit, ato të ndërrimit, të ajrosjes, klimatizimit, të alarmimit për zjarr apo tym dhe shuarjes së zjarrit, si dhe ashenzorët, shkallët lëvizëse dhe të ngjashme bashkë me instalimet(tubat, kabllo, ...) e tyre
- muret ndarëse fikse, ndërmuret e lëvizshme, ndërtavanet e montuara fikse, veshjet e tavaneve, tavane ulëse, mirëpo jo orënditë për ndarjen e hapësirave apo mobiliet e integruara(montuara)
- shtresat fikse të dysHEMEVE dhe MUREVE, veshjet me pllaka të shtruara; llamperitë e montuara fiks, dhe veshjet tjera të mureve
- markizat, kapakët e dritareve dhe roletat bashkë me elementet punuese që u takojnë hapësirave të siguruar.
- Stufat e murosura për nxehtjen e hapësirave
- Portalet e biznesit, me kusht që ato të jenë në pronësi të pronarit të ndërtesës apo nëse pronari i ndërtesës është i obliguar të bëjë rindërtimin.

1.2.3 Të pasiguruarat janë:

- hapësirat (dhomat) plotësuese si ato të: podrumit, tavanit, shupat e drurit, garazhet, etj.

1.3. Pajisjet e ndërmarrjes

1.3.1. Aty hyjnë të gjitha pajisjet që i shërbejnë asaj ndërmarrje e që gjenden në vendin e sigurimit si brenda godinës ashtu edhe jashtë saj, përveç nëse janë pjesë e pajisjeve teknike të godinës të përkufizuara me pikën 1.1.2.

Pajisje të ndërmarrjes llogariten posaçërisht:

- makineritë, pajisja, impiantet dhe instalimet për prodhim, transformim, përcim, magazinim dhe konsumim të energjisë në të gjitha format.
- Aty hyjnë po ashtu: pajisjet për tharje dhe djegje, furrat për prodhimin e tullave, majolikave, porcelanit dhe të sendeve të ngjashme, e po ashtu edhe kthinat për tymosje, trafo stacionet, instalimet për klimatizim dhe pastërtim të ajrit.
- Makinat, pajisjet, impiantet dhe instalimet për prodhimin, përpunimin, transmetimin, , dërgimin dhe ruajtjen e të dhënave, informacioneve, dhe njoftimeve të çfarëdo tipi(mirëpo pa mbajtësit e të dhënave – pika 1.5.2.)
- Pajisjet, impiantet, aparatat dhe instalimet për matjen, kontrollimin, rregullimin dhe drejtimin e produkteve, gjendjes operative dhe hapave punues të të gjitha llojeve.
- Pajisjet, impiantet, aparatat dhe instalimet për transportimin e personave, materialit, mallrave dhe lëndëve të të gjitha llojeve, po ashtu aparatave absorbuese dhe instalimeve të tubacioneve të ujit e ku hyjnë të gjitha aparatat për furnizimin dhe heqjen e ujërave bashkë me aparatat matëse, armaturat, filtrat dhe pjesët plotësuese.

- Automjetet e të gjitha llojeve, makinat punuese vetëlëvizëse si dhe rimorkiot, mirëpo jo nëse ato automjete hyjnë në grupin e automjeteve me regjistrim nga autoritetet(pika 1.5.1.), përveç nëse janë automjete për fikjen e zjarrit.

- Pajisjet, impiantet, këllëfët(mbajtësit), dhe enët për magazinimin e materialeve, mallrave dhe materieve të të gjitha llojeve; po ashtu ambalazhi që mund të riciklohet, paletat, kontejnerët si dhe pajisja e depove me rafto të larta;

- Makinat e punës të të gjitha llojeve bashkë me elementet e tyre të vënies në lëvizje dhe pjesët e tyre plotësuese.

- Siloset, bunkerët, fuqitë për ujë e të tjera, oxhaqet, kanalet, pusët/pusetat, nëse këto përdoren për prodhim dhe nuk llogariten si ndërtesë(godinë); bazamenti i maqinave.

- Veglat e punës në impiantet e prodhimit duke përfshirë edhe katalizatorët.

- makinat manuale dhe aparatet e çfarëdo lloji.

- Veglat e punës bashkë me mjetet ndihmëse të prodhimit të të gjitha llojeve për përdorim me dorë apo me maquina, përveç nëse hyjnë në grupin e mjeteve ndihmëse për replikim(riprodhim) (pika 1.5.3.)

- Pajisjet e zyrave të të gjitha llojeve, bashkë me revistat dhe librat, pajisjet dhe rrobat e punës të të gjitha llojeve; pajisjet e dhomave(hapësirave) të përbashkëta, atyre të akomodimit dhe të mysafirëve si dhe pajisjet e kuzhinave, kantinave, bibliotekave dhe të hapësirave të ngjashme.

- Impiantet për fikjen e zjarrit, mbrojtjen nga zjarri, mbrojtjen në punë, impiantet sanitare dhe sportive.

- mbishkrimet e firmës dhe pajisja propagandistike, mjetet e propagandës dhe të dekorimit.

- pajisjet e hequra nga përdorimi dhe ato rezervë; Pjesët rezervë dhe sendet ende të pa montuara(ndërtuara), e që janë për pajisjet e reja të gjithë atyre llojeve të përmendura më lart(më parë), si dhe pjesët rezervë për automjete.

1.3.2. Sigurimi plotësues për pajisjet e ndërmarrjes

Sigurimi plotësues mbulon rritjen e vlerës, rregullimin(vënien në gjendje të rregullt), blerjen, ndërrimin, vlerësimin e pamjaftueshmësi si dhe pajisjet të cilat aksidentalisht (jo qëllimisht) nuk janë përfshirë në sigurim. Ky lloj sigurimi shërben për vënien në ekuilibër të nënsigurimit, ku duhet theksuar se në rast të dëmtimit, ky lloj sigurimi ndahet nëpër shumat e sigurimit të atyre pozicioneve për të cilat është kontraktuar e tek të cilat ka ardhur deri tek nënsigurimi. Kjo ndarje nëpër pozicione bëhet bazuar në nënsigurimin që ekziston nëpër ato pozicione.

1.4. Mallrat dhe rezervat

Aty hyjnë të gjitha mallrat dhe rezervat që gjenden në vendin e sigurimit si brenda godinës ashtu edhe jashtë saj. Në këtë grup hyjnë lënda e parë, prodhimet gjysmëfinale dhe finale me të cilat punohet, pjesët e gatshme të blera, mallrat tregtare të të gjitha llojeve, mbeturinat e përdorueshme, prospektet dhe reklammat, materialit shpenzues dhe ndihmës të çfarëdo lloji, tretësit, vajrat, materialet për ngrohje dhe ndezje, gazrat teknik, materiali ndërtimor, materiali hedonist, ambalazhi i paracikluar dhe i çfarëdo lloji, si dhe metale të çmuara dhe gurët e çmuar që shërbejnë për qëllime të prodhimtarisë.

1.5. Sendet e tjera

1.5.1. Automjetet

Automjetet rrugore, mjetet lundruese, mjetet fluturuese me leje zyrtare (përveç automjeteve zjarrfikëse – pika 1.3.1).

1.5.2. Mbajtësit e të dhënave të të gjitha llojeve, bashkë me programet dhe të dhënat që gjenden në ta. Të tillë janë p.sh. librat e ndërmarrjes, dosjet, planet, ruajtësit magnetik, mikrofilmat dhe të ngjashme;

1.5.3. Materialet ndihmëse të reproduktimit(replikimit)

Në këtë grup hyjnë të gjitha gjërat që i shërbejnë ndërmarrjes, e të cilat i përgjigjen këtij përkufizimi (definicioni):

Materialet ndihmëse të reproduktimit(replikimit) mban në vete një formë, një model/shablon, dizajn, shkrim apo informacion tjetër për një produkt të veçantë, dhe e njëjta formë (model/shablon, dizajn, shkrim, informacion tjetër) bartet në produkt, ku në rast të ndryshimit të produktit apo përfundimit të prodhimit të atij produkti, materiali ndihmës i reproduktimit(replikimit) nuk është më i përdorueshëm apo të paktën duhet të ndryshohet për t'u përdorur sërish.

Këso materiale janë p.sh.: kallëpet e derdhjeje, shablonet e të gjitha formave, format e derdhjeje, injektimëve dhe ndrydhjeje, modelet, stampuesit(bluesit), matricat, klishtë, pllakat dhe cilindrat e shtypshkronjave e të tjera;

1.5.4. Paratë dhe sendet me vlerë paraqe

Në to hyjnë: paratë dhe sendet me vlerë paraqe të çfarëdo lloji, librazet e kursimit me apo pa fjalëkalim, letrat me vlerë me kurs zyrtar dhe letrat tjera me vlerë;

1.5.5. Sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes

Në sendet e përdorimit të punëtorëve të ndërmarrjes nuk bëjnë pjesë paratë, dhe sendet me vlerë paraqe, stolitë, automjetet dhe sendet që gjenden në ndërtesat e banimit si inventar shtëpie.

2. Rreziqet dhe dëmet e siguruarat dhe të pasiguruarat

2.1. Dëmet nga eksplozimi i lëndëve plasëse

Në ndryshim nga neni 1 pika 1.3, i kushteve të përgjithshme të sigurimit nga zjarri (AFB_KS12), dëmet e shkaktuara nga shpërthimi i lëndëve plasëse nuk janë të siguruara, nëse:

- lëndët plasëse në mënyrë të lejueshme apo të kontrolluar janë sjellë në vendin e sigurimit, apo
- kontraktuesi i sigurimit ka ditur apo do të duhej ta dijë, që në truatlin fqinj i cili nuk është në kontroll të tij, ka lëndë plasëse.

Në grupin e lëndëve plasëse, dhe atë pa marrë parasysh se a përdoren ato lëndë për gjuajtje/shpërthime apo jo, hyjnë të gjitha lëndët plasëse të ngurta dhe të lëngëta apo të përbëra prej tyre dhe materialeve shpërthyes (ndezëse), nëse mënyra e rrjedhjes së eksplozimit të tyre dhe ndikimi i atij eksplozimi përputhet me mënyrën e rrjedhjes së eksplozimit dhe ndikimit të tij të lëndëve plasëse të cilat përdoren në teknikat e gjuajtjes dhe shpërthimeve

2.2. Bazamenti i makinave

Nëse bazamentet e makinave nuk janë përjashtuar nga sigurimi, atëherë bazamenti i makinës së dëmtuar nga ngjarja e siguruar është i siguruar nga dëmi, deri tek i cili dëm vjen kur bazamenti i asaj maqine, pa marrë parasysh se a është dëmtuar / shkatërruar apo jo, për shkak teknikë bëhet pjesërisht apo plotësisht i papërdorueshëm për rindërtimin / riparimin e asaj maqine.

3. Masat e përgjithshme të sigurisë

Duhet përmbajtur të gjitha masave të sigurisë të vendosura me ligj, atyre të vendosura nga autoritetet, si dhe masave në vijim që dalin nga marrëveshja kontraktuale. Nëse kontraktuesi i sigurimit shkel ndonjërin nga këto masa atëherë ai është i detyruar ta zhvendosë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

3.1. Ushtrimi i veprimtarive të çfarëdo lloji, në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri

Veprimtari me rrezik të shtuar nga zjarri sipas masave të sigurisë, ndër të tjera janë:

- Saldimi dhe prerja (autogjen, me elektricitet, në mënyrë termite)
- Lërimi/gërryerja dhe ndarja me gërryerje/lërimin (sidomos me fleks)
- Kallajtsja(saldimi me pikje)
- përdorimi i flakës (shkriqe, djegie, rëgjimi i folleve, bitumi etj.)

Veprimtaritë e tilla janë të rrezikshme e zjarr nxitëse sidomos për shkak të:

- përdorimit të flakës së hapur;
- përdorimit dhe krijimit të temperaturave të larta;
- krijimit dhe përhapjes së shkëndijave të përfiakshme;
- metalit të lëngët a të skuqur që pikon;
- produkteve të nxehta shumë, shpesh pjesëve metalike të skuqura nga temperatura.

Rreziqe të posaçme:

- shkëndijat nga zjarri rrezikojnë mjedisin në rreth të paktën 10 metra,
- një rrezik i veçantë nga zjarri ekziston ta punimet me zjarr në kantiere dhe vendmontime,
- te veprimtaritë në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, në arka dhe tubacione për lëngje të përfiakshme ekziston rreziku nga plasje, sidomos atëherë kur ato janë të zbrazura, por brenda tyre ende gjenden avuj të lëngjeve të përfiakshme,
- gjithashtu ka rrezik nga plasje te veprimtaritë, në të cilat ka rrezik të shtuar nga zjarri, afër pluhurit të materive të ngurta të përfiakshme, po ashtu edhe nga metalet!

Për këtë arsye te veprimtaritë në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, nëse kryhen jashtë punishteve të parashikuara dhe të pajisura enkas për këtë qëllim, duhen zbatuar detyrimisht këto masa të sigurisë:

- 3.1.1. Veprimtaritë e çfarëdo lloji, në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, mund të ushtrohen vetëm me leje të veçantë të drejtorisë së ndërmarrjes. Drejtoria duhet të kujdeset, pavarësisht kush i kryen punimet – punëtorët e sipërmarrjes apo persona të tjerë – që punimet t'i mbikëqyrë një punëtor i kualifikuar dhe i besueshëm i sipërmarrjes dhe pa përjashtim t'u përmbahen masave të caktuara ligjore si dhe dispozitave të mëposhtme.
- 3.1.2. Veprimtaritë e çfarëdo lloji, në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, parimisht nuk duhen ushtruar afër lëndëve të përfiakshme apo lëngjeve të ndezshme. Pjesët që duhen përpunuar, duhen sjellë në punishten e parashikuar, e cila është e rregulluar posaçërisht për këtë qëllim.
- 3.1.3. Para ushtimit të veprimtarive të çfarëdo lloji, në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, është parashikuar që të plotësohet tërësisht vërtetimi i parashikuar i miratimit (formulari në shtojcën 2) dhe të nënshkruhet nga drejtoria e ndërmarrjes ose i ngarkuari për mbrojtje nga zjarri dhe nga personi që kryen veprimtari, në të cilat ka rrezik të shtuar nga zjarri.
- 3.1.4. Veprimtaritë në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri mund t'i kryejnë vetëm personat e besueshëm dhe të afësuar për ato punë, të cilët janë plotësisht të vetëdijshëm për rrezikun lidhur me këtë.
- 3.1.5. Punëtori kompetent për mbikëqyrje duhet të njohë punëtorët me mënyrën e ndërtimit të objektit dhe me materiet e ndezshme që gjenden në lokalet apo

hapësirat fqinje, si dhe të kujdesen për masat adekuate e të mjaftueshme për fikjen e zjarrit.

- 3.1.6. Sendet a lëvizshme që ndizen shpejt dhe lëndët e ndezshme të ngurta, të lëngëta si dhe pluhuri dhe hedhurinat duhen mënjënuar para fillimit të punimeve nga rrethina e vendit të punës dhe zonat e rrezikuara fqinje.
- 3.1.7. Pjesët e ndezshme fikse të ndërtimit duhet që para nisjes së punimeve të mbrohen në mënyrë të siguri nga flaka, shkëndijat ose pjesët e zjarrit a të skuqura nga temperatura e lartë dhe atë përmes mbulesave të pandezshme mbrojtëse, me ujë, leckë të lagura ose me zall.
- 3.1.8. Të çarat e tavaneve dhe të mureve, pusët/pusetat, kanalet e tubave dhe kabllove, fugat dhe pasaritjet duhet të mbyllen para se të fillojnë punimet, në mënyrë që hapësirat/dhomat fqinje të sigurohen nga zjarri. Zonat e rrezikuara fqinje gjatë zhvillimit të punimeve duhen kontrolluar vazhdimisht që të mos shpërthejë zjarri ose të mos përcëllohen/digjen pa flakë (p.sh. për shkak të përçimit të nxehtë, shpërhapjes së xixave etj.).
- 3.1.9. Veshjet e ndezshme, izolimet etj. duhet të largohen nga zona e rrezikshmërisë para fillimit të punimeve.
- 3.1.10. Fugitë, tubacionet dhe kanalet për lëndë të ndezshme të ngurta, të lëngëta ose në formë gazi duhen zbratur dhe pastruar me përpikëri para fillimit të punimeve, e nëse ka mundësi të mbushen me ujë.

3.1.11. Uji për shuarjen e zjarrit dhe aparatet e tjera të përshtatshme për fikje duhet të mbahen në sasi të mjaftueshme të gatshme në vendet ku kryhen punimet dhe në zonën e gjerë të rrezikuar.

3.1.12. Para fillimit të punimeve duhet shikuar nëse funksionojnë si duhet aparatat që duhen përdorur për punë. Tek lëshimi(lërgja) e përkohshme e flakëve për saldimit, prerje, saldaturë duhet pasur kujdes dhe duhet ruajtur posaçërisht flakën e hapur dhe ajo(flaka e hapur) duhet të jetë po ashtu në vëllim të pareshtur.

3.1.13. Pas përfundimit të veprimtarive në të cilat ekziston rreziku i shtuar nga zjarri, duhet mbikëqyrtur vendi i punës dhe zonat e rrezikuara përreth, si dhe duhet verifikuar herë pas here, madje disa orë pas mbarimit të punimeve, në mos ka zjarr, tym ose erë zjarri. Në këtë rast duhet bërë kujdes të posaçëm në vendet që vështirë mund të shihen ose janë të papërshtatshme për t'u qasur. Fikjes së gacave apo zjarrit, madje edhe nëse bëhet fjalë për gacë apo zjarr tepër të vogël duhet kushlur vëmendje të veçantë. Qoftë edhe kur vërehet shenja më e vogël e zjarrit, tymit apo erës së tymit duhet njoftuar zjarrfikësit më të afërt për qëllime plotësuese (parandaluese).

3.1.14. Nëse nuk është siguruar mbrojtja e mjaftueshme nga zjarri, duhen ndalur të gjitha veprimtaritë që kanë rrezik të shtuar nga zjarri.

3.2. Mbrojtja ndërtimore nga zjarri, pajisja kundër zjarrit

Masat ndërtimore për formimin e sektorëve kundër zjarrit, si pjesët zjarrdruuese të ndërtimit, segmentet kundër zjarrit etj. nuk guxojnë as të mënjanojnë e as t'u zvogëlohet efekti. Funksionaliteti i masave të ndërtimit për formimin e sektorëve kundër zjarrit dhe pajisjet e tjera kundër zjarrit duhen kontrolluar në intervale të përshtatshme kohore.

3.3. Ngarkesa elektrostатike

Për makinat dhe pajisjet e ndërmarrjes, në punën e të cilave mund të krijohet elektriciteti statik, duhen parashikuar tokëzimet përkatëse ose masa të tjera efektive për zbrazjen e kontrolluar të ngarkesës elektrostатike.

3.4. Implantet për ndezjen e zjarrit dhe nxehtë

- 3.4.1. Puna me këto implante mund t'u besohet vetëm personave të caktuar e të sigurt, të cilët janë të njohur me implantin si dhe me masat përkatëse ligjore, dhe rregullat e autoriteteve.
- 3.4.2. Lëndët e ndezshme të ngurta, të lëngshme dhe të gazit nuk duhet të vendosen afër vendit ku ndizet zjarri, as afër gypave të tymit, fugave dhe të hapurave për pastrimin e oxhaqeve.

3.5. Punimet nga ana e të papunësuarve në ndërmarrje

Edhe në rastet kur punimet i kryejnë persona që nuk janë të punësuar në ndërmarrje, duhet siguruar që ata të respektojnë masat e sigurisë. Kontrollin e nevojshëm duhet ta bëjnë punëtorët e ndërmarrjes që janë të përshtatshëm dhe të besueshëm për këtë.

3.6. Rendi dhe pastërtia, vërtetimi kontrollues

Duhet pakësuar maksimalisht mundësia apo probabiliteti i krijimit dhe i përhapjes së dëmit, përmes mbajtjes së rendit dhe pastërtisë në gjithë ndërmarrjen.

Pas përfundimit të punës(orarit të punës) në ndërmarrje, personi i përshtatshëm dhe i besuar duhet të kryejë vërtetimin kontrollues të tërë implantit në lëvizje. Ky person duhet të shikojë jo vetëm mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rendit, por edhe respektimin e masave të tjera të sigurisë.

3.7. Magazinimi

- 3.7.1. Në qoftë se në Kushtet e posaçme të kontraktuara nuk janë përcaktuar masa më të rrepta të sigurisë, atëherë vlejnë dispozitat e mëposhtme të magazinimit të të gjitha llojeve.
- 3.7.2. Nëse nuk ka dispozita më të rrepta (p.sh. dispozitat e pajisjes për fikjen e zjarrit), atëherë të magazinimi në blloqe sipërfaqja që zë një dërgesë e mbyllur mund të jetë jo më e madhe se 200 m². Ndërmjet blloqeve të tilla të krijuara të magazinimit duhet lënë hapësira të lira, të cilat sigurojnë që çdo bllok depozitimi në rast zjarri

të jetë i arritshëm nga zjarri/kësisit nga të gjitha anët. Zonat midis blloqeve depozituese duhet të jenë gjithnjë të lira.

3.7.3. Materiet e përfshirë dhe që ndizen shpall (p.sh. druri, fije artificiale, kaltrani, rrëshira artificiale, goma e papërpunuar, ashta, bitumi), lëngjet e përfshirë (p.sh. benzina, alkooli, benzoli, etori, acetoni, vaj zjarri), gazet etj. duhen depozituar në depot që përbëjnë një sektor me votë kundër zjarrit.

3.7.4. Në depo dhe zonat e magazinimit nuk lejohet nxehtë me stufë.

3.7.5. Aparatet teknike në depo, si p.sh. stacionet mbushëse(elektricitet,...) të përdoruesve, instalimet e paketimit në folie të përzjarë etj. duhen rregulluar në atë mënyrë që të pengohet zgjerimi i dëmit (zjarri, shpërthimi) të sendet fqinj (në pajtë e hapësirave të lira mbrojtëse, përfundimi i pllakave kundër zjarrit etj.) në rast se ndodh ndonjë gabim gjatë funksionimit ose të përdorimit i gabuar.

Kushtet e veçanta të sigurimit të ndërmarrjeve „Business Medium“ (BV100_KS12 / Niveli 4)

A. Për gjësendet e siguruar të cilat janë shënuar në policë vlen:

1. Nëse është lidhur një kontratë sigurimi për pajisjet/mallrat/stoqet e ndërmarrjes, atëherë si shtesë e rrezikut të siguruar të përcaktuar në kushtet e përgjithshme të sigurimit të pasurisë vlen po ashtu se deri në shumën e përcaktuar të sigurimit janë të siguruar po ashtu edhe pajisjet e ndërmarrjes të marrura leasing si dhe mallrat e komisionit, mirëpo vetëm atëherë kur për to nuk mund të merret kompensimi nga ndonjë kontratë tjetër sigurimi.
2. Prona e huaj (me përjashtim të parave, arit, argjendit, stolive, letrave me vlerë, automjeteve si dhe amvisërisë) të cilën pronarët ia kanë lënë kontraktuesit të sigurimit për përdorim, riparim apo ia kanë lënë atij në përkujdesje me kusht që kontraktuesi i sigurimit të jetë i obliguar për kompenzimimin e asaj prone në bazë të ligjeve në fuqi apo të kontratave valide duhet marrë parasysh gjatë përcaktimit të shumës së sigurimit dhe është e siguruar.
3. Në rast se në policë nuk është përcaktuar ndryshe, atëherë vetëmbajtja (franshiza) minimale prej € 100,- vlen për secilin klasë sigurimi.

B. Kushtet e veçanta në vijim të sigurimit të ndërmarrjeve(BV100_KS12 „Business Medium“), vlejné për rreziqet e shënuara në policë.

(p.sh. nëse janë kontraktuar vetëm rreziqet zjarri dhe uji i tubacioneve, atëherë vlejné vetëm kushtet e shënuara në pikat: „Business Medium“ BV_F_KS12/ Niveli 4 dhe „Business Medium“ BV_LW_KS12/Niveli 4, mirëpo jo kushtet tjera të veçanta.

Zjarri (BV_F_KS12 / Niveli 4)

Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga zjarri (AFB_KS12):

1. Brenda kufirit të përcaktuar me shumën e sigurimit për pajisjet e ndërmarrjes, të siguruar janë edhe përshtatjet e pajisjeve/implanteve dhe të ndërtesave/godinave, me kusht që: kontraktuesi i sigurimit t'i ketë bartur shpenzimet e ndërtimit/prodhimit të tyre(të përshtatjeve) të mëhershëm(fillestar) dhe që po ashtu ai të jetë i obliguar me ligj apo me kontratë për rindërtimin/riprodhimin/bartjen e shpenzimeve të rindërtimit/riprodhimit të tyre, apo kur rindërtimi/riprodhimi i këtyre përshtatjeve është i domosdoshëm për vazhdimin e punës së ndërmarrjes së siguruar në vendin e njëjtë të sigurimit.

Stuhia (BV_St_KS12 / Niveli 4)

Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga zjarri (ASTB_KS12):

1. Brenda kufirit të përcaktuar me shumën e sigurimit për pajisjet e ndërmarrjes, të siguruar janë edhe përshtatjet e pajisjeve/implanteve dhe të ndërtesave/godinave, me kusht që: kontraktuesi i sigurimit t'i ketë bartur shpenzimet e ndërtimit/prodhimit të tyre(të përshtatjeve) të mëhershëm(fillestar) dhe që po ashtu ai të jetë i obliguar me ligj apo me kontratë për rindërtimin/riprodhimin/bartjen e shpenzimeve të rindërtimit/riprodhimit të tyre, apo kur rindërtimi/riprodhimi i këtyre përshtatjeve është i domosdoshëm për vazhdimin e punës së ndërmarrjes së siguruar në vendin e njëjtë të sigurimit.

Uji i tubacioneve (BV_LW_KS12 / Niveli 4)

Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga zjarri (AWB_KS12):

1. Dëmet e thyerjeve në tubacionet e ujit/kanalizimit/sistemit për ujë e ftohje/nxehtë janë të siguruar, kur ato tubacione gjenden brenda hapësirave të siguruar. Të pasiguruar janë dëmet në tubacionet e ujit/kanalizimit, të cilat shërbejnë votëm për furnizimin e ndërtesave, të cilat nuk janë siguruar me këtë kontratë.
2. Tek dëmet nga tubacionet e ujit dhe atë për secilin dëm duke filluar nga dëmi i tretë brenda periudhës së njëjtë të sigurimit, vetëmbajtja (franshiza) minimale është 50% dhe kurrë më pak se € 500,-
3. Brenda kufirit të përcaktuar me shumën e sigurimit për pajisjet e ndërmarrjes, të siguruar janë edhe përshtatjet e pajisjeve/implanteve dhe të ndërtesave/godinave, me kusht që: kontraktuesi i sigurimit t'i ketë bartur shpenzimet e ndërtimit/prodhimit të tyre(të përshtatjeve) të mëhershëm(fillestar) dhe që po ashtu ai të jetë i obliguar me ligj apo me kontratë për rindërtimin/riprodhimin/bartjen e shpenzimeve të rindërtimit/riprodhimit të tyre, apo kur rindërtimi/riprodhimi i këtyre përshtatjeve është i domosdoshëm për vazhdimin e punës së ndërmarrjes së siguruar në vendin e njëjtë të sigurimit.

Vjedhja me thyerje (BV_ED_KS12 / Niveli 4)

Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga vjedhja me thyerje (AED_KS12):

1. E siguruar është po ashtu edhe shkatërrimi/dëmtimi i qëllimshëm(vandalizmi) i sendeve të siguruar, nëse keqbërësi përmes thyerjes (neni 1, pika 2 e kushteve të përgjithshme të sigurimit nga vjedhja me thyerje AED_KS12), ka hyrë në hapësirat e siguruar.

2. Kushtet e veçanta të sigurimit të ndërmarrjeve 3. Sigurimi i xhamave të biznesit: (GB3001_KS12 / Niveli 4)

4. Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga thyerja e xhamave (ABG_KS12):

1. Të siguruar janë të gjithë xhamat e ndërmarrjes si xhamat nga qelqi, xhamat artificial, dhe xhamat e veçantë bashkë me xhamat e brendshëm, xhamat e frigoriferëve, xhamat e dyleve, vitrinave për reklamim, dritareve, reklamave të ndërmarrjes si dhe ata të kupolave të dritës apo të pajisjeve solare. Poashtu xhamat e lakuar apo me vrima si dhe veshjet me xham plumbi, mesingu dhe xhamat tjerë artistik janë të siguruar.
2. Të pasiguruar tullat e qelqit, lavanet e betonit të qelqit, pllakat e qelqit, oxhaqet e qelqit, dritat dekorative, pllakat, qelqërat me zgavër(poqi, gota, shishja,...), veshja e maqinave/aparaturave me xham, punimet me xham, neoni dhe të ngjashme.
3. Shpenzimet për heqjen dhe rivendosjen e pengesave si grilave mbrojtës, shkopinjëve mbrojtës dhe të ngjashme të cilat pengojnë vendosjen e xhamit të ri, janë të siguruar.
4. Shpenzimet për vendosjen e xhamave apo mbështjellësve provizor nga shtrëngesa(nevoja e ngutshme), shpenzimet për skelat e nevojshme për rregullimin e dëmit si dhe për pagesat shtesë jashtë orarit të punës janë të siguruar përderisa nuk kalojnë limitet e sigurimit për copë xhami..
5. Me një shumë sigurimi prej EUR 500,- në rrezik të parë janë të siguruar:
- 5.1. Shpenzimet për ruajtjen e përkohshme dhe të domosdoshme të hapësirave të siguruar pas dëmit të mbuluar nga sigurimi i thyerjes së xhamave;
- 5.2. Shpenzimet e rivendosjes së shkronjave, simboleve apo folieve të cilat kanë qenë në xhamat e siguruar e të thyer.
6. Dëmshpërblimi është i kufizuar me maksimalisht EUR 1.500,- për copë xhami.
7. Për dëmet në veshjet me xham plumbi, mesingu dhe xhamat tjerë artistik kompenzimi për çdo rast dëmi është i kufizuar me maksimalisht EUR 500,-.
8. Nën sigurimi: Nëse në momentin kur ndodh dëmi, shumë e sigurimit është më e vogël se vlera e re e pajisjeve dhe/ose e sigurimit e mallërave dhe rezervave të siguruar, atëherë edhe dëmshpërblimi paguhet vetëm pjesërisht dhe atë duke ndenjur në proporcion të njëjtë me dëmin siq rin shumë e sigurimit me vlerën e re të pajisjeve dhe vlerën e sigurimit të mallërave dhe rezervave të siguruar.
15. Me vlerë të re të pajisjeve nënkuptohen shpenzimet e riblerjes së pajisjeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi(klasë).
16. Tek mallrat dhe rezervat/stoqet, vlerë e sigurimit llogariten shpenzimet për riprodhimin i riblerjen e sendeve të reja të të njëjtit tip dhe cilësi(klasë).

Kushtet e veçanta të sigurimit të ndërmarrjeve Sigurimi paushall i xhamave të ndërtesës: (GB3011_KS12 / Niveli 4)

17. Palët kontraktuese të sigurimit janë pajtuar që ndryshimet dhe plotësimet e mbrojtjes siguruese të shënuara në vijim janë bërë me marrëveshje dhe janë të vlefshme pa marrë parasysh kushtet e përgjithshme të sigurimit nga thyerja e xhamave (ABG_KS12):
18. 1. Të siguruar janë xhamat e ndërtesës së shënuar në policë. Aty bëjnë pjesë edhe xhamat e kupolave të dritës, të pajisjeve solare dhe të reklamave të ndërmarrjes. Xhamat e lakuar apo me vrma si dhe veshjet me xham plumbi, mesingu dhe xhama tjerë artistik janë poashtu të siguruar.
19. 2. Xhamat e brendshëm (xhamat brenda hapësirave të sigurimit, pasqyrat e murit, vitrinat brenda hapësirave të sigurimit, xhamat e frigoriferëve dhe të ngjajshëm) janë vetëm atëherë të siguruar nëse janë pronë e kontraktuesit të sigurimit apo kontraktuesi i sigurimit është i detyruar me ligj ose me kontratë që ti kthejë ata në gjendje të rregullt apo të të bartë shpenzimet e rivënies së tyre në gjendje të rregullt.
20. 3. Të pasiguruar janë tullat e qelqit, tavanet e betonit të qelqit, pllakat e qelqit, oxhaqet e qelqit, dritat dekorative, pllakat, qelqërat me zgavër (poqi, gota, shishja, ...), veshja e makinave/aparaturave me xham, punimet me xham, pajisjet e neonit dhe të ngjashme.
21. 4. Shpenzimet për heqjen dhe rivendosjen e pengesave si grilave mbrojtës, shkopinjëve mbrojtës dhe të ngjajshme të cilat pengojnë vendosjen e xhamit të ri, janë të siguruar.
22. 5. Shpenzimet për vendosjen e xhamave apo mbështjellësve provizor nga shtrëngesa (nevoja e ngutshme), shpenzimet për skelat e nevojshme për rregullimin e dëmit si dhe për pagesat shtesë jashtë orarit të punës janë të siguruar.
23. 6. Me një shumë sigurimi prej EUR 500,- në rrezik të parë janë të siguruar:
24. 6.1. Shpenzimet për ruajtjen e përkohshme dhe të domosdoshme të hapësirave të siguruar pas dëmit të mbuluar nga sigurimi i thyerjes së xhamave;
25. 6.2. Shpenzimet e rivendosjes së shkronjave, simboleve apo folieve të cilat kanë qenë në xhamat e siguruar e të thyer.
26. 7. Për dëmet në veshjet me xham plumbi, mesingu dhe xhama tjerë artistik kompenzimi për çdo rast dëmi është i kufizuar me maksimalisht EUR 500,-.
27. 8. Nën sigurim: Nëse në momentin kur ndodh dëmi, shumica e sigurimit është më e vogël se vlera e re e ndërtesës së siguruar, atëherë edhe dëmshpërblimi paguhet vetëm pjesërisht dhe atë duke ndenjur në proporcion të njëjtë me dëmin siq rrin shumica e sigurimit me vlerën e re të ndërtesës së siguruar.
Me vlerë të re, të një ndërtese, nënkuptohet vlera e shpenzimeve që janë të zakonshme për atë vend, për planifikimin, konstruktimin dhe rindërtimin e asaj ndërtese.

Kushtet e veçanta të sigurimit të shpenzimeve të transportimit dhe deponimit pa ambient (F93_KS12 / Niveli 4)

1. shpenzimet për kontrollimin/hulumtimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin janë të siguruar deri në lartësinë e shumës së kontraktuar të sigurimit në rrezik të parë për shpenzimet e transportimit dhe deponimit.
- 1.1. Shpenzimet e transportimit dhe deponimit duhet të jenë shkaktuar nga:
 - ndonjë rrezik i mbuluar me këtë kontratë
 - nga sendet e siguruar në vendin e siguruar
- 1.2. E siguruar është gjithëmonë vetëm mënyra më e lirë nëse dispozitat ligjore lejojnë mënyra të ndryshme të transportimit dhe deponimit.
- 1.3. Shpenzimet e transportimit dhe deponimit të shkaktuara si pasojë e kontaminimit të ambientit (dheu, ujërave apo ajrit), nuk janë të siguruar.
- 1.4. Në rast të përzierjes së sendeve të pasiguruar (ku janë të inkuadruara edhe dheu, ujërat, ajri) me sendet e siguruar, atëherë kompenzohen vetëm shpenzimet për sendet e siguruar.
- 1.5. Nëse shkaktohen shpenzime të transportimit dhe deponimit për sendet e siguruar e të cilat para se të ndodhë dëmi i siguruar veç kanë qenë të kontaminuara (barra e trashëguar) atëherë kompenzohen vetëm ajo pjesë e shpenzimeve të transportimit dhe deponimit e cila tejkalon lartësinë e shpenzimeve të transportimit dhe deponimit që do të krijoheshin për sendet e siguruar e më parë të kontaminuara (barra e trashëguar) pa marrë parasysh se a do të bëheshin dhe kur do të bëheshin këto shpenzime në rast se dëmi i siguruar nuk do të ndodhte.
2. Shpenzimet e kontrollimit / hulumtimit janë shpenzime që krijohen kur është e domosdoshme që nga autoritetet apo ekspertët të kontrollohet/hulumtohet se a kemi të bëjmë me:
 - mbeturina apo lëndë të rrezikshme,

- sende të cilat përmes dispozitave ligjore për menaxhimin e mbetjeve të kafshëve duhet dorëzuar/deponuar në vende të veçanta apo në mënyrë të veçantë dhe të përcaktohet mënyra se si duhet trajtuar / deponuar ato
- 2.1. mbeturina apo lëndë të rrezikshme janë vetëm ato të përcaktuara si të tilla përmes dispozitave ligjore në fuqi.
 - 2.2. Me kontaminim nënkuptohet fuqia direkte apo indirekte e materialeve të dëmshme të cilat mund të jenë të dëmshme për njeriun apo ambientin, mund të dëmtojnë të mirat materiale apo mund të paraqes pengesë për përdorimin e ambientit për qëllime rekreative apo qëllime tjera legjitime e që përkufizohet me dispozitat ligjore në fuqi.
 3. Shpenzimet të transportimit janë shpenzimet e transportit me qëllim të trajtimit apo deponimit.
 4. Shpenzimet e trajtimit janë shpenzimet për masat e marra të cilat shërbejnë që mbeturinat e rrezikshme, lëndët e rrezikshme apo sendet të cilat përmes dispozitave ligjore për menaxhimin e mbetjeve të kafshëve duhet dorëzuar/deponuar në vende të veçanta apo në mënyrë të veçantë të eliminohen apo të përgaditen për deponim.
 - 4.1. Shpenzimet e deponimit të përkohshëm deri në maksimalisht gjashtë muaj kohë janë të siguruar brenda kufijve të shumës së sigurimit dhe atë vetëm nëse sigurosi njoftohet menjëherë me shkrim për deponimin e përkohshëm.
 5. Shpenzimet e deponimit janë shpenzimet për deponimin bashkë me taksat publike që duhet paguar për këtë.

Mbikëqyrja e hapësirave të siguruar (E26_KS12 / Niveli 5)

1. Mbikëqyrja e hapësirave të siguruar

Duke u bazuar në nenin 5 të kushteve të përgjithshme të sigurimit nga vjedhja me thyerje, palët kontraktuale merren vesh që hapësirat e siguruar jashtë orarit të punës (çka do të thotë edhe të dielave dhe ditëve të festës) të kontrollohen dhe ruhen pa ndërpreje përmes rojës së ndërmarrjes apo organit të ndonjë kompanie të sigurimit fizik të licencuar nga autoritetet, organ i cili do të merrej vetëm me ruajtjen e hapësirave të siguruar në policë.

2. Pasojat e shkeljes së detyrimit para se të ndodhë dëmi

Nëse kontraktuesi i sigurimit, shkel ndonjë nga këto detyrime, atëherë ai është i detyruar ta zhvendosë siguruesin për secilin dëm që i është shkaktuar siguruesit si pasojë e sjelljes së tij.

Ngruhja në dysheme (L14_KS12 / niveli 5)

Dëmet në apo nga pajisja e ngrohjes në dysheme janë të siguruar. Dëmshpërblimi për dëmet në ngrohjen në dysheme është i kufizuar me dëmshpërblimin për një tub uji të dyshemesë.

Sistemi autonom i lajmërimit të zjarrit (F5101_KS12 / Niveli 5)

A.) Ndërtesat e shënuara në policë janë të mbrojtura nga sistemi autonom i lajmërimit të zjarrit. Sistemi autonom i lajmërimit të zjarrit duhet që në çdo kohë dhe në secilin pjesë të tij të jetë i instaluar dhe të mirëmbahet konform rregullave të instalimit dhe të mirëmbajtjes të definuara nga prodhuesi përveç nëse është marrë leja me shkrim nga sigurosi për të vepruar ndryshe. Heqja nga funksioni i sitemit autonom të lajmërimit të zjarrit paraqet një rritje të rëndësishme të rrezikshmërisë në përputhje me nenin 8 të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë (ABV_KS12) dhe për heqjen e pjesërishme apo të tërësishme nga funksioni të këtij sistemi kontraktuesi i sigurimit ka obligim të njoftojë siguruesin me shkrim.

Kur sigurosi kupton për heqjen e pjesërishme apo në tërësi nga funksioni të sistemit autonom të lajmërimit të zjarrit, atëherë zbritja e logaritit e primit e dhënë për shkak të sistemit autonom të lajmërimit të zjarrit hiqet dhe kontraktuesi i sigurimit është i obliguar të ia kthejë atë sigurosit për kohën e mbetur të periudhës siguruese.

Kontraktuesi i sigurimit ka obligim që:

1. të mirëmbajë sistemin dhe të operojë me të si duhet dhe në përputhje me rregullat e mirëmbajtjes dhe përdorimit. Poashtu ai është i obliguar që të ketë një kontratë mirëmbajtje me kompaninë e cila e ka instaluar sistemin në fjalë dhe që këtë kontratë të ia paraqes sigurosit pa marrë parasysh se a e ka kërkuar ai këtë apo jo;

2. në rast të mosfunksionimit apo prishjeve / defekteve të pjesërishme apo të tërësishme të sistemit:
 - A. për këtë të lajmërojnë menjëherë siguruesin,
 - B. të riparojë / rikthejë sa më shpejt që të jetë e mundur funksionimin e tërësishëm të sistemit konform rregullave për funksionimin e rregullt të tij dhe që në ndërkohë të marrë masa të kujdesit të shtuar.
3. të paktën një herë në vit të garantojë kontrollin e sistemit në tërësi nga kompania e autorizimënjahen eliminohen menjëherë. Kontraktuesi duhet të ketë pajtëtarë dëshminë për kontrollin e sistemit dhe të mënjanimit të defekteve nëse ka pasur të tilla.
4. të lejojë që siguruesi apo ndonjë person i autorizuar i tij në qdo kohë të mund të kontrollojë poashtu këtë sistem dhe në rast se ai gjen defekte të mënjanimit menjëherë ato dhe dëshminë për mënjanimin e defekteve të gjetura të ia dëshmojë siguruesit.

B.) Në rast se kontraktuesi i sigurimit shkelë obligimin e tij për njoftim të siguruesit për rritjen e rrezikshmërisë konform nenit 8 të kushteve të përgjithshme të sigurimit të pasurisë dhe nëse ndodh dëmi i siguruar atëherë siguruesi paguan dëmshpërblim të reduktuar. Dëmshpërblimi i reduktuar rrit në proporcion të njëjtë me dëmshpërblimin që do të ishte paguar sikur kontraktuesi i sigurimit të mos kishte shkelur obligimin e tij për njoftim sikurse primi i paguar ku është dhënë zbritja për sistemin autonom të alarmit për zjarrin me primin që do të duhej paguar nëse nuk do të ishte dhënë kjo zbritje

Prishtine, Korrik 2025.
Departamenti i Marrjes në Sigurim
Drejtor, Ibrahim Isufaj



Bordi i drejtorëve të K.S. „ELSIG“ Sh.a. i ka rishikuar dhe miraturat këto kushte të përgjithshme, në mbledhjen e mbajtur me 31.07.2025.

Këto kushte hyjnë në fuqi me datën 31.07.2025.

Pajisja spërkatëse për fikjen e zjarrit (L11_KS12 / Niveli 5)

dëmet në apo dëmet nga pajisjet spërkatëse (për fikjen e zjarrit) janë të siguruara.

Pajisjet për klimatizim dhe/ose mbajtësit e ujit (L12_KS12 / niveli 5)

Dëmet në apo dëmet nga pajisjet klimatizuese të cilat mbajnë ujë apo/dhe dëmet në apo nga mbajtësit e ujit vëllim më të madh apo të paktën 1 metër kub e të cilat gjenden në tavan apo nënkulm janë të siguruara.

Përshtatja e vlerës (KL_VPI_KS12 / Niveli 4)

Palët janë marrë vesh që qëndrueshmëria e vlerës për shumën e sigurimit, bazën llogaritëse të primit dhe primin e kësaj kontrate sigurimi të bazohet në indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK) i cili publikohet secilin muaj nga entit statistikor i Kosovës dhe atë në këtë mënyrë:

1. Indeksi bazë - IÇK(b):
Për llogaritjen e përshtatjes së vlerës, duhet marrë parasysh indeksin bazë. Indeksi bazë është indeksi i publikuar për muajin e katërt para muajit të fillimit të sigurimit (p.sh.: nëse fillimi i sigurimit ka qenë muaji maj, atëherë si indeks bazë merret indeksi i muajit janar të vitit të njëjtë).
Indeksi bazë shënohet në policë duke e shënuar muajin e caktuar. (shembull: „qëndrueshmëria e vlerës në bazë të IÇK muaji / viti“).
2. Momenti i përshtatjes së vlerës:
Në policë shënohet dita kur primi vjetor duhet të paguhet. Vlera përshtatet secilin vit, mu në të njëjtën ditë.
3. Mënyra e kalkulimit:
Si „indeksi i përshtatjes“ llogaritet indeksi i IÇK i publikuar i katër muajve para muajit të përshtatjes së vlerës. (p.sh.: nëse përshtatja bëhet në maj, atëherë indeksi i përshtatjes merret indeksi i muajit janar të të njëjtë vit)..
Shuma e sigurimit, baza e llogaritjes së primit dhe primi rriten apo zvogëlohen në momentin e përshtatjes së vlerës në të njëjtin proporcion me ndryshimin e indeksit aktual të përshtatjes dhe indeksit të përshtatjes së mëparshme. (IÇK(t) / IÇK(t-1)), përveç përshtatjes së parë, ku merret raporti mes indeksit aktual të përshtatjes dhe indeksit bazë. (IÇK(1) / IÇK(b)).
Përqindja e rritjes apo zbritjes i komunikohet klientit secilën herë kur ka pasur përshtatje..
4. Indeksi pasardhës:
Nëse indeksi për të cilin palët kanë rënë ujd, zëvendësohet me një indeks pasardhës, apo nuk llogaritet dhe nuk publikohet më, atëherë do të merret parasysh indeksi i cili zyrtarisht do të zë vendin e tij.

Pishina (L13_KS12 / niveli 5)

Dëmet nga rrjedhja e ujit nga pishina e cila gjendet në apo mbi ndërtesë janë të siguruara.